



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 14 DHE 15 NËNTOR 2013**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 14. I 15. NOVEMBRA 2013. GODINE**

**NËNTOR - NOVEMBAR
2013**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për aktet normative,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë,
9. Shqyrtimi i raportit vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2012,
10. Shqyrtimi i raportit vjetor të Auditimit për vitin 2012,
11. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media,
12. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës,
13. Emërimi i anëtarëve të Organit Përzgjedhës të Pavarur për zgjedhjen e kryesuesit dhe anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit,
14. Emërimi i anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Pronës,
15. Emërimi i 2 (dy) anëtarëve të Bordit të RTK-së.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja izvan dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje Zapisnika sa prethodne sednice,
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona o zaštiti konkurencije,
5. Prvo razmatranje Nacrta zakona o Agenciji za emergentno menadžiranje,
6. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni zakona o sprečavanju sukoba interesa u obavljanju javne funkcije,
7. Prvo razmatranje Nacrta zakona o normativnim aktima,
8. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona o deklarisanju, poreklu i kontroli imovine visokih javnih zvaničnika, i deklarisanju, poreklu i kontrole poklona u odnosu na sve jave zvaničnike,
9. Razmatranje godišnjeg izveštaja RTK-a za 2012. godinu,
10. Razmatranje Godišnjeg izveštaja o reviziji za 2012. godinu,
11. Formiranje Ad hoc Komisije za selekciju 2 člana Nezavisne komisije za medije,
12. Formiranje Ad hoc Komisije za selekciju kandidata za članove Nezavisnog nadzornog odbora civilne službe Kosova,
13. Imenovanje članova Nezavisnog organa za izbor predsedavajućeg i članova Organa za razmatranje nabavki,
14. Imenovanje članova borda Kosovske agencije o imovini,
15. Imenovanje dva (2) člana Borda RTK-a.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Zëvendëskryeministra,

Ministër i Kabinetit qeveritar,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Paraprakisht, ju njoftoj se në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, deputetja Alma Lama iu ka bashkangjitur Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, ndërsa deputeti Nijazi Idrizi ka kaluar në Grupin Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike është lajmëruar deputetja Xhevahire Izmaqu.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Më lejoni që sot si deputete e këtij Kuvendi, në këtë seancë edhe unë të shpreh reagimin tim lidhur me rastin e ngritjes së akuzës ndaj çlirimtarëve tanë të njohur si “Grupi i Drenicës”.

Deputetët e Partisë Demokratike përsërisin besimin e vet ndaj luftës së pastër e çlirimtare të këtyre njerëzve që sot përballen me akuza të tilla, për ne si parlamentarë të rënda e fyese për të kaluarën tonë. Ne dhamë besimin dhe votën tonë për vazhdimin e partneritetit për këtë mision që besuam dhe ende besojmë në vlera të vërteta për drejtësi dhe barazi. Besimi ynë në misionin e EULEX-it ka nevojë për konfirmim, ka nevojë që sa më parë të dal në shesh e vërteta ajo e vërtetë që për asnjë minutë s’do t’i linte as në burg e as në akuza ata që patën guximin e parë ndër ne të besojnë në liri e çlirim.

Duke i dëgjuar faktet me kohë sa më të shpejtë, institucionet e drejtësisë do të rikthejnë besimin te mijëra luftëtarë të lirisë, por edhe te popullata shumicë shqiptare, se EULEX-i me veprime të veta nuk ka qëllim të dëmtojë imazhin e një lufte të drejtë që bëri Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Konsiderojmë se institucionet e drejtësisë do të rrisin nivelin e besueshmërisë ndaj tyre, duke mos lejuar tendencat për njollosjen e luftës së drejtë çlirimtare. Mendojmë se është koha e fundit për të dalë në shesh e vërteta, pasi vetëm ajo krijon besimin pa të cilin nuk mund të jetojë asnjë demokraci.

Drejtësia nuk toleron gjykime për interesa momentale, Salustro dhe EULEX-i përgjithësisht duke ngritur akuza kryesisht ndaj çlirimtarëve tanë po amnistojnë kriminelët e vërtetë, të cilët i dinë me emra dhe mbiemra. Aktorët e krimeve të vërteta i di EULEX-i, pasi në sirtarët e tyre janë dosjet siç i di edhe urdhëruesit e tyre. Kjo akuzë është e padrejtë, ne besojmë në luftën e drejtë e të pastër të luftëtarëve të UÇK-së, besojmë se lufta e pastër çlirimtare e Kosovës nuk mund të gjykohet as nuk duhet të dënohet. Këta burra dhe djem që sot po akuzohen ishin shpresa e vetme e mijëra qytetarëve të Drenicës për mbijetesë fizike dhe jo e kundërta.

Aktakuza e ngritur kundër bashkëluftëtarëve të komandantit legjendar Adem Jashari, prek vetë lirinë dhe themelet e shtetit të Kosovës. Kjo aktakuzë e ndërtuar mbi shpifje nga bashkëpunëtorët e atyre që na vranë e masakruan, është fyerja më e madhe që i bëhet Drenicës heroike dhe djemve më të mirë të saj.

EULEX-i me gjykimin e drejtë ndaj luftëtarëve të lirisë mund të përfundojë misionin e vet me dinjitet pa e devijuar besimin në një mision të paralizuar e të devijuar, mund të kthej besimin e respektin tonë si deputetë dhe të gjithë qytetarëve të këtij vendi. Besimi ynë në EULEX kthehet vetëm me gjykimin e drejtë e të shpejtë, me lirinë e ish-luftëtarëve tanë. Faleminderit!

KRYETARI: Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: I nderuar kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Kryeministri Thaçi, si dhe disa zyrtarë të tjerë qeveritarë u munduan që për një kohë të gjatë t'i bindin qytetarët e Kosovës, si dhe ta mashtrojnë popullin e Kosovës se marrëveshja me Serbinë e integron veriun e Kosovës, si dhe e mundëson sovranitetin e shtetit tonë edhe në atë pjesë.

Nëse është vërtet kështu, nëse me këto marrëveshje jemi bërë “Zot” të territorit tonë siç po thotë Qeveria, atëherë çka ka nevojë që kryeministri Thaçi ta takojë kryeministrin serb Ivica Daçiq dhe të bisedojë me të për mbajtjen e zgjedhjeve lokale në një pjesë të territorit të Kosovës. Nëse Marrëveshja me Serbinë po e sjell veriun nën kontroll të Prishtinës, atëherë pse askush nuk mundi atje që t'i mbronte zgjedhjet, të cilat u shkatërruan pikërisht nga strukturat e Serbisë në veri të Kosovës?

Kjo Qeveri aktuale e Kosovës po vazhdon që me një lehtësi të dhimbshme ta shndërrojë çdo çështje të brendshme të shtetësisë së Kosovës në temë të negociatave me Serbinë. Duke u takuar me Daçiçin dhe duke fol me të për zgjedhjet lokale në territorin e Kosovës, Qeveria jonë po e pranon Daçiçin, si dhe po e faktorizon atë si instancë vendimmarrjeje për një pjesë të territorit tonë.

Zyrtarët tanë qeveritarë duke filluar që nga kryeministri, duhet ta kuptojnë se duke u takuar me një zyrtar serb, i cili thotë se e përfaqëson edhe Kosovën, si dhe duke negociuar me ta e duke bërë kompromise për shtetin e Kosovës, kështu ata me ose pa vetëdije bëhen në njëfarë mënyre legjitimues të pretendimeve të Serbisë.

Ne duhet ta mbajmë qëndrimin parimore se nuk ka takime me zyrtarët serbë mbi supozimin se Serbia është hisedare në Kosovë. Normalizimi i marrëdhënieve mund të ndodhë vetëm kur Serbia të heqë dorë nga kjo platformë e saj hegjemoniste. Kryeministri ynë duke u munduar që të duket super-bashkëpunues para bashkësisë ndërkombëtare është duke lëshuar pe në çështjet fundamentale të shtetësisë së Republikës së Kosovës.

Atij më shumë po i intereson imazhi personal se si po duket para tjerëve, se sa kualiteti i shtetësisë të Republikës së Kosovës. Bashkëpunimi ndërshtetëror natyrisht se është i mirë, por vetëm kur ndërtohet mbi principet e respektimit të sovranitetit, reciprocitetit, si dhe dinjitetit mes shteteve. Jashtë këtyre parimeve marrëdhënia ose bëhet sundim, ose bëhet nënshtrim. Përderisa takimet Thaçi-Daçi po vazhdojnë, kryeministri i Serbisë para pak ditësh deklaroi se nëse zgjidhet një shqiptar në krye të Mitrovicës së veriut, atëherë do të ketë edhe konflikte të armatosura.

Zonja dhe zotërinj,

Në një shtet normal kësaj deklarate i thonë kërcënim me luftë, por nuk e dëgjova askënd nga Bashkimi Evropian që ta qortonte Ivica Daçiqin për këtë deklaratë luftë-nxitëse. Si mund të quhet ky njeri i paqes kur është përgjegjës për gjendjen kriminale në veri të Kosovës? Si mund të thuhet që ai i kontribuon stabilitetit në këtë mënyrë kur kërcënon me luftë Kosovën, nëse nuk bëhet ashtu siç dëshiron Serbia? Kjo do të thotë që Serbia i pamundëson çfarëdo zgjedhje në veri, por i mbështet veprimet e armatosura nëse veriun nuk e qeverisin njerëzit e saj.

Kjo fatkeqësisht tregon se kush në të vërtetë po qeveris me veriun e Kosovës dhe në vend që Qeveria jonë t'i shfrytëzojë këto veprime të Serbisë për ta forcuar pozicionin e Kosovës me veprimet e tyre qeveritarë tanë veç sa e kanë rehabilituar Ivica Daçiqin. E rehabilituan njeriun i cili i ka duart e lyera me gjakun e shqiptarëve.

A e patë atë komandantin e Policisë që doli tash si dëshmitar, Slobodan Stojanović, i cili vetë ka qenë komandant i Policisë edhe tregoi se çfarë tmerre, çfarë masakra, çfarë krime monstruoze ka shkaktuar Policia Serbe dhe në këtë kohë kur ky Slobodan Stojanović ka qenë komandant i Policisë, Ivica Daçi ka qenë pjesë e aparatit shtetëror serb, i cili me propagandë i ka...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: I nderuar kryetar!

Kabinet Qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni që në fillim të uroj lirimin e pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i ashtuquajtur "Grupi i Gjilanit" nga Gjykata e Beogradit për ta, urime për familjet e tyre, për popullin e Kosovës, i cili e ka bërë një luftë të drejtë dhe kjo u vërtetua, sepse edhe në

këtë foltore edhe më herët kemi thënë se ky është një proces i montuar politik me qëllime të caktuara për ta denigruar luftën tonë për liri.

Po ashtu, konsideroj se lidhur edhe me këtë rast prokuroritë, gjykatat duhen të heqin dorë nga marrja me historinë. Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka qenë e drejtë, prandaj ka fituar, ka qenë e drejtë prandaj është përkrahur nga bashkësia ndërkombëtare, ka qenë e drejtë dhe e pastër prandaj Kosova është bërë shtet i pavarur dhe sovran.

Prandaj, të gjitha montimet politike që bëhen e që po bëhen e më tutje siç është rasti me “Grupin e Drenicës” nuk ka ngjyrim tjetër përveç një ngjyrimi politik me akuza të shpifura, të cilat duan të denigrojnë një luftë të tërë. Kërkojmë që të merren prokuroritë e gjykatat qoftë ato ndërkombëtare, qoftë ato vendore me krimin e organizuar që para syve të tyre po ndodh, me korrupsionin, me veprimet antiligjore në Kosovë se sa të merren me pjesë të historisë të lavdishme tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, fjalën e ka kryetarja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderur kryetar!

Përshëndetje për zëvendëskryeministrin dhe ministrat, deputetët, të cilët janë sot të pranishëm në këtë seancë.

Unë prita që sot në seancë të jetë kryeministri Thaçi dhe zëvendëskryeministrja Edita Tahiri, për arsye se besoj që kryeministri ndoshta nuk është në dijeni për çështjen e Marrëveshjes teknike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në sektorin e energjisë.

Unë ngre shqetësimet e mia, duke marrë parasysh se zonja Edita Tahiri vjen po nga ky sektor dhe në këtë marrëveshje në shikim duket shumë e mirë, mirëpo në implementim do të ketë pasoja shumë të mëdha për Kosovën. Unë nga këtu apeloj në emrin tim si deputete e Kuvendit të Kosovës dhe në emër të Grupit Parlamentar që gjatë zbatimit të kësaj marrëveshjeje, kryeministri të njoftohet ekskluzivisht mjaft qartë për arsye se grupet teknike, të cilat kanë arritur marrëveshjen ka mangësi dhe ka dobësi në bazë të ligjeve të cilat i kemi miratuar ne si Kuvend i Kosovës.

Nuk dua të diskutoj më shumë në këtë temë për arsye se do të ketë probleme në implementim gjatë dhjetorit të këtij viti, mirëpo kërkoj edhe njëherë nga kryeministri që të jetë në dijeni me grupet teknike dhe me zëvendëskryeministren Edita Tahiri për implementimin e marrëveshjes në sektorin e energjisë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Por, Kuvendi e ka miratuar marrëveshjen me më shumë se 80 vota. Në emër të “6+”, fjalën e ka deputeti Enis Kervan.

ENIS KERVAN: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Ben dün Kosova medyalarında Çevre ve Alan Planlama Bakanlığı Bakanı sponsorluğunda Çevre ve ses kirliliğini düzenleyen Yasa Tasarısının Hükümet tarafından kabuluyla ilgili haberine değinmek istiyorum. Evet bu medyalarda yer alan bir haber.

Kosova Meclisine henüz ulaşmadı, fakat yanlış payı olsa bile bu haberin Bakanın çıkıp bunu tepkiyle karşılaması gerekiyordu.

Bu da haberin maalesef gerçek olduğunu öne sürüyor. Çevre ve ses kirliliğini düzenleyen Yasa Tasarısında ibadet yerlerindeki seslerin düzenlenmesini de içeriyor, bu da yüzde 96 Mülüman nüfusunun yaşadığı bir Kosovada ezan seslerinin düzenlenmesini içeren bir yasa ise medyadaki haberlere göre bunu ve Bakanı kınıyorum, milletin sabrını taşırmayın diyorum Sayın Bakanımıza. Bundan birkaç ay önce zaten çeşitli günlük gazetelerde Türklere ve Osmanlıya yönelik yanlış bilgilerle ve yazılarla önümüze çıkan Bakan bu sefer böyle bir yasa tasarısıyla gerçekten çıkıyor ise, bu milletin sabrını taşırdığı anlamına gelecektir.

Bu yüzden umarız böyle bir yasa taslağı Meclise gelmez, gelse de zaten burada eminim ki destek bulamaz, ezanların ve diğer ibadet yerlerindeki seslerin sesini düzenlemek bizim herhalde Anayasamıza da aykırı, insani değerlere de aykırı. Teşekkür ederim.

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolege edhe kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Edhe unë e kërkoja fjalën për të shprehur shqetësimin për rastin e konfiskimit të mbi 5 mijë librave shqipe nga policia, si dhe nga Inspektorati serb në Luginën e Preshevës, libra këto të cilat do të thotë janë dhuruar donacion nga Ministria e Arsimit e Republikës së Kosovës për nxënës të apo shkollat e Luginës së Preshevës.

Kemi parë dy ditë më herët, do të thotë ku me mbishkrimet “kthena abetaren” këta nxënës të shkollës “Zenel Hajdini” të fshatit Raincë të Preshevës kanë protestuar para dyerve të shkollës së tyre duke kërkuar që të mos u shkelet e drejta e tyre elementare. Asnjë demokraci nuk ka rrezik nga abetaret, e as nga fëmijët që dinë të lexojnë.

Ne nuk ndalojmë libra, prandaj Qeveria e Serbisë do të duhej të përkujdesej për pakicat ashtu siç trajtohen këto pakica në Republikën e Kosovës. Ky akt antivilizues bie ndesh me vullnetin e treguar nga Qeveria e Serbisë për normalizim të marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve. Normalizimi do të duhej të ishte i dyanshëm dhe është i natyrshëm vetëm atëherë kur palët nuk janë destruktive, kur këto palë synojnë vlerat evropiane, e assesi vlerat mesjetare.

Nxënësve të Luginës u janë mohuar të drejtat e tyre dhe ato të pakicave, prandaj ky akt antivilizues do të duhej të korrigjohej shpejt dhe nxënësit shqiptarë të Luginës të vazhdojnë mësimin në gjuhën e tyre dhe nga autorë shqiptarë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

U kthjem tash në seancë prapë pas një kohe të gjatë që iu pamundësua puna këtij Kuvendi, i cili shpeshherë si pamundësim tentojnë të kamuflohej me fushatën parazgjedhore. Pra, thoshim deputetët e koalicionit qeverisës që për shkak të fushatës nuk po vijnë deputetët në sallë, rrjedhimisht nuk po kemi kuorum, gjë që të gjithë e dimë që nuk ka qenë fare e vërtetë.

Bllokimi i seancës është bërë për shkak të bojkotit që ia ka bërë koalicioni qeverisës seancës ose më saktësisht themelimit të Komisionit Hetimor për Privatizimin e PTK-së. Ky ka qenë shkaku edhe arsyeja kryesore pse ky Kuvend nuk ka mbajtur seancë të rregullt tash e një kohë të gjatë.

E, natyrisht bllokimi i themelimit të këtij Komisioni Hetimor është bllokim i hetimit të këtij procesi të privatizimit të PTK-së. Pra, kjo tregon shumë qartë që Qeveria me deputetët e vet, me disa prej deputetëve të vet që i ka këtu në Kuvend po do që ta bllokojë hetimin për procesin e privatizimit dhe jemi në një situatë të tillë çfarë jemi dhe kjo situatë fatkeqësisht edhe po vazhdon. Dhe, ky tentim për ta bllokuar punën e këtij Komisioni Hetimor tregon shumë zëshëm që këta edhe kanë çka të fshehin në këtë proces të privatizimit edhe janë të vetëdijshëm se çka po fshehin, prandaj edhe nuk duan ta hetojnë procesin e privatizimit.

Kemi dëgjuar disa herë edhe në seancat e kaluara që nuk kemi çfarë të hetojmë, sepse nuk është marrë kurrfarë vendimi për këtë proces privatizimi, gjë që po ashtu është absolutisht e pavërtetë, sepse të gjithë e dinë që Qeveria e Kosovës e ka nisur një proces të tenderimit, e ka udhëhequr atë proces të tenderimit edhe e ka përfunduar atë proces të tenderimit duke e shpallur madje një prej kompanive aty si kompaninë ofertuese më të mirë për blerjen e PTK-së.

Pra, ky është vendim qeverie, ky është proces që e ka udhëhequr Qeveria dhe kjo është materia e hetimit të Komisionit Hetimor. Pra, nuk është e vërtetë që nuk kemi se çfarë të hetojmë, ne kemi çfarë të hetojmë dhe kemi veprim që është ndërmarrë nga Qeveria i cili domosdoshmërisht duhet të hetohet dhe i cili është pjesë e hetimit nga ky Komision Hetimor që është kërkuar nga 40 deputetë.

Ju bëj thirrje veçanërisht nënshkruesve të kësaj kërkesë për themelimin e Komisionit. Është absolutisht e dëmshme poqe se tërhiqemi tash. Nuk bën të tërhiqemi nga themelimi i këtij Komisioni. Madje- madje nuk bën edhe ta pranojmë suspendimin e themelimit të këtij Komisioni, sepse pavarësisht se si do të jetë në fund vendimi për apo kundër privatizimit të PTK-së ky proces duhet të hetohet për shkak se është proces i cili ngërthen shumë shkelje të ligjit, shkelje procedurale, madje-madje edhe dyshime për afera korruptive dhe këto duhet të zbardhen nga ky Kuvend.

Nuk ka të drejtë askush që t'ua bllokojë Komisionin Hetimor 40 deputetëve nënshkrues që e kanë dhënë firmën për ta...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!
Të nderuar deputetë,

Të gjithë jemi dëshmitarë që gjatë fushatës zgjedhore kandidatë dhe candidate të caktuara kanë ulur nivelin intelektual duke zgjedhur forma shpifëse, thashetheme e çka jo tjetër. Këto nuk i bëjnë nder as politikanëve në fjalë, por as politikës në tërësi. Më vjen shumë keq që po e ngre një çështje këtu në Parlament, por patjetër më duhet ta falënderoj shumë singlerisht zonjën Kusari-Lila, e cila në dy minutat e fundit në emisionin e mbrëmshëm në “Rubikon” në vend se të tregonte se çka do të bënte për Gjakovën, më zgjodhi edhe më bëri publicitet mua si mësimdhënëse e matematikës dhe më duhet t’i tregoj që në atë shkollë, në Shkollën e mesme të ulët në fshatin Sheremetaj punoj që 22 vjet dhe jam shumë e nderuar që jam mësimdhënëse e matematikës dhe profesioni i matematicientes është profesion deficitar dhe në Komunën e Gjakovës nuk ka asnjë mësimdhënës të matematikës që nuk është i punësuar.

E ftoj zonjën Mimoza Kusari-Lila, që pas humbjes që do ta ketë më një dhjetor në Gjakovë, të zgjedhë profesionin e matematicientes dhe po i premtoj që Aleanca do të ketë shumë mirëkuptim pas diplomimit do t’ia gjejë një vend të punës, sepse ekonomistë sot në Kosovë fatmirësisht kemi shumë të tillë që diplomojnë, por fatkeqësisht ka numër shumë të madh dhe nuk kemi hapësirë për t’i punësuar.

Prandaj, edhe njëherë i them që shkolla në të cilën unë punoj është shkolla “Dy Dëshmorët” aty punoj edhe jetoj që 22 vjet dhe nga Prishtina nuk e monitoroj shkollën dhe jam shumë e nderuar dhe edhe njëherë i bëj ftesë që t’i përkushtohet profesionit të matematikës në qoftë se ka kapacitet dhe unë i premtoj që do t’ia gjej një vend të punës, ne si Aleancë. Kemi mirëkuptim për humbje do ta ketë më 1 dhjetor.

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Suzan Novobërdaliu.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit! Flas në emër të Grupit, kryetar.

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

E dimë të gjithë se me datën 8 nëntor në shkollën “Zenel Hajdini” në fshatin Raincë të Preshevës, nga inspektorët serbë janë konfiskuar 5 mijë libra të cilët kanë qenë për nxënësit e klasës së parë, të dytë, të tretë dhe të katërt. Librat kanë qenë në gjuhën shqipe dhe të hartuara sipas plan programeve të Kosovës.

Ndërsa, në Kosovë po ndodh e kundërta dhe atë siç jeni në dijeni le që mësimi zhvillohet komplet me plan programet e Serbisë, por edhe i gjithë materiali mësimor është produkt i shtetit fqinj. Po ashtu, edhe simbolet shtetërore, flamujt, vulat, ditarët e nxënësve janë pjesë e punës së shkollave ku mësimi zhvillohet në gjuhën serbe, ndërsa objektet janë në shtetin e Kosovës.

Pra, nga autoritetet serbe është ndërmarrë një veprim krejtësisht ndryshe krahasuar me tolerimet që bëhen nga institucionet e Kosovës për shkollat ku mësimi zhvillohet në gjuhën serbe. Andaj, pasi jemi në fazën e konkretizimit të Marrëveshjes së bashkëpunimit me shtetin fqinjë mendoj se është koha e fundit që delegacioni kosovar i udhëhequr nga kryeministri i vendit i cili po vazhdon bisedimet për jetësimin e Marrëveshjes me Serbinë duhet përfundimisht të kërkojë reciprocitet për unifikim të drejtave në procesin mësimor. Faleminderit!

KRYETARI: Adem Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Unë vetëm desha që për hir të opinionit, për të mos lejuar të krijohet mjegulli, të bëhet paqartësi të qartësoj edhe njëherë qëndrimin e Grupit Parlamentar të PDK-së dhe lirisht mund të them edhe të koalicionit, se koalicioni asnjëherë nuk kemi qenë as nuk e kemi ndjekur rrugën e bllokimit, aq më tepër si grup parlamentar edhe si Parti Demokratike. Gjithnjë kemi qenë për bashkëpunim e aq më tepër kur kanë qenë në pyetje interesat nacionale.

Për rastin në fjalë, ne absolutisht asnjëherë në asnjë moment nuk e kemi kundërshtuar formimin e çfarëdo Komisioni Hetimor për çfarëdo çështje që ka paqartësi, por ne kemi kërkuar dhe kërkojmë që të respektohen procedurat, të respektohen ligjet të cilat i kemi aprovuar këtu në këtë Parlament.

Kemi dy çështje për të cilat duhet të votohet, Parlamenti ka konsumuar debatin, prandaj nuk është në interes as të qytetarëve, as të vendit, as të këtij institucioni që të shpërndahen shpifje, paqartësi, të krijohet mjegull para opinionit, por opinionit duhet t'i bëhet e qartë ,edhe në këtë rast çdo grupi, çdo deputet për çfarëdo çështje që janë të interesuar që të hetojmë, do ta ketë përkrahjen e fuqishme të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës. Krejt këtë e bëjmë të heqjes së çdo dyshimi për çdo çështje cilado qoftë, apo të çfarëdo natyre qofshin ato.

Prandaj, edhe njëherë po e përsëris, ne kërkojmë vetëm respektimin e procedurave, respektimin e Rregullores së këtij Kuvendi, respektimin e ligjeve, të cilat i kemi aprovuar. Faleminderit!

KRYETARI: Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë dola këtu të shpreh shqetësimin tim dhe të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike lidhur me procesin e zgjedhjeve të 3 nëntorit, proces nga i cili unë po preferoj kësaj radhe të trajtoj vetëm një segment, segmentin e zgjedhjeve si rezultat i Marrëveshjes së Kosovës dhe Serbisë ku kemi një fenomen i cili është shfaqur dhe fenomen i cili mund të dëmtojë rënd interesin e Kosovës.

Ka ndodhur që zgjedhjet në Kosovë qëllimisht në përpjesën e brendshme që po e quajnë kështu në jug të Kosovës, janë mbajtur për pakicën serbe dhe janë lejuar që zyrtarë të lartë të Serbisë të vijnë dhe të llobojnë fort, të thërrasin direkt, haptas që të votohet për një parti të caktuar.

Dhe, po ashtu qëllimisht është lejuar që të dëmtohet procesi në pjesën e veriut dhe ky dy kohësim i procesit zgjedhor për pakicën serbe në Kosovë ka krijuar një realitet i cili është për mendimin tim dhe të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, shumë shqetësues. Pse është shqetësues? Sepse, ka krijuar një ribalansim të forcave politike sa i përket pakicës serbe në Kosovë dhe tashmë e kemi një humbje territorit nga përfaqësuesit e pakicës serbe të cilët ka pasur një qasje më pozitive dhe kanë qenë pjesë e institucioneve të Kosovës dhe kemi radikalizim në pjesën e brendshme të Kosovës dhe përfaqësim radikal të interesit të pakicës serbe në Kosovë.

Ky problem me deklaratat dhe ndërhyrjet direkte Qeverisë së Serbisë brenda territorit të Kosovës, ka denigruar dhe ka dëmtuar rëndë përfaqësimin e interesit të qytetarëve të Kosovës të përkatësisë etnike serbe dhe kjo po ashtu si rezultat i deklaratave dhe qëndrimit të zyrtarëve serbë dhe si rezultat i mungesës së vizionit, planit dhe qëndrimit të institucioneve të Kosovës.

Sa i përket pjesës veriore po ashtu është problematike dhe mjaftë shqetësuese fakti që qëllimisht është dëmtuar procesi zgjedhor dhe po ashtu është jashtëzakonisht shqetësuese fakti që përfaqësuesit e Serbisë kur kanë ardhur edhe në pjesën e veriut edhe në pjesën e jugut të Kosovës, kanë thanë se me këto zgjedhje do të përcaktohet roli i Serbisë brenda Kosovës dhe kjo deklaratë mendoj se është mjaftë shqetësuese dhe ky qëndrim është mjaft shqetësues dhe mungesa e qëndrimit të institucioneve të Kosovës, mungesa e qëndrimit të Qeverisë së Kosovës, mungesa e qëndrimit të kryeministrit të Kosovës, është po ashtu shqetësuese dhe problematike për përfaqësimin e interesit të qytetarëve serbë brenda Kosovës dhe po ashtu për determinimin e rolit të institucioneve të Kosovës në gjithë territorin e Kosovës.

Po ashtu, kjo jep të kuptojmë që Qeveria e Kosovës dhe vetë kryeministri...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Në emër të Grupit, edhe dy minuta.

ARBEN GASHI: Po ashtu, kjo jep të kuptojmë se kryeministri i Kosovës nuk ka plan sa u përket zgjedhjeve në Kosovë, nuk ka plan sa i përket realitetit, i cili po krijohet me ndërhyrjen e Qeverisë së Serbisë, për të mos lënë ta kuptojmë ndoshta më të keqen që mund të jetë pjesë e një plani të keq për Kosovën dhe për të ardhmen e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Ka përfunduar kjo pikë e rendit të ditës. Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Prej të gjitha pyetjeve që janë bërë që u janë drejtuar ministrave vetëm një ministër është këtu. Deputetja që ka bërë pyetje për ministrin Agani, Time Kadriaj, mund ta parashtrojë pyetjen.

TIME KADRIAJ: Faleminderit, kryetar!

Aksioni i marrë në gusht për spërkatjen e vendeve endemike me rriqra ka rezultuar i suksesshëm. A është ky aksion i vonuar dhe pse ky aksion nuk është marrë herët në pranverë në fillim të sezonit, po në fund të zezonës?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

E nderuara zonja deputete,

I nderuar zoti zëvendëskryeministër,

Aktivitetet e dezisektimit selektiv janë planifikuar që nga muaji mars i këtij viti duke specifikuar të gjithë materialin e nevojshëm dhe të cilësisë së lartë të nevojshëm për të realizuar synimin.

Aktivitetet e dezisektimit të vatrave endemike janë realizuar si proces në vazhdimësi nga ekipet e përbashkëta të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik dhe ekipet komunale: Malishevë, Rahovec, Suharekë dhe Klinë, të cilat paraprakisht kanë qenë të trajnuara. I gjithë materiali i nevojshëm është siguruar nga Ministria e Shëndetësisë.

Faza e parë e këtij dezisektimi është kryer gjatë muajit prill dhe maj të këtij viti me ndërprerje për shkak të kushteve atmosferike.

Faza e dytë ka filluar në qershor të këtij viti dhe ka zgjatur deri në fillim të muajit gusht. Raportimi i aktiviteteve të zbatuara është bërë në baza ditore. Në gusht të vitit 2013 dezisektimi kolektiv është bërë nga Ministria e Bujqësisë dhe atë deri në gjysmën e shtatorit të vitit 2013 në komunën e Malishevës, në vatrën endemike ku ka pasur raste të vdekjes nga ethet hemorragjike krime kongo, në Astrazub, Dragobil, Burim, Balincë dhe në Panorc. Prandaj, ky aktivitet parandalues nuk ka filluar në muajin gusht, por që nga muaji prill dhe atë në të gjitha fshatrat që janë definuar si vatra endemike që kanë qenë gjithsej 107.

Se sa ka qenë i suksesshëm është vështirë të matet me saktësi, por efekti gjithsesi ka qenë i madh në zvogëlimin e numrit të rriqrave dhe ajo që është evidente dezisektimi i sivjetmë ka pasur një dimension shumëfish më të madh sesa në vitet e kaluara. Vjet kemi pasur vetëm dy raste fatale nga 12 raste pozitive e në vitin 2011 asnjë rast fatal nga ethet hemorragjike krime kongo, nga pesë raste pozitive.

Sivjet kemi pasur dezinfektimin selektiv më masovik në ato hapësira dhe kemi pasur gjithsej 11 raste të vdekjes. Kjo padyshim flet qartë se nuk është vetëm faktori i dezinfektimit i vetmi, por ka edhe faktorë të tjerë të eko-sistemit, që sivjet kanë ndikuar në shtimin e numrit të madh të rriqrave, përfshirë edhe faktorët klimatik. E gjithë kjo situatë është marrë parasysh nga Këshilli Ndërmintor për ethe hemorragjike që është ngritur nga Qeveria e Kosovës dhe ne kemi pasur një aktivitet sistematik në muajt e fundit dhe kemi nxjerr strategjinë për t'u ballafaquar me këtë problem, si dhe planin operativ për zbatimin e masave që do të minimizojnë në maksimum, sa është e mundur mundësinë e përsëritjes së ngjarjeve tragjike të këtij viti.

KRYETARI: Faleminderit! Deputete, ke pyetje shtesë?

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, ministër për informatat, mirëpo, pas dezinfektimit të fundit nuk kemi më raste të vdekjeve nga ethe hemorragjike.

A ka plan Ministria për vitin e ardhshëm për dezinfektim dhe a ka buxhet, sepse për këtë vit keni thënë që nuk ka pasur buxhet të mjaftueshëm dhe a keni bërë planifikim, a do të fillojë dezinfektimi me kohë, në mënyrë që rastet e rënda dhe rastet me fatalitet të zvogëlohen?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Fakti se në muajin shtator nuk ka pasur raste të vdekjes nga ethe hemorragjike krime kongo është një fakt, i cili bazohet edhe në rrjedhën normale të ciklit biologjik të zhvillimit të rriqrave, sepse në atë periudhë kohore rriqrat e përfundojnë periudhën e tyre të shumimit dhe prandaj më nuk paraqesin rrezik të drejtpërdrejtë për popullatën.

Prandaj kjo ka qenë më tepër një aktivitet në kontinuitet, tash nga prilli që ka përfunduar në muajin shtator, por nuk ka pasur një ndërlidhje të drejtpërdrejtë të suksesit. Unë e thashë se kësaj here për herë të parë Qeveria e Kosovës ka ndërmarrë masa konkrete në koordinimin e aktiviteteve ndërmjet ministrive dhe nuk bëhet fjalë për plan të Ministrisë së Shëndetësisë, por për plan të ballafaqimit me ethe hemorragjike në nivelin e Këshillit Ndërmintor.

Jo vetëm plan operativ, por edhe strategji e cila do të kombinojë një serë të masave të cilat do të fillojnë që nga janari i vitit që vjen, madje-madje një masë e veçantë që nënkupton lëvrimin e djerrinave në periudhën kur temperaturat janë të ulëta, në mënyrë që larvat e rriqrave të cilat gjenden në tokë t'u ekspozohen temperaturave të ulëta dhe në atë mënyrë të shkatërrohen. Pra, një metodë që është përdorur në disa shtete dhe atë me mjaftë sukses, ajo do të bëhet gjatë muajit dhjetor.

Pra, kemi një kombinim të masave në nivelin qendror dhe në nivelin komunal, në komunën e Malishevës në mënyrë më konkrete. Prandaj, shpresoj që viti i ardhshëm do të jetë vit në të cilin do të shohim një veprim edhe më të organizuar të organeve shtetërore ndaj këtij problemi shumë serioz. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Bekim Haxhiu, pyetje për ministrin Nenad Rashiq.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

I nderuar ministër,

E drejta për punësim për familjet e dëshmorëve, të invalidëve dhe veteranëve të UÇK-së është rregulluar me Ligjin numër 04/L-054 për statusin, të drejtat e dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve, të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimat civile dhe familjet e tyre.

Sipas ligjit këto kategori kanë përparësi në punësim në kushte të barabarta të punës, përparësi në regjistrim dhe pranë institucioneve arsimore publike në kushte të barabarta me të tjerët, bursë për shkollim të mesëm dhe universitar.

Sipas të njëjtit ligj, nenit 21 parashihet gjoba prej 3 mijë deri në 5 mijë euro për moszbatimin e dispozitave të këtij ligji. Janë me qindra raste të shkeljes së këtij ligji dhe Inspektorati i Punës, që funksionon në kuadër të Ministrisë suaj nuk ka ndërmarrë asnjë veprim deri më tani.

Pyetja është: Çfarë hapash ka ndërmarrë ministria për zbatimin e plotë të këtij ligji, për statusin e drejtat e dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve dhe pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre dhe a ka ndonjë rast ku Inspektorati i punës ka shqiptuar gjoba për shkelje të këtij ligji? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče.

Poštovani ministre,

Dame i gospodo narodni poslanici,

Podsećam vas da zakon broj 04/Z-054 za status i prava boraca, invalida, veterana, pripadnika oslobodilačke vojske, civilnih žrtava i njihovih porodica je objavljen u službenom listu od 31 decembra 2011.godine a stupio je na snagu 15 januara 2012.godine.

Odredbama člana 20 i drugim odredbama ovog pravnog akta predviđeno je donošenje podzakonskih akata od strane Vlade Kosova i nadležnih ministarstva u Vladi.

Prema odredbama tog zakona konkretno člana 20, stava 1, podtačka 1,1 tog zakona, Ministarstvo rada i socijalne zaštite je odgovorna za donošenje ovih propisa, koje smo usvojili, a to su:

- Administrativno uputstvo o postupcima o podnošnju zahteva za ostvarivanja prava utvrđena ovim zakonom, i
- Administrativno uputstvo za procenu i ispitivanje stepena invalida rata OVK i civilnih invalida rata,

- Dok administrativno uputstvo za nadoknadu troškova za sahranu i davanje vojne počasti za smrt veterana, pripadnike invalida OVK, posebno za odobravanje ovog uputstva je suspendovan, jer se još ne zna tačan broj veterana i pripadnika OVK.

Nakon verifikacije tačnog broja ovih kategorija od strane vladine komisije za priznavanje i verifikaciju statusa palih boraca, invalida i veterana, nacionalnih heroja, invalida OVK-a, veterana i nestalih pripadnika OVK, će se odobriti i pomenuto administrativno uputstvo predviđeno članom 20 zakona.

Mi kao ministarstvo ove kategorije pridvedene u zakonu o statusu i pravima palih boraca, invalida, veterana, pripadnika OVK, civilnih žrtava i njihovih porodica, imamo kao prioritet za zapošljavanje i stručno osposobljavanje i reosposobljavanje prema projektima i programima za zapošljavanje kojim upravljamo.

Za sprovođenje ovog zakona su uključena i druga odgovarajuća ministarstva, kao što je obrazovanje, kao što je zdravstvo i tako dalje.

Takođe je važno naglasiti da nacrt-zakona o izmenama i dopunama zakona broj 04/Z o statusu i pravima i palih boraca, invalida, veterana, pripadnika OVK je usvojen na prvom čitanju u Skupštini i trenutno je na proceduri odbora za rad, zaštitu i zdravlje.

Takođe je osnovana i vladina komisija za priznavanje i verifikaciju statusa palih boraca i invalida OVK, veterana i nestalih članova. To je član 15, stav 7...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Deputet, ke pyetje shitesë?

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Faleminderit, i nderuar ministër!

Çështja e numrit të familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve dhe veteranëve të UÇK-së është e rregulluar, një pjesë e gëzojnë këtë status. Çështje problematike është për ata që dëshirojnë të marrin shtesë numrin e veteranëve, do të thotë ka pasur mundësi që Inspektorati i Punës të ketë këto shënime edhe nga shoqatat edhe nga Ministria dhe të bëjë zbatimin e këtij ligji dhe interesi im ka qenë jo për numrin e invalidëve, për arsye se Qeveria e Kosovës dimë që ka bërë mjaft për ta, ka bërë rritjen e pagave edhe për invalidë edhe për familjet e dëshmorëve, por problemi te mospuna e Inspektoratit të Punës, i cili nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për zbatimin e këtij ligji dhe për të dënuar ato institucione, të cilat nuk e respektojnë këtë ligj.

Dhe, Inspektorati i Punës është duke bërë edhe shkelje tjera dhe do t'ju sugjeroja që të merreni pak me punën e tyre, për arsye se ajo çka është tani më shqetësuese është një dënim që ka shqiptuar Inspektorati i Punës për drejtorin e Kirurgjisë së Qendrës Klinike Universitare, edhe pse nuk është punëdhënës për punëtorët e tij, sigurisht do të duhej ta kuptonin inspektoratet e punës, se të gjithë punëtorët e Qendrës Klinike Universitare kanë

kontratë me drejtorin e QKUK-së, ndërsa drejtorët e klinikave janë drejtorë profesionalë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ministër, vazhdo!

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Hvala puno gospodine predsedniče!

Nisam završio samo najbitniju rečenicu, pošto Inspektorijat za rad u ovom momentu ne nadgleda taj zakon, jer nije još u punoj meri usvojen i takođe jedna najbitnija stvar, vi ste u ovom pitanju pitali dali je bilo nekih reakcija inspektorijata za rad. Do sad, do ovog momenta nismo imali nikakve žalbe koje se tiču neimplementisanja ovog projekt-zakona. Prema tome, ukoliko mislite da ih ima određenih kršenja zakona u bilo kojem polju, u bilo kojoj instituciji ja vas pozivam da nam dostavite informacije ili da pošaljete ljude, koji smatraju da su njihova zakonska prava prekršena, i mi ćemo sigurno delovati.

Ali dok u ovom sadašnjem momentu, kao što sam reako, nemamo nijednu prijavu na kršenje ovog zakona ili da prava ovih grupacija ljudi koje sam pomenuo da se na neki način krše. Hvala vam!

KRYETARI: Janë edhe pesë pyetje, por ministrat të cilëve u janë drejtuar pyetjet nuk janë këtu, edhe pse në Raportin e Progresit Qeveria ka marrë vërejtje për shkak të mosgatishmërisë për t'iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve.

Deputeti Afrim Kasolli ka pyetje për ministrin Ramë Buja. Doni ta lexoni pyetjen, deputet? Regjia, fjalën deputetit Afrim Kasolli.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Është hera e dytë që ministri nuk vjen për t'u ballafaquar lidhur me këtë temë, pra do të thotë i shmangët kësaj pyetjeje.

Në vitin 2010 zyrtarë të MASHT-it kishin deklaruar se qytetarë të cilët kishin lëshuar shtëpitë e tyre për nevojat e arsimit shqiptar gjatë viteve të '90-ta do t'u vihej nga një pllakë përkujtimore në shenjë respekti për kontributin e dhënë.

Në vitin 2012, MASHT-i kishte formuar edhe një Komision për identifikimin e të gjitha shtëpive. Ky identifikim kishte rezultuar me një numër prej 3 mijë e 200 kryefamiljarëve, që kishin lëshuar shtëpitë e tyre.

Me një shkresë të veçantë zoti ministër, ju ka drejtuar edhe një qytetar, që gjatë këtyre vjetëve shtëpinë e ka lëshuar për Fakultetin Filologjik, ai është Ahmet Namani, të cilit që nga janari i këtij viti nuk i keni kthyer përgjigje.

Prandaj, pyetja është: Zoti ministër, Kuvendi i Kosovës dhe qytetarët e Kosovës nuk kanë informacion në lidhje me këtë proces dhe këto veprime të Ministrisë, çfarë jeni duke bërë në këtë drejtim? Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Time Kadrijaj, pyetje për ministrin Blerand Stavileci.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar!

Po më vjen keq që është hera e dytë që duhet ta lexoj pyetjen, por pa përgjigje. Pyetja i është drejtuar ministrit të Bujqësisë dhe kaqenë: A iu kanë kompensuar dëmet e shkaktuara nga breshëri në bujqësi në komunën e Gjakovës, Rahovecit dhe Istogut? Ministri, nga komuna dihet se i ka marrë raportet e dëmeve dhe kanë premtuar se do t'ua kompensojnë dëmet e shkaktuara bujqve nga breshëri, mirëpo deri sot asnjë kompensim nuk është bërë. Ndërsa, tash në fushatën zgjedhore kemi parë se zyrtarë të lartë të Qeverisë në fushatën zgjedhore u kanë premtuar subvencione bujqve vetëm për fushatë elektorale, ndërsa dëmet që vërtet është dashur t'u kompensohen nuk ua kanë kompensuar.

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Lirie Kajtazi nuk është këtu. Deputeti Bekim Haxhiu, pyetje për ministrin Besim Beqaj.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Pasi që është hera e tretë që parashtroj të njëjtën pyetje për ministrin Beqaj, po e lexoj. Shpresoj të na dëgjojë ai apo dikush nga Administrata Tatimore.

Sipas Ligjit nr. 04/L-080 për lojërat e fatit ATK-ja subjekteve ekonomike u lëshon licencë për ushtrimin e veprimtarisë së tyre, për lojërat e fatit, lojërat në automate, bastet sportive dhe tombola bingo lokale të mbyllura. Nëse aplikantët i plotësojnë disa kushte dhe njëra ndër to është i rregulluar në nenin 66, 70 dhe 72 të ligjit, është që lojërat e fatit të mos jenë në afërsi të drejtpërdrejtë, së paku 500 metra të objekteve edukativo-arsimore, të institucioneve historike- fetare, dhe pronës komunale.

I nderuar ministër, jemi dëshmitarë, nëse na dëgjon që këto lokale këto lojëra të fatit janë licencuar dhe punojnë në afërsi të objekteve edukativo-arsimore, disa ndodhen mu para dyerve të shkollave dhe ky është një shqetësim i madh.

Mendoj që ATK-ja me rastin e licencimit të lokaleve të lojërave të fatit, të cilat ndodhen më afër se 500 metra, do të thotë nuk do të duhej të bënte licencimin e tyre dhe kërkoj nga Ministria, Administrata Tatimore, që të bëjë zbatimin e plotë të ligjit për lojërat e fatit, i miratuar në Kuvend në muajin maj të vitit 2012 dhe që të mos lejojë që këto lojëra të fatit të jenë funksionale përpara objekteve arsimore. Faleminderit!

KRYETARI: Dhe, pyetja e fundit, deputetja Suzan Novobërdaliu, pyetje për ministrin dhe zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, kryetar!

Unë do ta lexoj pyetjen time.

Më 8 nëntor në Konferencën për Trashëgiminë e Gjykatave Penale Ndërkombëtare në Gjermani, prokurori serb për krime të luftës, Vladimir Vukçević, ndër të tjera ka thënë, citoj: “Të gjithë kemi nevojë për hapa më të shpejtë, më energjikë dhe të pakompromis në ndjekjen e krimeve të luftës”

Sipas njohurive të miya, vetëm në Beograd ndodhen në liri së paku edhe 300 persona, që mund të jenë të dyshuar për krime lufte. Sipas kësaj deklarate mund të konkludojmë se ka mungesë vullneti që hetimet të fillojnë për t'u saktësuar se dyshimet a janë të bazuara apo jo? Deklarata është dhënë nga prokurori i Prokurorisë Speciale për Krime të Luftës në Serbi dhe e njëjta duhet të merret me seriozitet nga institucionet kosovare dhe ndërkombëtare.

Prandaj, në këtë drejtim mua më interesoi se meqë në marrëveshje me Serbinë si pikë e veçantë për diskutim është paraparë edhe çështja e personave të pagjetur, në lidhje me këtë deklaratë se a janë ndërmarrë hapa nga institucionet tona tek institucionet ndërkombëtare, cilat janë ato dhe nëse nuk janë ndërmarrë, pse nuk janë ndërmarrë? Faleminderit!

KRYETARI: Edhe kjo pikë e rendit të ditës ka përfunduar. Kemi pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Miratimi i procesverbaleve të seancave të mëparshme

Pyes nëse keni vërejtje në procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 12, 19, 26 shtator dhe 2 tetor 2013?

Të pranishëm janë 69 deputetë. Nëse nuk ka vërejtje, konstatoj se Kuvendi i miratoi procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 12, 19, 26 shtator dhe 2 tetor 2013.

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, zëvendëskryeministrin Bujar Bukoshi, që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI BUJAR BUKOSHI: I nderuar zoti kryetar,

Të nderuara deputete dhe deputetë,

Kolegë ministra,

Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni që në emër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, shkurtimisht të paraqes arsyet për ndryshimin e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës nr. 03/L-229.

Arsyeja për ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji është përmbushja e objektivave të Qeverisë së Kosovës në fushën e konkurrencës, ku pas hyrjes në fuqi të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, gjegjësisht gjatë zbatimit të tij në praktikë, është hasur në disa pengesa dhe vështirësi të natyrës administrative dhe procedurale.

Po ashtu, qëllimi i ndryshimit të këtij ligji është evitimi i vërejtjes së bërë nga Komisioni Evropian në raportin e studimit të fizibilitetit për Ligjin për konkurrencën lidhur me keqpërdorimin e pozitës dominuese.

Ky projektligj është hartuar në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe është marrë parasysh vërejtja e përmendur nga Komisioni Evropian.

Në këtë projektligj ka disa risi, por do t'i përmendja risitë kryesore:

- Dispozita rreth abuzimit të pozitës dominuese.

Edhe nëse veprojnë dy ndërmarrje dhe pjesëmarrja e tyre në treg kalon 60%, dy ose më shumë ndërmarrje të pavarura mund të jenë në pozitë dominuese nëse në raport me konkurrentët e tyre, veprojnë bashkërisht në treg.

Supozohet se dy ose më shumë ndërmarrje kanë pozitë dominuese në treg të mallrave dhe shërbimeve dhe pjesëmarrja e përgjithshme e tyre në treg kalon 60% apo më shumë. Ky është pra dominimi kolektiv.

Në këtë projektligj është paraparë edhe

- Përgjegjësia e personave përgjegjës.

Nëse provohet se personi përgjegjës i ndërmarrjes është i involvuar në shkeljet, që parashihen me këtë ligj dhe nëse është i përfshirë në marrëveshje të ndaluara.

Gjithashtu kanë ndryshuar edhe disa dispozita për Autoritetin e konkurrencës së Kosovës, ku përcaktohen qartë kompetencat e Autoritetit dhe evitohen të gjitha pengesat administrative dhe rregulluese, që do ta pengonin funksionimin e punës së Autoritetit, duke përfshirë edhe Sekretariatit e tij.

Po ashtu definohet në mënyrë të qartë gjykata që është kompetente me rastin e inicimit të padisë kundër vendimeve të Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës dhe sipas këtij projektligji është Gjykata kompetente për çështje administrative.

Vendimet e Autoritetit të konkurrencës kanë efekt suspensiv, pra pezullues derisa të vendosë gjykata kompetente për çështje administrative.

Neni 25 i këtij projektligji parasheh: “inicimi i konfliktit administrativ e ndalon ekzekutimin e vendimit”. Kjo është paraparë me qëllim që të mbrohen ndërmarrjet nga vendimet e Autoritetit, derisa për një çështje të vendosë Gjykata.

Zonja dhe zotërinj,

Projektligji është hartuar në përputhje me procedurat e parapara me Rregulloren e Qeverisë së Kosovës dhe është pranuar deklarata financiare nga Ministria e Financave dhe deklarata e pajtueshmërisë me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij projektligji në fushën e konkurrencës dhe me qëllim që fusha e konkurrencës të rregullohet sa më mirë, që të kemi një konkurrencë të shëndoshë, të drejtë dhe të ndershme dhe se projektligji i propozuar është në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare dhe evropiane, ju propozojmë që ta miratoni këtë projektligj. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Radha është e kryetarit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, zotit Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zotëri zëvendëskryeministër,

Ministra,

Kolegë deputetë,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri ka trajtuar këtë projektligj në mbledhjen e mbajtur të datës 1.10.2013 dhe rrjedhimisht në përputhje me nenin 54 të Rregullores së Kuvendit i rekomandon Kuvendit për miratim në parim këtë projektligj.

Dëshiroj t'ua përkujtoj që Komisioni e ka trajtuar edhe në mënyrë tjetër monitorimin e zbatimit të Ligjit të konkurrencës dhe punën e funksionimit të këtij Komisioni, gjatë periudhës që e kemi lënë pas sivjet. Më vjen mirë që ka një reagim të shpejtë të Qeverisë për sa i përket rekomandimeve të Komisionit Evropian dhe që kanë të bëjnë kryesisht me çështjen e abuzimit të pozitës dominuese, por rrjedhimisht dëshiroj të theksoj që komisioni dhe Kuvendi i kanë nxjerrë disa rekomandime dhe do të ishte mirë të reflektojnë edhe vetë Kuvendi me kompetencat që i ka në mbikëqyrjen e këtij Komisioni edhe Qeveria në zbatimin e këtyre rekomandimeve, sepse jo vetëm këto çështje që i shtrun Komisioni Evropian, por edhe çështje të tjera janë shumë të ndjeshme për funksionimin e këtij Komisioni.

Ne do ta bëjmë punën tonë, sa më shpejt që të jetë e mundur si Komision, besoj që do të kemi të njëjtin disponim të gjithë deputetët e Kuvendit për funksionimin sa më të mirë të këtij institucioni të rëndësishëm për zhvillimin e vendit, rrjedhimisht të ekonomisë. Por, kisha apeluar te Qeveria, meqenëse e kam fjalën tash, që të kujdeset edhe për çështje të tjera që i ka në kompetencën e saj, për funksionimin e këtij Komisioni, ta zëmë nëpërmjet Ministrisë së Administratës Publike të bëjë diçka për hapësirat që t'i gjejë një vend ose zyra këtij Komisioni, që janë çështjet ndoshta më banale që mund të jenë karshi ligjit e funksionimit në tërësi të këtij institucioni, po ky mekanizëm nuk ka hapësira ku do të punonte dhe do të ishte mirë që t'i krijohen kushte, që Qeveria të bëjë diçka t'i krijojë të paktën një mundësi logjistike këtij Komisioni dhe ne të bëjmë ndryshimin e ligjit dhe rrjedhimisht, ky institucion të funksionalizohet sa më mirë, sepse tash aktualisht ata kanë mungesë të anëtarëve të bordit, kanë mungesë të hapësirës dhe nuk mendoj që tash ata po funksionojnë mirë.

Unë nuk e di qysh do të dalin rekomandimet tjera të Komisionit Evropian për këtë institucion, nëse nuk ndërmarrim diçka urgjentisht. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zonja Sala Berisha-Shala e ka fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje Kabinet Qeveritar,

Kolegë dhe kolege deputetë dhe ju të pranishëm,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka analizuar me vëmendje plotësim-ndryshimin e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Projektligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës sjell disa ndryshime në Ligjin bazik për mbrojtjen e konkurrencës dhe sidomos në pjesën që ka të bëjë me funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës. Projektligji sjell disa lehtësira për kompanitë dhe në anën tjetër krijon gjokat çka i mungonte më parë ligjit paraprak.

Vlen të theksohet se në Raportin e fundit të Progresit, domethënë në tetor të këtij viti, thuhet që Autoriteti ka pasur vështirësi në funksionimin e tij dhe se nevojitet progresi i mëtejshëm i këtij Autoriteti. Ligji për konkurrencën është pjesërisht në përputhje me ‘acquis communautaire’ dhe në memorandum shpjegues është thënë që ndryshimet janë bërë edhe për të përfshirë një varg direktivash të Bashkimit Evropian.

Përafrimi i Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës me standardet evropiane dhe ndërkombëtare, respektivisht me direktivat e BE-së dhe ‘acquis communautaire’ është atribut i drejtëpërdrejtë i dalë konform rekomandimeve të Raportit të Progresit për vitin 2012.

Projektligji për mbrojtjen e konkurrencës është përafruar me legjislacionin e BE-së, si dhe janë inkorporuar një varg aktesh ligjore të Bashkimit Evropian.

Nëse analizojmë përmbajtjen e projektligjit vërejmë që ky ndryshim-plotësim sjell më shumë lehtësira për kompanitë, çka na mbetet neve në grupin punues në Komisionin Parlamentar që t’i analizojmë me vëmendje këto ndryshime. Për shembull, projektligji shton edhe nenin 7a që flet për përjashtimet grupore dhe kushtet që marrëveshjet duhet t’i plotësojnë për të qenë të përjashtuara nga ndalesat e përgjithshme.

Në këtë mënyrë edhe marrëveshjet grupore do të mund të jenë objekt i heqjes së ndalesave të përgjithshme, nëse plotësojnë disa kushte.

Ndryshim tjetër, neni 9 i ligjit bazik është ndryshuar në atë mënyrë që ka mbetur vetëm një paragraf dhe janë hequr 9 paragrafë të tjerë. Këto pika flisnin mbi përmbajtjen e aplikacionit për lejim, përjashtimit, kufizimin e kohës prej 3 vjetësh për përjashtimin dhe për mundësi të refuzimit të aplikimit.

Një tjetër ndryshim me rëndësi që sjell projektligji i ri është sa i përket ndryshimit të nenit 10 të ligjit bazik, përkatësisht pikës 3 të tij, ku në ligjin aktual thuhet dy ose më

shumë ndërmarrje të pavarura mund të jenë në pozitë dominuese nëse në raport me konkurrentët e tyre veprojnë bashkërisht në treg.

Ndërsa, ndryshimi në draftin që e kemi tani, thuhet se dy ose më shumë ndërmarrje të pavarura mund të jenë në pozitë dominuese, nëse në raport me konkurrentët e tyre veprojnë bashkërisht në treg. Supozohet se dy ose më shumë ndërmarrje kanë pozitë dominuese në treg të mallrave dhe shërbimeve dhe pjesëmarrja e përgjithshme e tyre në treg kalon 60% apo më shumë dominim kolektiv, çka na mbetet prapë ne si grup punues të analizojmë shumë detaje se a do të jetë kjo në favor të qytetarit apo do të jetë një favor i njëanshëm vetëm i kompanive?

Ky konsiderim i bazuar në këtë paragraf nuk është i aplikueshëm, në rast se ndërmarrjet në fjalë bindshëm tregojnë se kushtet e konkurrencës kërkojnë, që ato të mbajnë konkurrencë të konsiderueshme ndërmjet vete, ose që nuk kanë bashkërisht pozitë dominuese në treg, në krahasim me konkurrentët tjerë që i kanë, duke marrë parasysh faktorët e specifikuar paragrafi 1 të këtij neni.

Projektligji i ri pra, do t'i konsiderojë në pozitë dominuese dy e më shumë ndërmarrje, nëse pjesëmarrja e përgjithshme në treg kalon 60% ose më shumë të tregut dhe jo sikurse ligji aktual në fuqi, që konsiderohet me pozitë dominuese çdo marrëveshje me të cilën dy e më tepër palë veprojnë bashkërisht në treg ndaj konkurrentëve të tjerë.

Projektligji ka specifikuar gjobat për dallim nga ligji aktual, që nuk kishte një gjë të tillë. Tek masat ndëshkuese nga neni 56, paragrafi 1 i ligjit bazik, masa prej 10% është ulur në 7% të të hyrave të përgjithshme. Edhe kjo masë është masë lehtësuese për bizneset në treg, kështu që i ndihmon një ambienti të favorshëm të të bërit biznes në Kosovë.

Ne si grup parlamentar do ta përkrahim në parim dhe kontributin tonë do ta japim në fazën e amendamentimit. Faleminderit!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e Grupit Parlamentar të LDK-së. Fjalën e ka zoti Zharku.

LUTFI ZHARKU: I nderuar nënkryetar,

Të nderuar kolegë,

Të nderuar ministra,

Ligji ka të bëjë me një agjenci që faktikisht ka probleme të shumta dhe është mirë që projektligjin e kemi sot në shqyrtim. Megjithatë të themi, përkundër atyre problemeve që i kemi në Autoritetin e Konkurrencës, projektligji i propozuar nuk i adreson saktësisht çështjet me të cilat po përballet Agjencia.

Unë do t'i ndaj ato çështje të themi në pjesën e parë, që kanë të bëjnë me çështjet administrative, me probleme që janë aktuale dhe nga të cilat rrjedh ky jofunksionalitet i Autoritetit, e që kanë të bëjnë me udhëheqjen dhe organizimin e Autoritetit.

Projektligji i propozuar përsëri themi nuk i përcakton se cilat janë kompetencat e kryetarit dhe Autoritetit si trup kolegjal në raport me administratën, çfarë autoriteti ekzekutiv ka kryetari apo të themi sekretari i Autoritetit, kush e menaxhon administratën e Autoritetit?

Kur e lexon ligjin le të nënkuptohet sikur janë dy administrata, njëra është profesionale kurse tjetra joprofesionale, kështu që nuk kemi një njësim me një organizim të pastër.

Në anën tjetër themi për Autoritetin nuk vlen Ligji për shërbyesit civilë, por vlen Ligji i punës. Cila është arsyeja që për disa punëtorë të një agjencie, që është në kuptimin themi agjenci sikurse agjencitë tjera, të vlejë një ligj tjetër, kurse të mos vlejë Ligji mbi shërbyesit civilë?

Çka është më tutje, të thuhet se kryetari dhe anëtarët e Autoritetit nuk janë nëpunës shtetëror, që në parim nuk besoj se është një zgjidhje apo të mos them, është një përkufizimi i pakuptimtë. Në anën tjetër, zgjedhja e anëtarëve të Autoritetit thuhet që është jopolitik, por lihet një kufizim themi që së paku gjashtë muajt e fundit ata njerëz të mos jenë marrë me politikë. Çfarë garancie apo çfarë baze është ajo që dikush është jopolitik, nëse veç gjashtë muajt e fundit s'është marrë me politikë. Më mirë është të themi është politik, apo anëtarët mund të jenë të partive politike e jo të bëhet lojë me ligjin.

Në anën tjetër zgjedhja e kryetarit dhe themi e anëtarëve dhe nënkryetarit nuk është uniforme. Kryetarin e propozon Qeveria dhe anëtarët i propozon Qeveria dhe zgjidhen nga Parlamenti, kurse nënkryetarin duhet ta propozojë kryetari apo ndonjë anëtar. Cila është arsyeja? Nuk ka ndonjë arsye logjike që t' i bëjmë këto ndarje apo të krijojmë një jo uniformitet në ligj.

Sa i përket asaj që është thelbësore për rregullimin e konkurrencës, është çështja e përqendrimeve, pra është shumë indikative pse disa çështje që përjashtohen nga përqendrimet janë përmendur në ligj. Po i përmend disa.

Shpërndarja dhe servisimi i automjeteve nuk është veprimtari që duhet ta ketë një rëndësi të posaçme, që të futet në ligj. Them janë indikative, kush janë ato kompani, cilat janë ato kompani që merren me këtë, përndryshe, auto-serviset, shpërndarja e automjeteve nuk është çështje që duhet në parim të përjashtohet nga përqendrimi;

Sigurimi i automjeteve, është çështje e njëjtë. Ne e kemi vetëm një rast që Autoriteti është marrë me sigurime të automjeteve.

Marrëveshjet në sektorin e transportit, është shumë, të mos them absurde, por është e pakuptimtë marrëveshja në sektorin e transportit të përjashtohet nga përqendrimet. Domethënë, që përcaktohen tri apo katër lëmi, të cilat janë shumë indikative, pse ato marrëveshje duhet përjashtuar prej përqendrimeve.

Në fund, themi kemi raste kur dy ndërmarrje kanë mbi 60% të tregut, por nëse ato janë në konkurrencë të drejtpërdrejtë, edhe pse e tejkalojnë 60% të tregut, mund të mos konsiderohen si subjekt i autoritetit. Në realitet, nuk merret edhe ana tjetër, nëse e kemi një prodhues dhe kemi importues të të njëjtit mall të kompanive të njëjta, cili është ai rast? Mund ta kemi një prodhues në Kosovë dhe shumë prodhues jashtë Kosovës, të cilët në parim kontrollohen nga një kompani amë. Në realitet, edhe ai është dominim i tregut, edhe ajo është pozitë dominuese, pavarësisht pse kompania vendore nuk e dominon tregun, por e dominon kompania e huaj, kështu që nuk është e rregulluar.

Në fund, themi është përcaktuese në të gjitha këto raste - barra mbi përcaktimin e pozitës dominuese i bie autoritetit. Çdo herë do të kemi probleme në përcaktimin strikt të asaj, a është 60% apo 59,9%, apo 61%.

Kështu që të themi, duhet ta kemi një liri më të madhe të autoritetit që ta përcaktojë pozitën dominuese. Kurse, në anën tjetër, nuk duhet apriori të përcaktohen se cilat janë lëmitë, cilat mund të përjashtohen nga përqendrimi. Është edhe një dispozitë tjetër që është pak në kundërshtim me logjikën e funksionimit edhe të institucioneve.

Thuhet që autoriteti i bën propozimet për udhëzime administrative, të cilat i aprovon Qeveria. Nëse autoriteti i përgjigjet Kuvendit, atëherë të gjitha udhëzimet e tij, apo çfarëdo vendimi i tij duhet të kalojë nëpërmjet Kuvendit. Nuk duhet të kthehet te Qeveria, se ajo i bie indirekt që nuk e kemi një pavarësi të autoritetit, por e kemi një varshmëri drejtpërdrejt nga Qeveria.

Unë nuk kam problem që autoriteti t'i mbetet Qeverisë, por nëse i mbetet Qeverisë le t'i mbetet Qeverisë, nëse i mbetet Kuvendit le t'i mbetet Kuvendit. Por, jo një përzierje e kompetencave që çon në një jofunksionalitet të skajshëm të autoritetit.

Në parim, përkundër të gjitha këtyre vërejtjeve që i kemi në projektligjin e ri, LDK-ja do ta votojë, me shpresë që në Komision do të përmirësohen të gjitha këto çështje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, kryetari Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, nënkryetar!

Është e vërtetë që kjo agjenci dhe ky ligj kanë pasur shumë probleme edhe në zbatimin e tij, por edhe vetë funksionalizimi i mirëfilltë i agjencisë ka hasur në shumë vështirësi prej se është themeluar dhe mendoj që këtu, të them ashtu - përgjegjësinë kryesore e ka pasur mungesa e vullnetit politik nga Qeverisë, veçanërisht për ta funksionalizuar këtë autoritet kaq të rëndësishëm për mbarrëvajtjen e tregut në Kosovë, dhe kjo nuk është se po e them vetëm unë, por e kanë thënë disa herë madje edhe ish-anëtarët e këtij Komisioni, edhe nëpunës në të, të cilët kanë hasur në probleme të shumta, veçanërisht në komunikimin me Qeverinë dhe në obligimet që Qeveria është dashur t'i kryejë karshi tyre.

Ligji ose plotësim-ndryshimi i ligjit bazik për konkurrencën në Kosovë i ka disa të meta jashtëzakonisht të dëmshme, konsideroj unë, të cilat pak a shumë deri tash u përmendën, por mendoj që duhet t'i përmend edhe një herë.

Një prej atyre të metave që është edhe i pakuptimtë, por edhe i dëmshëm, konsideroj ky neni 7a, që i shtohet tash rishtazi ligjit, i cili në këtë plotësim-ndryshim është i renditur si neni 4, i përjashtimeve grupeve, të cilat, përveç atyre që i përmendi zoti Zharku, me të cilat pajtohem, e kisha theksuar edhe këtë 2.3, që nuk u përmend deri tash. Pra, marrëveshjet grupeve që përjashtohen mund të jenë edhe marrëveshje mbi transferin e teknologjive dhe kjo në një farë kuptimi mund ta ketë një arsyeim pse duhet të përjashtohet transferi i teknologjive, por pastaj kjo edhe mund ta ketë edhe kuptimin shumë të gjerë për mënyrën se si është përmendur këtu në ligj, për shembull transferi i teknologjive mund të konsiderohet edhe ka arka fiskale, të cilat u shiten ndërmarrjeve, bizneseve në Kosovë, e i cili është kryekëput treg i monopolizuar dhe i cili po u kushton shumë shtrenjtë bizneseve.

Pra, nëse kjo llogaritet si transfer i teknologjive, e mund të llogaritet si transfer i teknologjisë, atëherë kjo po e dëmton dhe do ta dëmtojë vazhdimisht tregun, edhe biznesin në Kosovë, dhe në njëfarë mënyre nuk po u lë asnjë derë hapur këtyre bizneseve që ta kenë sadopak një mundësi ankese.

Çështja tjetër që ndryshon tash në ligj, mendoj që në njëfarë mënyre e prek raportin që Kuvendi dhe Qeveria e kanë me këtë autoritet, por duke i bërë disa ndryshime. Për shembull, te kryetari dhe anëtarët e Komisionit, përpara ka qenë që Qeveria i zgjedh nëpërmjet një konkursi të hapur, ndërkohë që tash me ndryshim thuhet që vetëm i propozon për emërim apo riemërim, e nuk përmendet fare konkursi i hapur. Kjo në njëfarë mënyre ia lë duart pastaj të lira të Qeverisë që të propozojë këdo aty, pa e çarë kokën fare për profesionalizmin dhe integritetin e personave që propozohen. Pra, mendoj që kjo duhet të mbetet siç ka qenë në ligj, që këta persona për bordin e këtij Komisioni të zgjidhen nëpërmjet një konkursi të hapur, në mënyrë që ta kemi një lloj garancie sado formale të rritjes së profesionalizmit të njerëzve që emërohen aty dhe pastaj natyrisht që këta të emërohen nga Kuvendi.

Ndërkohë që, në anën tjetër, është një ndryshim do të kisha thënë pozitiv, i cili e ndryshon pikën që ka të bëjë me shkarkimin e kryetarit dhe e anëtarëve të Komisionit. Në ligjin bazik, ky shkarkim ka qenë i mundshëm vetëm me propozim të Qeverisë, ndërkohë që tash me këtë ndryshim shkarkimi mund të bëhet me shumicë votash drejtpërdrejt nga Kuvendi, që mendoj që ia rrit rolin Kuvendit karshi këtij komisioni dhe është për t'u përshëndetur dhe natyrisht është i pranueshëm.

Një gjë të cilën kisha dashur ta ngre këtu, e cila konsideroj që është jashtëzakonisht e papranueshme, është ulja e masës ndëshkimore prej 10% në 7%. Mendoj që kjo në asnjë mënyrë nuk bën të ndodhë, sepse sado që t'i ulim ne masat ndëshkimore, vetëm sa e inkurajojmë shkeljen e ligjit.

Pra, masa ndëshkimore nuk është për ta dëmtuar biznesin, duhet ta kuptojmë këtë një herë e përgjithmonë. Masa ndëshkimore vihet në mënyrë që ta mbrojtë ligjin. Prandaj, edhe janë këto masa dhe duhet të jenë të larta. Pra, këtu, në njëfarë mënyre, kur flasim për gjokat dhe për masat ndëshkimore, kam dëgjuar edhe nga deputetë tjerë, nisen nga një supozim që ligji gjithsesi do të shkelet, por të mos i ndëshkojmë shumë ata që e shkelin. Jo. Ne duhet të nisemi nga supozimi që ligji në asnjë mënyrë nuk bën të shkelet. Dhe, për ta mbrojtur ligjin nga shkeljet duhet të caktojmë masa ndëshkimore, të cilat vërtet e dekurajojnë shkeljen e ligjit, e me uljen e masave ndëshkimore natyrisht që nuk e dekurajojmë shkeljen e ligjit, por e inkurajojmë shkeljen e ligjit dhe Kuvendi nuk do ta lejojë një gjë të tillë.

Pra, këto janë disa prej vërejtjeve që ne i kemi në këtë plotësim-ndryshim në ligj. Do ta votojmë ligjin në këtë lexim të parë, mirëpo po që se këto ndryshime nuk pranohen nëpërmjet Komisionit, atëherë natyrisht që do të jemi kundër në leximin e dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka zoti Kelmendi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së.

RAMIZ KELMENDI: Faleminderit, nënkryetar!

Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah në parim këtë projektligj dhe do të jetë aktiv në komisione që ky ligj të jetë në shërbim të mbrojtjes së konkurrencës.

Prandaj, i ftoj anëtarët e Grupit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës që ta përkrahin këtë ligj.

KRYESUESI: Faleminderit! Koalicioni për Kosovë të Re, kryetarja e Grupit, Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Koalicioni për Kosovën e Re e ka shqyrtuar Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Duke marrë parasysh se edhe si Komision Parlamentar kemi bërë monitorimin e këtij ligji dhe kemi parë që në qasjen e implementimit të këtij ligji ka mangësi të mëdha, e sidomos te çështja e Agjencisë Kosovare të Konkurrencës, që është formuar thuajse në mandatin e kaluar, mirëpo tash po shihet që formimi i asaj agjencie definitivisht gjatë funksionimit të saj nuk e ka pasur rolin çfarë e ka pasur edhe me ligj. Mirëpo, edhe dispozitat të cilat i janë caktua me ligjin e atëhershëm, shihet që ka mangësi.

Mirëpo, edhe tani me këtë ligj, u tha edhe nga kolegët, duhet të precizohet ekskluzivisht çështja e funksionimit të Agjencisë Kosovare të Konkurrencës, meqë është një agjenci më e rëndësishme edhe në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Agjenci e cila duhet t'i raportojë Kuvendit të Kosovës, mirëpo kjo të bëhet në mënyrë të qartë. Çështje tjetër është çështja e marrëveshjeve në sektorë, që edhe parafolësit e theksuan. Ne duhet të kemi kujdes në këtë projektligj, duke u bazuar në bazë të Kushtetutës së

Republikës së Kosovës, e cila thotë se Kosova është ekonomi të lirë të tregut dhe për konkurrencë.

Në rast se Kosova është për ekonomi të lirë të tregut dhe për konkurrencë, atëherë duhet të shohim se cilat marrëveshje duhet të dënohen dhe cilat nuk duhet të dënohen, që janë duke zhvillua monopol në Kosovë.

Në përgjithësi ka shumë nene, të cilat duhet të riformulohen. Mirëpo, Koalicioni për Kosovë të Re i jep përkrahje këtij ligji dhe besoj që gjatë amendamentimit në Komisionin Parlamentar do të arrihet që ta kemi një ligj, i cili do të jetë viza-vijë me ligjet e BE-së.

Dhe, njëkohësisht, në fjalimin tim kërkoj që fushata zgjedhore, e cila po bëhet për balotazh të mos implementohet në Kuvendin e Kosovës, ndërsa debatet televizive të zhvillohen në debat dhe kush ka dalë fitues në zgjedhjet e 3 nëntorit, e kush do të dalë humbës dhe do të ketë nevojë për punë, atëherë do të shihemi pas 1 dhjetorit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “6+”, zoti Kinolli.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar projektligjin në fjalë, përkatësisht plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Ne në parim e përkrahim këtë projektligji, ndërsa kontributin tonë do ta japim gjatë punës së Komisionit. Faleminderit!

KRYEXUESI: Faleminderit! “Zajednička Budućnost”, zonja Kostiq.

BISERKA KOSTIĆ: Zahvaljuje potpredsedniće!

Na samom početku želim da isteknem svoju zabrinutost i zabrinutost naše parlamentarne grupe vezano sa sastav borde, bord koji još uvek nije kompletiran, i to već traje duži vremenski period, samim tim i sastav borda koji u svom sastavu nema pripadnike nevećinskih zajednica, a i samim tim uslovi u kojima radi bord su poprilično neadekvatni.

Parlamentarna grupa “Zajednička Budućnost” je razmatrala Nacrta zakona o zaštiti konkurencije. Identifikovali smo niz jezičkih i gramatičkih neispravnosti, što bitno i suštinskih menja značaj određenih članova u samom zakonu.

Recimo posebnu pažnju treba obratiti na reči svako fizičko lice, jer to podrazumeva sve građane, čak i oni koji nemaju registrovani biznis. Međutim mnogo logični bi bilo da stoji reč “preduzetnik”, što podrazumeva fizička lica koja imaju registrovan biznis.

Ovde ostaje na tome da trebamo da videti sa predlagačem Zakona šta je želeo reći u ovom članom, ako je želeo da obuhvati sva pravna lica i fizička lica, bez obzira da li su registrovani za biznis, ili ne, onda je to veoma široka formulacija i nema smisla.

U pitanju je veliki broj jezičkih ne ispravnosti, kao što sam i na samom početku rekla što se tiče srpske verzije. Međutim, u srpskoj verziji predložićemo jedan amandman, koji će zahtevati da se čitav Nacrta zakon i verzija na srpskom jeziku ispravi, kako bi se uskladila sve tri verzije, i ono što želim da naglasim da ispravka srpske verzije neće suštinski menjati albansku, niti englesku verziju.

Parlamentarna grupa “Zajednička Budućnost” podržaće u načelu zakon, a kasnije će administraciji dostaviti svoje predloge. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Afërdita Berisha-Shaqiri.

AFËRDITA BERISHA-SHAQIRI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Duke u nisur nga objektivat kryesore të së drejtës së konkurrencës të BE-së, siç janë ruajtja e transparencës dhe unifikimi i tregut të brendshëm, sigurimi i efikasitetit ekonomik në treg, si dhe mbrojtja e konsumatorëve, nxitja e zhvillimit ekonomik, ofrimi i shërbimeve dhe produkteve të konsumatorëve me çmime më të ulëta dhe kualitet më të lartë, mendoj se trajtimi dhe implementimi i mirë i këtij ligji do të ndikojë në vendosjen e rregullave të një konkurrence të mirëfilltë dhe të nevojshme për funksionimin e tregut, sepse asnjë biznes nuk ekziston në vakuum dhe asnjë biznesi nuk i mungon konkurrenca.

Konkurrenca është bazë e mirë për një sistem të lirë të ndërmarrësisë. Ajo është e pranishme në të gjithë komponentët e tregut, duke filluar nga çmimi, lloji dhe kualiteti i produktit, sasia dhe deri te metodat e distribuimit dhe shpërndarjes së produkteve dhe shërbimeve të konsumatorit.

Është i rëndësishëm trajtimi i mirë dhe pastaj implementimi i këtij ligji, sepse njëra nga frazat më të shpeshta të dëgjuara në Kosovë është konkurrenca jo fer, konkurrenca e padrejtë. Kjo frazë u referohet më së shumti atyre, të cilët futin dhe nxjerrin mall në Kosovë, duke iu shmangur tatimeve.

Tash, përderisa nuk ekziston një ligj i mirë dhe me masa ndëshkuese, që në këtë projektligj janë paraparë të ulen nga 10 në 7%, siç theksoi dhe kolegu Ymeri, atëherë për të mbetur në treg të gjithë mendojnë t’i përshtaten kësaj sjelljeje të padrejtë.

Në botën moderne të tregut të lirë, që po pretendojmë të futemi edhe ne, konkurrenca jo vetëm që duhet të jetë e pritur, por ajo gjithashtu duhet të jetë e përkrahur nga të gjitha institucionet.

Të gjitha mënyrat e konkurrencës ekzistojnë në treg dhe bizneset e suksesshme e gjejnë mënyrën t'i kapërcejnë, natyrisht duke iu përmbajtur rregullave të lojës.

Ekonomia jonë në të ardhmen do të jetë e udhëhequr nga kërkesat. Ata të cilët nuk e kuptojnë forcën e ndryshimit do të mbeten pa biznes. Konkurrencë nuk është, ose nuk janë vetëm ata që e ofrojnë produktin e njëjtë, apo shërbimet vetëm në bazë të çmimit, por ajo përkufizohet më gjerësisht. Pra, përfshin të gjitha mënyrat që mund të shërbejnë për nevojat e blerësit, që do të thotë edhe mënyra tjera që blerësi mund t'i shpenzojë paratë e njëjta.

Dhe, në fund, me analizë reale të konkurrencës në tërësi arrihen vendime më të mira për investime kapitale. Reagim më të mirë në një ambient afarist, vendime më të mira për marketing e të tjera.

Prandaj, duhet krijuar një bazë të mirë ligjore dhe efikase me standarde evropiane dhe ndërkombëtare për mbrojtjen nga konkurrenca joligjore, sepse edhe në Raportin e fundit të Progresit thuhet se Autoriteti Kosovar i Konkurrencës duhet të vazhdojë ta rrisë kapacitetin e tij, sidomos sa i përket ekspertizës dhe përvojës së stafit.

Gjithashtu, thuhet se autoriteti është i vendosur në ndërtesën e Kuvendit, e nuk ka lokale të veta. Rekomandohet gjithashtu që menaxhimi i autoritetit dhe procedurat e tij të përmirësohen në mënyrë të konsiderueshme, duke shpresuar në një shqyrtim dhe trajtim të mirë të këtij projektligji që do t'i bëjnë anëtarët e këtij Komisioni, që ky ligj të jetë i zbatueshëm në praktikë për një funksionim sa më të mirë të tregut në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Deshishku.

HASHIM DESHISHKU: Faleminderit, i nderuar kryesues i Kuvendit, zoti Haliti, Të nderuar ministra, Të nderuar deputetë dhe deputete, Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës, Jemi dëshmitarë të faktit se ndonëse ishte qëllimi i mirë për themelimin e Autoritetit të Konkurrencës, ai në asnjë moment nuk ka arritur që të jetë në nivel të detyrës. Puna e tij është e peshuar me parregullsi.

Qasja e tij shpesh ka qenë nën ndikimin e tendencave të individëve brenda bordit. Ka ndërmarrë masat dhe ka njoftuar biznese pa grumbulluar fakte të mjaftueshme dhe të qëndrueshme dhe ka ndodhur që vendimet e tij të merren në bazë të supozimeve.

Me këtë e ka lënduar besueshmërinë dhe integritetin e subjekteve afariste në treg. Ky është një ambient që e bën më se të domosdoshëm ndryshimin e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, por edhe forcimin e përgjegjësisë së anëtarëve, tash të komisionit, në mënyrë që puna e tyre vërtet të jetë në funksion të mbrojtjes së konkurrencës, e jo të individëve dhe të pozicioneve të subjekteve të caktuara në treg.

Propozimet e dhëna i japin një bazë që të shpresojmë se gjërat në punën e këtij komisioni do të ndryshojnë, madje me qëllim që kjo të arrihet në një nivel më të lartë.

Mendoj se ligji ka nevojë edhe për ndërhyrje të tjera, që nuk parashihen në propozimin për plotësim-ndryshimin e ligjit bazikë.

Po nisi nga neni 7a, i cili i definon autorizimet e Qeverisë për përcaktimin e kushteve për përjashtimet grupore. Të gjitha pikat në paragrafin e dytë të këtij ligji janë të diskutueshme, meqenëse në mënyrën si janë prezantuar Qeverisë i lejojnë hapësirë për ndërhyrjen në sektorët e ndryshëm të tregut, posaçërisht kur është në pyetje shpërndarja dhe servisi i automjeteve, sektori i sigurimeve dhe ai i transportit.

Kjo lë mundësinë që një subjekti t'i krijohen rrethana për pozitë monopolistike dhe dominuese në treg, apo në ndonjë formë të njëjtë të favorizuar nga autoritetet shtetërore, siç po ndodh aktualisht me homologimin e automjeteve.

Prandaj, këto gjëra duhet t'i rregullojë tregu dhe konkurrenca. Në rast të shkeljes së ligjeve apo dëmtimit të konkurrencës ekziston autoriteti që mund të ndërhyjë.

Plotësimi i nenit 26, nënparagrafi 3.3, është konfuz dhe i paqartë.

Këtu bëhet fjalë për rrethanat në të cilat dikush nuk mund t'i zgjidhë anëtarët e autoritetit. Aty thuhet: “Është i dënuar për vepra penale që i bën të papërshtatshme ushtrimin e veprimtarisë të kryetarëve dhe anëtarëve të komisionit”.

Këtu nuk dihet se për cilat vepra bëhet fjalë, e kjo i mundëson një autoriteti, qoftë edhe individual, që të bëjë përcaktimin e veprës dhe në bazë të kësaj edhe eliminimin e kandidatëve.

Vlerësoj se zgjedhja më e mirë ka qenë që ajo që parashihet në ligjin bazik, që i përjashton ata, kanë qenë të dënuar për vepër penale me 6 muaj burgim.

Te neni 14 i propozimit, që ka të bëjë me nenin 27, nënparagrafi 1.2 të ligjit bazikë thuhet se kryetari ose anëtarët shkarkohen, nëse dënohen për vepër penale. Kjo ua lejon anëtarëve dhe kryetarit që ta ushtrojnë detyrën deri në momentin kur një vendim gjyqësor bëhet i plotfuqishëm. Mirëpo, sikur është harruar krejt se këtu kemi të bëjmë me një autoritet tejet të rëndësishëm dhe shumë të ndjeshëm për marrëdhëniet në treg.

Për këtë arsye, anëtarët dhe kryetari nuk guxojnë të veprojnë në periudhën derisa ka dyshime se janë përzier në punët e paligjshme.

Nëse vazhdojnë me këtë supozim, ata do të kenë mungesë kredibiliteti, por edhe mund të jenë lehtë të shantazhueshëm gjatë kryerjes së punës.

Propozoj që shkarkimi apo së paku suspendimi i këtyre të bëhet në momentin ku konfirmohet aktakuza ndaj tyre.

Kjo zgjedhje tash e bën të panevojshëm paragrafin 1.5, që duhet t'i shtohet nenit 27 të ligjit bazik.

Neni 15 i propozimit, nëpërmjet të cilit plotësohet neni 28 i ligjit bazik, pika 1.15 duhet të hiqet, ose të riformulohet. Aty thuhet: “Autoriteti kryen edhe punë të tjera të parapara me këtë ligj”. Kjo është thënë në mënyrë të përgjithësuar dhe lejon mundësinë për interpretime të ndryshme. Prandaj, duhet kompetencat dhe punët që duhet të kryhen të thuhën në mënyrë të saktë dhe të qartë, njësoj siç duhet të jenë edhe në nenet tjera të ligjit.

Mendoj se me këto ndryshime është dashur të ndërhyhet edhe në nenin 26 të ligjit bazik, që rregullon mënyrën e marrjes së vendimit. Aty thuhet se për ta marrë një vendim duhet të jenë së paku tri veta nga pesë sa janë gjithsej, dhe tri vota afirmative.

Sipas kësaj, të gjithë anëtarët e pranishëm domosdoshmërisht duhet të pajtohen nëse duan të marrin vendim, për arsye se deri më tash ende nuk janë plotësuar anëtarët e bordit.

Ky është një defekt i rëndë ligjor dhe që anëtarëve në këto rrethana ua kufizon mundësinë që ta shprehin qëndrimin e vet. Ai domosdoshmërisht duhet të jetë pro, me qëllim që procesi të mos bllokohet.

Probleme të këtilla kemi edhe më shumë, borde të autoritetit të pavarur dhe të ndërmarrjet publike. Prandaj, zgjedhjet si ajo që përmban neni 29 i Ligjit për konkurrencën duhet të rishikohen.

Posaçërisht, pasi kjo mundëson që për kohë të gjatë, bordet të jenë gjysmake, apo në mënyrë të paligjshme të funksionojnë me ushtrues të detyrës. Kjo po ndodh edhe me Bordin e Autoritetit të Konkurrencës.

Në fund, është një paqartësi të opinionit të Ministrisë së Financave, ku thuhet se zbatimi i nenit 26.2 krijon implikime buxhetore në një shumë prej 58 200 euro të ligjit bazë. Ky nen e përcakton mandatin. Ndërsa të propozimi dhe ndryshimi i ligjit në këtë nen përfshihet niveli maksimal i ndëshkimeve.

Prandaj, nuk është e qartë se kujt i referohet Ministria e Financave kur e jep këtë opinion.

Në parim ne do ta përkrahim këtë projektligj, por me grupet punuese që do të informojmë do të mundohemi që t'i përmirësojmë të gjitha këto nene të cilat janë në kundërshtim me ligjin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur për diskutim. Regjia, ziles ju lutem!

Në sallë tani kemi kuorum të mjaftueshëm, janë 67 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash! Faleminderit!

Konstatohet se me 64 vota me kartelë, një pa kartelë, dhe dy abstenime, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin numër 04/L-226 për plotësim-ndryshimin e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Ngarkohet Komisioni Funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Pika e pestë e rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funksional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

E ftoj ministrin e Punëve të Brendshme, zotin Rexhepi, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin. Zoti Rexhepi, e keni fjalën.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: I nderuar zëvendëskryetar i Kuvendit,
Zëvendëskryeministra,
Të nderuar deputetë,
Më lejoni ta prezantoj para jush Projektligjin për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent, i sponsorizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Projektligji për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent është hartuar duke u bazuar në programin legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2013 dhe në pajtim të plotë me Rregulloren e Punës së Qeverisë numër 09/2011.

Arsyeja për nxjerrjen e Projektligjit për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent qëndron në fuqizimin e kornizës ligjore me të cilën themelohet kjo agjenci, e cila është funksionale.

Pra, me këtë projektligj rregullohet mënyra e themelimit, organizimi, strukturimi, detyrat, përgjegjësitë dhe mënyra e financimit të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent.

Ky projektligj përmban gjithsej 21 nene, duke filluar nga dispozitat e përgjithshme, dispozitat shpjeguese, si dhe dispozitat kalimtare dhe përfundimtare.

Hartimi i këtij projektligji është në harmoni të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me instrumentet ligjore, të cilat janë pjesë direkte të zbatimit në Republikën e Kosovës, si dhe me burimet legjislative të Bashkimit Evropian.

Gjatë hartimit të këtij projektligji janë marrë për bazë procedurat e parapara sipas Rregullores së Punës së Qeverisë numër 09/2011 dhe për këtë projektligj janë pranuar edhe deklaratat për vlerësimin e ndikimit buxhetor nga Ministria e Financave dhe deklaratat e pajtueshmërisë, bashkë me opinionin ligjor nga Ministria e Integritetit Evropian, me të cilat vërtetohet pajtueshmëria me ‘acquis communautaire’.

Të nderuar deputetë,

Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij projektligji, nevojën e avancimit të kuadrit ligjor në këtë fushë, si dhe duke marrë parasysh prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, kërkoj nga ju në parim miratimin e këtij projektligji dhe procedimin e tij të mëtejme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Radha është e kryetarit të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Si duket, fjalën e ka Fatmir Xhelili, në emër të Komisionit.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar,

Përshëndetje për deputetët e nderuar,

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë, në mbledhjen e vet të fundit ia ka dhënë vizën këtij projektligji që të kalojë në lexim të parë, ligj ky i cili pritet që ta rregullojë themelimin e agjencisë në fjalë, si dhe të rregullojë organizimin, strukturimin, detyrat, përgjegjësitë dhe obligimet e saj.

Është një projektligj i cili do të ndikojë në plotësimin e kualitetit të rregullimit të kësaj fushë-lëmie në resorët e menaxhimit të emergjencave civile.

Besoj që anëtarët e Komisionit dhe anëtarët e grupeve parlamentare do ta japin kontributin në punën e mëtejshme të Komisionit në drejtim të ngritjes së cilësisë të këtij projektligji.

Në qoftë se më lejoni do t'i kisha vazhduar edhe disa fjalë në emër të Grupit Parlamentar. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar këtë projektligj në parim dhe do ta japë kontributin e vet në punën e Komisionit në fjalë.

Duhet t'i tërheqim disa konstatime dhe disa paradokse që qëndrojnë në këtë fushë-lëmi, duke filluar prej zjarrfikësve. Po i quaj zjarrfikës se nuk po di si t'i quaj ndryshe, se në bazë të Ligjit të shërbyesve civilë këta janë të kategorizuar në shërbyes civilë, gjë që edhe për kah përgjegjësitë, edhe për kah funksioni, edhe për kah detyre, edhe për kah rrezikshmëria, këta nuk është dashur të jenë të kategorizuar në Ligjin për shërbyes civilë, por duhet të jenë të kategorizuar si zyrtar profesionalë dhe të bazohen në ligj, i cili ua mundëson rregullimin e skemës së pagave dhe obligimeve tjera që shkojnë karshi rrezikshmërisë dhe detyrave që këta njerëz i kryejnë.

Njësitë zjarrfikëse të Kosovës e kanë dëshmuar veten dhe kanë treguar gjithherë në situata emergjente, si gjatë zjarreve të ndryshme që kanë ndodhur në Kosovë, por edhe problemeve të ndryshme dhe zjarreve të ndryshme nëpër qytete se janë të afta për të kryer detyra, të cilat ua kanë parashtruar me ligj këtyre njësite. Mirëpo, mund të them lirisht që këto njësi në shumicën e qyteteve të Kosovës nuk janë të pajisura me mjete teknike adekuatë. Mund të them që këta përdorin kamionë edhe të prodhuar nga vitet 1975-1980 e më tutje. Pajisjet e tyre teknike individuale janë të vjetra edhe nuk testohen, kështu që

shpesh, përpos rrezikut të drejtpërdrejtë nga zjarri dhe aktivitet të cilat i zhvillojnë, kanë rrezikshmëri edhe prej pajisjeve teknike individuale, të cilat nuk janë të testuara. Kanë problem me shfrytëzimin e benificioneve që u takojnë për kah detyra si shujta, pagat, puna jashtë orarit e të tjera.

Besoj që në këtë ligj do të duhej duhet të definohet edhe statusi i tyre, që të quhen zyrtarë profesionalë, dhe i kisha propozuar Ministrisë së Punëve të Brendshme që së bashku me Ministrinë e Administratës ta iniciojnë procedurën për plotësim-ndryshimin e Ligjit për shërbyesit civilë, që të bëhet kategorizimi i saktë i kësaj kategorie, ose i kësaj strukture të zyrtarëve.

Gjithsesi se ky projektligj do të ndihmojë funksionalizimin edhe strukturimin e kësaj agjencie, ku shteti ynë ka përparuar bukur shumë, se Qeveria ka investuar në prodhimin e dokumenteve, të cilat e rregullojnë sistemin e menaxhimit integral të emergjencave, e ka planin e reagimit kombëtar, e ka vlerësimin e rreziqeve, i cili ripërtërihet çdo vit edhe besoj që me këtë projektligj do të ngrihet niveli, funksionaliteti, dhe do të jetë një menaxhim më i lehtë i situatave emergjente, të cilat eventualisht shkaktohen, qoftë prej dorës së njeriut, qoftë prej fatkeqësive natyrore.

Andaj, propozojmë që ky ligj të kalojë në lexim të dytë.

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Në emër të PDK-së, foli zoti Xhelili. Grupi Parlamentar i LDK-së, zonja Vjollca Krasniqi.

VJOLLCA KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar dhe ju deputetë,

Sot e kemi para vetes Projektligjin për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent dhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar bukur herët këtë projektligj dhe ka vërejtje në një numër të neneve të këtij projektligji.

Fillimisht do të doja të them që shumica e projektligjeve që kanë ardhur në Kuvend, e po vazhdohet edhe më tej edhe sot me këtë projektligj, po vazhdohet me avazin e vjetër që çdo projektligj të ketë ndikime buxhetore, prandaj pyetja ime është: Pse nuk po bëhen këto planifikime në mënyrën e duhur më herët? Pse t'i mbetet përgjegjësi Ministrisë së Punëve të Brendshme që të gjej mjete shitesë për financimin e dy zëvendës drejtorëve, të cilët nuk janë paraparë me projektligjin për vitin 2014, e as në kornizën afatmesme të shpenzimeve buxhetore?

Në projektligj thuhet se lehtësimi i këtij projektligji do të ketë të hyra buxhetore. Nuk shqyrtohet më tutje se nga do të jenë këto të hyra buxhetore dhe do ta pyesja ministrin: a keni ndonjë paralogari se sa mund të jenë këto të hyra buxhetore për një periudhë të caktuar kohore, për një, dy, tri, apo pesë vjet? Dhe, në asnjë nen nuk sqarohet se si mund të hyjnë këto të hyra dhe të jenë pjesë e Buxhetit të Republikës së Kosovës.

Kemi vërejtje edhe në nenin 7, ku flitet për emërimin e drejtorëve të përgjithshëm dhe zëvendës drejtorëve, drejtorët dhe zëvendës drejtorët propozohen nga një komision, i

themeluar nga ministri, e më pas emërohen nga kryeministri dhe ministri, por nuk thuhet se ky komision nga çfarë brumi do t'i marrë këta persona dhe a do të ketë konkurs apo jo. Por, e keni lënë që më tutje të themelohen, themelimi, përbërja dhe procedurat e komisionit rregullohen me akte nënligjore dhe të nxjerra nga ministri. Mendoj se shumë punë ju ka mbetur, zoti ministër, për të bërë, sepse në shumë nene keni thënë se kjo punë, ose kjo çështje, do të rregullohet me rregullore, ose me akte nënligjore.

Kemi rezerva në një numër të shumtë të neneve, edhe pse nuk është një projektligj i gjerë. Kësaj radhe, në parim do ta mbështetim si grup parlamentar, mirëpo mendoj që shumëçka do të duhej të ndryshohej në leximin e dytë, gjatë punës së komisionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, zoti Rexhep Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” normalisht e kemi shqyrtuar dhe njëkohësisht i kemi edhe vërejtjet tona, të cilat do t'i shfaqim dhe do t'i ndajmë bashkë me grupin punues, pjesë e të cilit jam unë në komisionin përkatës.

Nuk do të doja t'i ndaja me ju të gjitha vërejtjet kështu për shkak të kohës ndoshta dhe për shkak të efektit, për shkak se vërejtjet do të kenë efekt aty ku do të punojmë bashkë me anëtarët e grupit ndërmjet leximit të parë dhe të dytë dhe mendojmë se të gjitha vërejtjet tona do të kihen parasysh para leximit të dytë, por nuk do të doja njëkohësisht edhe ta anashkaloja pa e përmendur këtu para kolegëve vërejtjen kryesore që e kemi në titull, për shkak se mendojmë se qëllimi i titullit është i mirë, por përkthimi ka qenë i keq, për shkak se nuk do të duhej të quhej Projektligji për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent, por do të duhej të quhej: Projektligji për Menaxhimin e Emergjencave. Në anglisht i bie njëjtë, por në shqip i bie ndryshe, kështu që ne do të jemi të vetëdijshëm që kemi çka të ndryshojmë, do ta japim kontributin tonë në grupin punues, respektivisht në komision.

Do ta kemi parasysh për shkak se edhe në përputhje me implikimet buxhetore, siç e përmendi kolegja paraprakisht, do të duhej ta shikonim njëherë dhe do të ketë një punë zinxirore për shkak se para se të hyjë në fuqi ky projektligj, do të miratohet ose nuk do të miratohet buxheti për vitin 2014, dhe mendoj që pasi të futet në fuqi, ky ligj do të ndikojë edhe në rishikimin e buxhetit të vitit 2014, kështu që ne do të jemi pjesë e punës dhe pretendojmë që ta bëjmë një ligj sa më të mirë të mundshëm, ligj i cili është i nevojshëm për infrastrukturën e sigurisë në Kosovë.

Pra, ne si Grup Parlamentar e përkrahim në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, zoti Isufi.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar projektligjin, i cili është jashtëzakonisht i domosdoshëm për periudhën që e kemi për arsye se ka nevojë

për rregullimin e pozitës së zjarrfikësve, sidomos dhe beneficionet që duhet t'i gëzojnë ata për shkak të punës specifike që kanë.

Kontributin tonë do ta japim në komision dhe besoj se do të mund ta bëjmë një ligj, i cili do të jetë i implementueshëm, në mënyrë që të rregullohet edhe kjo çështje ligjore në Agjencinë e Menaxhimit Emergjent. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Koalicioni për Kosovë të Re, kryetarja Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, nënkryetar!

Faleminderit prej ministrit për prezantimin e Ligjit për Agjencinë e Menaxhimit të Emergjencës. Duke marrë parasysh ardhjen e këtij projektligji në Kuvend, Koalicioni për Kosovë të Re e ka shqyrtuar atë dhe i jep përkrahje ministrit për ardhjen e tij, mirëpo njëkohësisht kërkojmë që gjatë amendamentimit të këtij projektligji të definohet në mënyrë më të qartë pozita e zjarrfikësve dhe t'i ndihmohet Ministrisë së Punëve të Brendshme, në këtë rast edhe ministrit, që pozita e tyre të caktohet në mënyrë të prerë dhe njëkohësisht të ndahen të holla nga Buxheti i Kosovës për implementimin këtij ligji në një sasi më të madhe. se nuk mund të kërkojmë nga ministri që ligji të jetë i zbatueshëm dhe efektiv kur në fakt nuk ka para për implementimin e tij.

Si Koalicion për Kosovë të Re i japim përkrahje projektligjit dhe njëkohësisht e mbështetim ministrin dhe kërkojmë nga Ministria e Financave që të ndajë të holla më shumë në zbatimin e këtij projektligji.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Zajednička Budućnost”, zoti Marinković.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala gospodine predsjedavajući!

Poslanička grupa “Zajednička Budućnost” pažljivo je razmatrala Nacrta zakona o pravljenu vanrednim situacijama, i ima određene primedbe na Nacrta zakona, počev od naslova zakona koji jasno odnosi na formiranje Agencije za upravljanje vanrednim situacijama, zato i naziv samog zakona mora biti jasan, jer će ovaj termin da se kasnije koristiti u nizu zakonskih članova, koji regulišu rad i delokrug same agencije.

Ispravnost termina je veoma važan, a njihova neispravnost kod građanstva može izazvati određene zabune. Istovremeno zakon mora da sledi jedan logičan slet termina koji moraju biti isto od prvog do doslednog člana zakona, pa čak i šire, i mora da bude u skladu sa postojećim važećim zakonodavstvo. Ja ću sada dati određene primere na koje treba posebno obratiti pažnju. Na termin “Komisija” i termin “Odboru”, u pitanju je isti organ koji su u različitim članovima, različito označava, što unosi zabunu da su u pitanju dva različita organa, što nije želja predlagača zakona.

Isti je slučaj sa terminima “pravila” i terminom “Pravilnik”, koji u suštini trebaju da razrade zakon i učine ga primenjivim. Istovremeno dolazi do mešanja značaja termina “zakonski” i termina “podzakonski”, čime se remeti hierarkija zakonski i podzakonskih akata, što unosi zabunu u celokupnom tekstu predloga zakona. Neki termini nemaju

nikakav znaçanje u srpskom jeziku. Na primer termin “verifikovana diploma”. Jasno je da se radi o nostrifikovanoj diplomi stranih univerziteta, ukoliko se pojavi kandidat koji je završio fakultet u inostranstvo.

S obzirom da se radi o velikom broju neispravnosti u srpskoj verziji predloga zakona, Poslanička grupa “Zajednička Budućnost” odlučila je da sa prečišćenim tekstom Nacrta zakona i jednim amandmanom reši pitanje svih jezičkih neispravnosti. Što se ostalih članova Nacrta zakona tiče, Poslanička grupa “Zajednička Budućnost” daće svoje amandmane u parlamentarnim komisijama, a danas će u načelu podržati usvajanje istog Nacrta zakona. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Demolli

HAKI DEMOLLI: Faleminderit i nderuar kryesues i Kuvendit!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Pas leximit dhe analizimit të dispozitave të Projektligjit për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent, mund të thuhet se i njëjti përcillet me një varg lëshimesh, si të karakterit struktural-përmbajtjesor, ashtu edhe lëshimet e karakterit tekniko-juridik dhe të atij gjuhësor.

Në vazhdim do t’i paraqes disa prej lëshimeve dhe dobësive të këtij draf-tligji. Kësisoj, njëri prej lëshimeve përmbajtjesore paraqet faktin se ky draft, në njërën anë, përmban një mori dispozitash, sipas mendimit tim të panevojshme, me të cilat rregullohen parimet e punës së agjencisë, pastaj disa përkufizime të termeve dhe shkurtesave, kurse, në anën tjetër, i njëjti nuk përmban dispozita me të cilat do të rregullohej themelimi, përbërja dhe procedurat e punës së komisionit, i cili e propozon kandidatin për drejtor të përgjithshëm të agjencisë.

Duke pasur parasysh rëndësinë, rolin dhe peshën e këtij komisioni, jam i mendimit se themelimi, përbërja dhe procedurat e punës së tij duhet të jenë objekt i trajtimit të dispozitave të këtij ligji, e assesi nuk duhet lejuar që kjo çështje kaq e rëndësishme të rregullohet me një akt nënligjor, të nxjerrë nga ministri. Mangësia tjerët e këtij drafti qëndron në nenin 8 të tij, ku janë përcaktuar kriteret për kandidatët që mund të emërohen në pozitën e drejtorit, apo të zëvendës drejtorit. Më konkretisht, sipas këtij neni nuk kërkohet që kandidati ta ketë asnjë ditë përvojë pune për t’u emëruar në këto poste kaq të rëndësishme dhe me kaq përgjegjësi.

Pra, konform këtij neni, fala është për nenin 8, në postin e drejtorit të agjencisë mund të emërohet edhe personi i cili sapo i ka kryer studimet, apo madje që e ka blerë ndonjë diplomë në universitetet private, qoftë në vend apo në vendet e regjionit, e që e ka nostrifikuar te ne, andaj propozoj që në këtë nen të parashihet përvoja e punës në ndonjë pozitë menaxheriale për së paku 5 vjet si kriter për kandidatët që garojnë për këto poste.

Mangësi tjetër e këtij ligji është se, ndonëse në nenet 7, 8, 9 flitet për emërimin, kriteret e emërimit, lirimet dhe shkarkimet e zëvendës drejtoreshave të agjencisë, askund nuk theksohet

numri i saktë i zëvendës drejtorëve të agjencisë, e bazuar në përvojat e partive tona politike, atëherë është e pritshme se kur t'i teket ministrit për ta rehatuar ndonjë militant të vet partiak, ai do ta emërojë për zëvendës drejtor, sepse nuk ka kufizime ligjore.

Andaj propozoj që gjatë përpunimit të ligjit në komisionet përkatëse të kufizohet dhe të rregullohet kjo çështje, duke e përcaktuar numrin e saktë të zëvendës drejtorëve.

Kur jemi te zëvendës drejtorët e agjencisë, vlen të komentohet edhe neni 11, me të cilin përcaktohen përgjegjësitë e tyre, ku decidivisht thuhet: “Në mungesë të drejtorit të përgjithshëm, zëvendës drejtori i kryen të gjitha detyrat e parapara me nenin 10 të këtij ligji, si dhe detyrat tjera të caktuara nga drejtori”, që do të thotë se nëse është i pranishëm drejtori, atëherë ai nuk paska fare detyra, prandaj propozoj që ky nen të riformulohet, duke i përcaktuar më konkretisht përgjegjësitë dhe detyrat e zëvendës drejtorit.

Më tutje, në paragrafin 4 të nenit 17 theksohet se agjencia krijon të hyra që derdhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës. Mendoj se këtij neni duhet shtuar edhe një paragraf, në të cilin do të shënoheshin veprimtaritë, respektivisht mënyrat dhe burimet prej nga agjencia mund të krijojë të hyra, mirëpo, siç e theksova më lart, ky draf-tligj, përveç lëshimeve përmbajtjesore, ka edhe lëshime në formulime gjuhësore. Si për shembull, në nenin 9, paragrafi 1.4, ku thuhet se drejtori apo zëvendës drejtori lirohen apo shkarkohen, ndër të tjera, edhe: “për shkak të pamundësisë të ushtrimit të detyrës për një periudhë kohore jo më të gjatë se 6 muaj”. Theksoj edhe një herë ‘jo më të gjatë se 6 muaj’, gjë që nënkupton se ata mund të lirohen apo shkarkohen edhe nëse nuk mund ta ushtrojnë detyrën edhe për një ditë të vetme, apo për disa ditë të caktuara, sepse një ditë e vetme shikuar realisht paraqet periudhë jo më të gjatë kohore se 6 muaj.

Ligji po ashtu ka edhe formulime të pakuptimta dhe shprehje që janë përdorur në mënyrë joadekuate. Kështu, për shembull, në nenin 5, paragrafi 1.2 kur flitet për parimin progresiv, thuhet se: “menaxherët parashikojnë fatkeqësi të ardhshme”, e unë nuk besoj se në Kosovë kemi menaxher që do të mund t'i parashikojnë edhe fatkeqësitë e ndryshme natyrore, ngase ata mund të vlerësojnë situata të rrezikshme, por jo edhe t'i parashikojnë ato.

Edhe teksti i paragrafit 4 të nenit 6, duket si i pakuptimtë, sepse në të thuhet: “Drejtori i përgjithshëm e mban të informuar ministrin 24/7”. Vërtet thyesa 24/7 nuk e di se çka paraqet, ndoshta është 24 orë në 7 ditë, por duke pasur parasysh se ky është ligj, e ne si ligjvënës nuk do të kursejmë fjalë dhe të sajojmë edhe ndonjë formulim më shumë, në mënyrë që dispozitat e këtij ligji të jenë të qarta dhe të kuptueshme, si për zbatuesit të ligjit, ashtu edhe për çdo person që e lexon atë.

Ndonëse këtij ligji mund t'i bëhen edhe disa vërejtje dhe komente të tjera, unë do ta përfundoja këtë fjalë timen, duke ju falënderuar për vëmendje.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Përfaqësuesi i Qeverisë, dëshiron ta marrë fjalën? Jo.

Nuk kemi kuorum për të votuar. Regjia, ziles edhe një herë. Faleminderit! Në sallë tani janë 64 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

E përsëritim edhe një herë votimin.

Të nderuar deputetë, ju që jeni në sallë, votojeni ligjin, sepse vetëm 58 veta keni votuar. Edhe një herë e përsëritim votimin. Votojmë tash! Në sallë janë 65 deputetë.

Kush është pa kartelë? A ka të tillë? Nuk ka asnjë. Domethënë nuk po doni të votoni! Votojmë edhe një herë. Në qoftë se nuk votoni, kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës. Votojmë tash!

Konstatoj se me 68 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin numër 4/L-230 për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

Pika e gjashtë e rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

E ftoj zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Drejtësisë, zotin Kuçi, që para deputetëve ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin. Zoti Kuçi, e keni fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI DHE MINISTRI HAJREDIN KUÇI:

Faleminderit i nderuar nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Zëvendëskryeministër Bukoshi, ministër Rexhepi,

Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni që ta paraqes para jush Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Zonja dhe zotërinj,

Ky është njëri prej ligjeve që paraqet interes të veçantë për qytetarët e Republikës së Kosovës, por edhe për institucionet dhe mbarë shtetin tonë. Ky projektligj është një prej produkteve të angazhimeve tona të vazhdueshme dhe të përbashkëta për të ndikuar në parandalimin e interesit, por mbi të gjitha ne synojmë ta arrijmë një stad, ku në shoqërinë

tonë shmangia e konfliktit të interesit paraqet përgjegjësi, detyrë dhe në radhë të parë, do të thosha, kulturë qytetare të karakterit moral dhe shoqëror dhe jo vetëm obligim ligjor.

Për ta arritur këtë stad të vetëdijes dhe të përgjegjësisë, të gjithë ne duhet të punojmë akoma më shumë dhe duhet ta rritim kontrollin nëpërmjet masave represive, por edhe duke marrë masa të tjera, që këto dukuri negative gradualisht të zbehen, të ndalohen dhe mbi të gjitha të merren masa që konsiderojmë që në momentet e caktuara mund të jenë të ashpra për shoqërinë, por mbi të gjitha në stadin e zhvillimit të shoqërisë çfarë gjendemi ne, janë të domosdoshme dhe besoj edhe të arsyeshme.

Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni që në fillim të theksoj se ky projektligj ka tri qëllime kryesore: nën një, ligji ka për qëllim që ta harmonizojë legjislacionin kundër korrupsionit me legjislacionin penal në fuqi, përkatësisht me Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale, sipas të cilave sanksioni për veprën penale - konflikt interesi - është rritur në masë të dukshme dhe rastet e caktuara kjo vepër është përcaktuar si vepër penale. Për herë të parë në legjislacionin tonë është paraparë edhe dënim me burg. Lidhur me këtë pikë e shoh të rëndësishme të theksoj se dispozitat tona ndëshkuese janë ndër më të lartat në rajon dhe në disa raste shumë më të larta se në vendet anëtare të BE-së.

Kjo e ka një arsye të fuqishme për këtë çështje, që mund të përkthehet me dëshirën tonë të përbashkët që këto dënime të jenë aq të ashpra, sa të dekurajojnë çdo përpjekje për të vepruar në konflikt interesi dhe rrjedhimisht në përpjekje eventuale për të korruptuar dikë, apo për të qenë i korruptuar.

Qëllimi i dytë patjetër që ndërlidhet me përmbushjen e kriterëve dhe rekomandimeve që dalin nga studimi i fizibilitetit për Kosovën. Këtu është kërkuar që këto dy vepra të përsosen më tutje me kornizën ligjore dhe të përafrohen me ato kundër korrupsionit.

Të nderuar deputetë,

Ne i kemi rritur sanksionet, procedurat i kemi përshtatur dhe kemi krijuar ligje të përshtatshme për ta luftuar këtë dukuri dhe tani më i mbetet Prokurorisë dhe gjykatave tona që të jenë aktive në këtë luftë.

Qëllimi i tretë ndërlidhet me përmbushjen e kërkesave që kanë bërë agjenci të ndryshme përfshirë Agjencinë Kundër Korrupsionit; përfaqësuesit e prokurorive dhe gjykatave; përfaqësuesit e EULEX-it dhe përfaqësuesit e tjerë, përfshirë edhe shoqërinë civile. Andaj, nëpërmjet këtij projektligji ne i kemi bërë këto ndryshime.

E para, e kemi shtuar obligimin shumë të rëndësishëm për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe e kemi paraqitur një detyrim shtesë për ata që nëpërmjet tyre të parashtrihen kallëzimet penale pranë prokurorisë kompetente, në raste kur vërehet ose dyshohet se një person zyrtar gjendet në konflikt interesi.

Nëpërmjet kësaj dispozite kemi inkurajuar dhe obliguar aktivisht, duke e shtuar aktivitetin për agjencinë, që pa dyshim do të rezultojë më shumë në kallëzime penale, më

shumë në ndjekje dhe rrjedhimisht më shumë gjykime, e krejt kjo, të nderuar deputetë, do të përkthehet në më shumë rezultate konkrete.

Kemi bërë unifikimin e termit të personit zyrtar, duke përcaktuar qartë me ligj se kush është ai që përcaktohet me emrin 'person zyrtar', që përcaktohet edhe me Kodin e ri Penal. Nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje, sado e vogël që mund të duket në shikim të parë, do të shtohet përmasa shumë e madhe e numrit të personave që bien ndesh me fushëveprimin e këtij ligji dhe pa dyshim do të paraqesë një zhvillim pozitiv në interes të vendit tonë.

Është bërë qartësimi i dispozitave ekzistuese ligjore dhe shtimi i dispozitave të nevojshme për rekomandimet e Agjencisë Kundër Korrupsionit, duke intervenuar që kjo agjenci në shumë fusha ta ketë autoritetin shtesë për të ndryshuar, por edhe për të ndihmuar në kryerjen e veprave dhe veprimeve efikase në parandalimin e konfliktit të interesit.

Kemi shtuar kompetencat për Agjencinë Kundër Korrupsionit, duke promovuar që ky institucion do të rekomandojë edhe më shumë në raportet për Kosovën dispozitat e reja të tij dhe të tjerëve përmes të cilave do të shtohet përgjegjësia e institucioneve të vendit në raste kur ka konflikt të interesit dhe kështu aktivisht do të jenë të involvuar, jo vetëm ata të cilët thirren në Agjencinë Kundër Korrupsionit, por edhe të tjerët, të cilët janë të ftuar që të punojnë aktivisht në konfliktin e interesit dhe shmangien e situatave të tilla brenda institucioneve ku ata edhe punojnë.

Po ashtu, jemi përkujdesur që të krijojmë një dinamizëm më të madh të punës së institucioneve tona, duke përcaktuar qartë afatet e ndryshme kohore, qoftë për agjencinë, qoftë për individët që janë të informuar për konfliktet e interesit, apo për ata që duhet të deklarohen, dhe kjo mundëson që institucionet tona të jenë më efektive në ndjekjen e kësaj dukurie.

Zonja dhe zotërinj,

Duke ju ftuar që t'i jepni në parim mbështetje këtij projektligji dhe duke dhënë mundësinë që ju të jepni amendamentimin për këtë projektligj, ju ftoj që ta miratoni dhe pastaj të punoni në miratim për leximin e dytë.

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e kryetarit të Komisionit për Legjislacion, zoti Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Komisioni e ka shqyrtuar projektligjin dhe vlerëson se ka bazë kushtetuese, në aspektin përmbajtësor i plotëson kushtet e përcaktuara me rregullat e hartimit të legjislacionit, si dhe kushtet e caktuara me Rregulloren e Kuvendit për ta proceduar për shqyrtim dhe për miratim në parim. Prandaj, komisioni i rekomandon seancës që ta shqyrtojë dhe ta aprovojë në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Në emër të PDK-së, zoti Selimi.

BEHAR SELIMI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra

Shumë të nderuar deputetë,

Grupi ynë e ka shqyrtuar projektligjin në fjalë dhe vlerësojmë se duhet të aprovohet në parim për shumë arsye. Disa prej tyre parimisht do t'i kisha cekur. E para është se e përdor një gjuhë më të qartë juridike, e dyta është se i përcakton edhe më qartë titullarët e funksioneve që ushtrojnë funksione publike, të cilët duhet të ruhen nga konflikt interesi, e treta dhe sidomos kjo mendojmë meriton mbështetje, është ashpërsimi i politikës ndëshkimore rreth parandalimit dhe luftimit të korrupsionit dhe, së fundi, mendojmë se forcimi i rolit të Agjencisë Kundër Korrupsionit në proceset e prokurimit është për t'u përshëndetur, sidomos pjesëmarrja e tyre në cilësi vëzhguese në të gjitha aktivitetet e prokurimit, gjë që bën të parandalojë nëpërmjet rekomandimit të opinioneve të ndryshme në parandalimin e korrupsionit në fushën, sidomos të prokurimit.

Pra, duke qenë se parimisht e vlerësojmë si të tillë, ne i inkurajojmë edhe të tjerët që ta votojnë në parim këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

ARBEN ZEMAJ: Faleminderit, zot kryesues!

Përshëndetje për kolegët deputetë,

Ministra të pranishëm,

Këto ndryshime që janë paraqitur me plotësim-ndryshimin e këtij ligji përkojnë edhe me shumë çështje që jo rrallë herë janë ngritur nga deputetët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, por edhe nga vetë Kuvendi i Kosovës për kufizimin, ta quaj ashtu, të ushtrimit të funksioneve tjera, të cilat bien në konflikt të interesit.

Është për t'i përshëndetur këto ndryshime, edhe ato çka e tha sponsorizuesi, ministri, dhe kolegu im deputet, që është një gjuhë shumë më e konkretizuar, sidomos te pjesa e afateve, por edhe pjesa e përgjegjësisë dhe e institucionit, edhe pjesa e përgjegjësisë së Agjencisë Kundër Korrupsionit, në harmoni edhe me Kodin Penal dhe me Kodin e Procedurës Penale, por unë vetëm po theksoj se ndoshta pak a shumë kemi ardhur në një situatë që është anomali që duhet të tejkalohet çështja e konfliktit të interesit dhe njerëzit, të cilët pajisen me përgjegjësi si të zgjedhur dhe si të emëruar, duhet njëherë e përgjithmonë ta dinë që duhet ta lënë anash pjesën ku mund të krijojnë favore, apo edhe mund të krijojnë përshtypje se po punojnë jo për interesin e përgjithshëm, por për interesat e kufizuara të ndërmarrjes së vet, apo të grupit të vet të interesit dhe deri te ushtrimi i më shumë funksioneve, të cilat bien ndesh me ligjet që janë të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe ky ligj, të cilin tani e kemi të pranishëm.

Mendoj që këto ndryshime duhet të përkrahen, edhe pse, nëse paraqitet nevoja, te përkufizimi 'personi zyrtar', edhe sipas Kodit Penal, por edhe sipas këtij ligji, sepse ikja nga përgjegjësia është bërë konkretisht këtu se çka është zyrtar i lartë publik dhe cili është ushtrimi i atij funksioni, por sido që të jetë, Grupi Parlamentar i LDK-së i përkrah këto ndryshime dhe besojmë se angazhimi ynë nuk do të mungojë edhe në pjesën tjetër deri në leximin e dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, zonja Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Nëse e dëgjojmë ministrin e Drejtësisë, na duket se kush e di se sa ndryshimet janë bërë me këtë plotësim-ndryshim, mirëpo shumicën prej çështjeve që i përmendi zoti ministër, pak a shumë, janë në ligjin aktual, mirëpo këtu vetëm sa janë riformuluar. Pra, nuk ka ndonjë ndryshim përmbajtjesor në këtë plotësim-ndryshim të Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit. Pra, ajo që po ndryshohet është termi ‘zyrtar të lartë’ zëvendësohet me “persona zyrtarë”, dhe neni 4 i projektligjit, ku personi zyrtar nuk është specifikuar pra veç e veç si në ligjin aktual, por vetëm sa është përshtatur me Kodin Penal dhe çështja e afatizimit.

Thënë të drejtën, Kosova nuk vuan nga mospasja e ligjeve, por nga moszbatimi i atyre ligjeve në praktikë. Pra, ne tashmë e kemi në fuqi Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit, porse ai nuk po zbatohet nga institucionet të cilat janë të thirrura për ta zbatuar këtë ligj. Pra, nuk dihet se çka nënkupton parandalimi i konfliktit të interesit për Agjencinë Kundër Korrupsionit, pasi kur është fjala për njerëzit e këtij pushteti vepron me standarde të dyfishta. Pra, e kam fjalën për zëvendëskryeministrin dhe ministrin Slobodan Petroviq, i cili për dy vjet me radhë ka qenë në konflikt interesi, duke qenë edhe anëtar i Bordit të AKP-së, dhe AKK-ja, pra Agjencia Kundër Korrupsionit nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për parandalimin e këtij konflikti.

Pra, e ka lënë derisa e ka përfunduar punën si anëtarë në Bordin e AKP-së, dhe rasti tjetër është me anëtarin e KQZ-së, Betim Gjoshi, nga radhët e PDK-së, i cili është edhe anëtar i KQZ-së dhe kryeshef ekzekutiv në ndërmarrjen publike “Treimkos” dhe AKK-ja vazhdon me heshtjen e saj përballë këtij konflikti të interesit.

Ne si subjekt politik do ta votojmë këtë plotësim-ndryshim, edhe pse nuk ka ndonjë ndryshim përmbajtjesor, mirëpo i bëjmë thirrje Agjencisë Kundër Korrupsionit që ta respektojë ligjin dhe të marrë vendime në përputhje me ligjin. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.)

KRYETARI: Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të Aleancës, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës do ta votojë Projektligjin për ndryshimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputetja Suzan Novobërdaliu.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, kryetar!

Edhe Koalicioni për Kosovë të Re e ka shqyrtuar këtë projektligj. Siç tha edhe ministri me miratimin e Kodit të ri Penal, i cili zbatohet nga janari i vitit 2013, i njëjti është dashtë

të plotësohet dhe të ndryshohet dhe të jetë më i përafërt me Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale.

Gjithashtu më duhet të ju falënderoj, sepse në memorandumit shpjegues na jepet edhe një tabelë e mirë e të konsulentëve, të cilët kanë qenë pjesë përbërëse e konsultimeve dhe propozimet e tyre pse janë pranuar, apo pse nuk janë pranuar.

Ne e kemi shqyrtuar këtë projektligj dhe të njëjtin në parim e përkrahim. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit parlamentar “6+”, deputeti Enis Krvan

ENIS KRVAN: Faleminderit kryetar!

“6+” Parlamentar Grubu olarak söz konusu Yasa Tasarısının gereğini göz önünde bulundurarak kabul ettiğimizi belli eder, derli toplu bir yasa tasarısını sundukları için bakana ayrıca teşekkür ederiz. Gereken düzenlemeleri ve önerilerimizi mevcut komisyonlara sunacağız.

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar “Zajednička Budućnost”, deputetja Biserka Kostiq e ka fjalën.

BISERKA KOSTIĆ: Zahvaljujem predsedniče!

Parlamentarna grupa “Zajednička Budućnost” je razmatrala Nacrta zakona, mi ćemo u načelu podržati i glasaćemo za, a konkretne predloge daćemo u dotičnoj komisiji. Hvala!

KRYETARI: Nuk ka të lajmëruar të tjerë për debat. 56 deputetë janë në sallë, nëse ka deputetë që janë afër le të kthehen për të votuar, apo vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për aktet normative

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

E ftoj zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Drejtësisë, zotin Hajredin Kuçi, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI DHE MINISTRI HAJREDIN KUÇI:

Faleminderit i nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Zonja dhe zotërinj

Më lejoni që para jush, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ta prezantoj Projektligjin për akte normative.

Me këtë projektligj rregullohen çështjet që kanë të bëjnë me qartësimin e qartë në parandalimin e konfliktit të akteve normative deri në përcaktimin e autoritetit përgjegjës për nxjerrjen e akteve normative si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal dhe parandalon konfliktin ndërmjet marrëveshjeve ndërkombëtare dhe akteve tjera vendore.

Për më shumë nëpërmjet këtij projektligji aktet normative rregullohen që nga parimet e tyre, që nga hartimi, nxjerrja, miratimi, publikimi i tyre dhe llojet e hierarkisë në aktet normative.

Ky ligj do të vlejë për të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës, të cilat janë kompetente për të miratuar, nxjerr apo publikuar akte normative sipas Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi.

Në përputhje me këtë ligj do të bëhet hartimi i akteve normative që do t'i nënshtrohet parimeve, si atij të kushtetutshmërisë, ligjshmërisë, vlefshmërisë dhe domosdoshmërisë, konsistencës, transparencës dhe profesionalitetit.

Ky ligj do t'i rregullojë disa fusha me rëndësi. Në radhë të parë do t'i përcaktojë llojet dhe hierarkinë e akteve normative në Republikën e Kosovës dhe ndërlidhjen e këtyre akteve normative, pastaj do të përcaktohet përgatitja e publikimi i teksteve të konsoliduara të akteve normative. Po ashtu konsolidimi i teksteve të aktit normativ, do të lehtësohet dukshëm në qasjen e akteve normative për të gjithë personat që merren me zbatimin e ligjit, përfshirë edhe qytetarët dhe interesin e publikut.

Me qëllim të transparencës nga qytetarët do të lehtësohet sa më shumë puna në qasjen e akteve normative, duke mundësuar një data-bazë të të dhënave të akteve normative në fuqi, që do të publikohen dhe përditësohen sipas publikimit të akteve të tilla.

Po ashtu do të përcaktohet qartë se të gjitha aktet normative do të hyjnë në fuqi pas publikimit në Gazetën Zyrtare dhe publikimi tanimë është i domosdoshëm.

Po ashtu këtu do të bëhet edhe vlerësimi i ndikimit rregullativ dhe mundësia që organet kompetente, ministrinë dhe institucionet tjera të bëjnë vlerësimin paraprak dhe më të paskajshëm të efektit të akteve normative.

Dhe në fund, do të ketë Njësinë për rregullimin më të mirë të akteve normative që bën një harmonizim të tyre dhe i përcakton kompetencat e qarta të gjitha organeve që merren me akte normative në vendin tonë. Ju ftoj që ta miratoni në parim.

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka kryetari i Komisionit Funkcional për Legjislacion, Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar dhe ka vlerësuar se në aspektin përmbajtësor i plotëson kushtet, mirëpo në të njëjtën kohë ne si Komision kemi bërë një hulumtim lidhur me praktikën e vendeve tjera sa i përket Ligjit për aktet normative dhe na rezulton se shumica e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian nuk e kanë një ligj të tillë. Dhe, vendet që i kanë janë: Bullgaria, Lituania dhe Sllovenia, e cila po e heq këtë ligj, mirëpo në të njëjtën kohë kemi konstatuar se në vendin tonë ka problem dhe konflikt ndërmjet ligjeve dhe akteve të ndryshme juridike, prandaj kemi qenë në dilemë a duhet apo s'duhet të kemi një ligj të tillë?

Dhe, realisht për ta zhdukur këtë problem të konflikteve administrative, të konflikteve të ligjeve dhe duke pasur parasysh edhe elementin tjetër se përvoja institucionale në Kosovë është relativisht e re dhe tradita institucionale është relativisht e re, atëherë në Komision kemi vlerësuar se është e rëndësishme që të kemi një ligj të tillë për të vendosur hierarkinë ligjore ose në rast të konflikteve për t'i sqaruar mënyrat e procedimit, por edhe në të njëjtën kohë të jemi shumë të vëmendshëm që në Komision brenda dy leximeve të shohim në mënyrë më detaje se si duhet të ndryshohet ky ligj dhe si duhet t'i përshtatet më mirë rrethanave tona.

Domethënë, kemi konstatuar njëzëri në Komision se ky ligj është pak a shumë për rrethanat në të cilat gjendemi ne dhe nuk është ligj i cili mbështetet shumë në praktikën ndërkombëtare se shumica e vendeve të Bashkimit Evropian nuk e kanë. Faleminderit!

KRYETARI: Tani është radha e grupeve parlamentare për t'u prononcuar për këtë, por unë megjithatë dua ta ngre një shqetësim timin. Sot, për shembull, në të gjitha mediet shkruan "deputetët mashtrues" dhe është vërtet mirë të dihen cilët janë "deputetët mashtrues", e të mos jetë që komplet deputetët jemi mashtrues, kështu që ne kemi përgjegjësi edhe për sjelljen tonë individuale dhe të secilit deputet.

Në emër të Partisë Demokratike, fjalën e ka deputeti Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mirëpret ardhjen e këtij projektligji në Parlament dhe e vlerësojmë si një projektligj shumë të rëndësishëm për vendosjen e standardeve të legjislacioneve.

Mendoj se një ligj i tillë i duhet shumë Kosovës, i duhet për arsye që ne jemi në fazën e konsolidimit të sistemit juridik dhe jo në pak raste kemi pasur probleme me cilësinë e ligjeve dhe akteve normative që i kemi miratuar.

Praktikisht ky ligj është e vërtet se është i rrallë në praktikën shteteve tjera, është i nevojshëm për Kosovën, sepse Kosova ndodhet në procesin e integritetit evropian ku standardizimi i ligjeve është faktori kyç.

Më lejoni t'i theksoj tri objektivat që pretendon ky ligj, të jap dy vërejtje parimore dhe në një mënyrë të përcaktojë edhe angazhimin që do ta kemi ndërmjet dy leximeve, sepse kryetari i Komisionit harroi të thotë. Dua ta përsërit se brenda agjendës së punës së Komisionit të Ligjeve për këtë vit ne kemi paraparë që Komisioni i Ligjeve ta marrë iniciativën vetë për hartimin e këtij ligji, por tani kjo iniciativë ka ardhur nga Qeveria dhe ne do të punojmë jashtëzakonisht shumë që ky ligj të jetë një bazë e mirë për Kuvendin që të ngre cilësinë e ligjeve jo vetëm të evitojë konfliktin ndërmjet ligjeve, por të ngrejë cilësinë e ligjeve dhe akteve normative që miratohen në Kosovë.

Objektiva e parë e këtij ligji është pra standardizimi i akteve normative në Kosovë dhe ndërtimi i komplet sistemit juridik brenda standardeve unike të teknikës dhe të shkrimit ligjor.

Objektivi i dytë është vendosja e një hierarkie normale, një hierarkie ku vendoset parimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë dhe ky është një ligj jashtëzakonisht mirë i detajuar sa i përket hierarkisë, sepse rregullon supremacinë e Kushtetutës dhe me akte tjera pretendon që të vendosë rend edhe sa i përket akteve të pushteteve tjera, akteve që i miraton Qeveria, që i miraton presidenti i Republikës, si dhe aktet e pushtetit lokal, në mënyrë të veçantë përcakton primatin apo prevalencën e marrëveshjeve ndërkombëtare në raport me ligjet, në mënyrë të veçantë fokusohet tek legjislati i organit, pra ligjet kushtetuese, ligjet që miratohen me 2/3 dhe ligjet me interes vital dhe kjo është shumë me rëndësi, sepse jo rrallë në praktikën e sistemit juridik ne kemi pasur edhe shkelje të hierarkisë legjislativë.

Për Kuvendin e Kosovës ky ligj është shumë i rëndësishëm. Ne e kemi Rregulloren e punës ku rregullohet procedura e miratimit të ligjeve, të rezolutave, të rekomandimeve, të konkluzioneve, të deklaratave. Ne do të punojmë në leximin e dytë që në këtë ligj të përpunohen procedurat e miratimit të akteve dhe efekti dhe pasojat juridike të akteve që i miraton Kuvendi, për shkak se jo rrallë kemi pasur edhe dilema këtu në Kuvend që çfarë fuqie ka rezoluta, cilat janë rezolutat me karakter legjislativ?

Gjithashtu kemi pasur bukur probleme për fuqinë dhe efektin juridik të konkluzioneve me rastin e debateve dhe kërkesave për debate, më pak kemi pasur përvoja në këtë legjislaturë me deklaratat e Kuvendit, por me legjislaturën e mëparshme ne kemi pasur edhe praktikën e miratimit të deklaratave politike të Kuvendit të Kosovës dhe në leximin e dytë do të punojmë detajisht që plotësisht të rregullohet dhe asgjë të mos lihet e pa qartësuar për efektin juridik të akteve nënligjore që miraton Kuvendi i Kosovës.

Përgjithësisht nëpërmjet këtij ligji ne do të vendosim disiplinë juridike, do të vendosim rend juridik, sepse në Komisionin e Ligjeve shpeshherë na vijnë edhe projektligje edhe projektamendamente jo të mira të komisioneve nga fushat përkatëse dhe na krijohet një sistem jo koherent.

Po e zëmë shpeshherë na vijnë edhe strategjitë politike e shndërrohen në ligje dhe gjuha e këtyre ligjeve nganjëherë është shumë politike dhe ne e dimë se ligjet kanë një gjuhë normative dhe thjesht ne nuk duhet parë tash a e ka Kroacia a e kanë shtetet tjera, ne kemi nevojë ta kemi këtë ligj?

Për çka kemi nevojë, për shkak se ende kualiteti i ligjeve, i akteve tjera normative nuk është në nivelin e dëshirueshëm dhe në një mënyrë nëpërmjet këtij ligji ne po vendosim një disiplinë dhe po i obligojmë të gjitha institucionet ligjvënëse, por edhe institucionet tjera që bien aktet e përgjithshme normative që t'i respektojnë standardet e miratimit të ligjeve.

Gjithashtu ligji e ka përcaktuar mirë edhe procedurën e krijimit të transparencës, statusin juridik të Gazetës Zyrtare, procedurat e amendamentimit të ligjeve dhe thjesht është një bazë e mirë dhe në leximin e dytë është një orientim që unë ta udhëheq grupin punues për këtë ligj. Në leximin e dytë do të punojmë jashtëzakonisht me kujdes që ky ligj të marrë edhe tiparet e një kodi të hartimit të ligjeve dhe akteve normative dhe nëse jo kësaj legjislature, legjislaturës që vjen pas neve t'i krijojë një bazë që të bëjë ligje të mira, por

njëkohësisht të krijojë edhe një sistem të avancuar të shkrimit ligjor, sepse shkrimi ligjor është edhe shkencë, edhe art dhe ne kemi obligim që nëpërmjet këtij ligji të ngremë cilësinë e ligjeve, t'i obligojmë të gjitha ministritë, të gjitha departamentet dhe agjencitë që kur të bien ligje në Parlament dhe akte normative, t'i respektojnë standardet që i cakton ky ligj.

Kështu që Grupi Parlamentar i jep mbështetje të plotë dhe ne kontributin tonë do ta japim në leximin e dytë. Faleminderit!

KRYETARI: Radha është te Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike. Fjalën e ka deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Vetëm shkurt edhe në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, me vërejtjet që i thash edhe në emër të Komisionit, ne e përkrahim. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka në emër të Grupit “Vetëvendosje”, deputetja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Fillimisht më duhet të them që ne si subjekt politik mendojmë që Kosova ka nevojë për një ligj për akte normative, mirëpo asses i në mënyrën se si është përgatitur nga Qeveria, konkretisht nga Ministria e Drejtësisë.

Pra, fillimisht kritikë e veçantë kemi për të gjitha përkufizimet, për shumicën e përkufizimeve që janë të përmendura në këtë projektligj, si në aktin normativ, kushtetutshmërinë, ligjshmërinë, dekretin, Gazetën Zyrtare, pra të gjitha këto janë të përkufizuara në mënyrën më të keqe të mundur dhe në shpërputhje të plotë me ligjet në fuqi.

Në nenin 6, paragrafi 8, është theksuar se “nëse një autoritet jokompetent nxjerr akt normativ, ai akt normativ është i pavlefshëm”.

Aktet normative, përpos aspektit përmbajtësor material, duhet të jenë të përfillshme edhe në aspektin formal, pra të nxirren në procedurën strikte të paraparë me ligj.

Andaj, çdo nxjerrje në procedurë dhe nga organi inkompetent, akti i tillë duhet të konsiderohet si absolutisht i pavlefshëm e që në këtë dispozitë duhet të ceket se i njëjti në asnjë mënyrë nuk mund të prodhojë asnjë efekt juridik.

Projektligji duhet të specifikojë në mënyrë më të thuktë çështjen e spastrimit të tekstit ligjor, tek rasti i plotësimit apo të ndryshimit të aktit normativ. Jemi në dijeni se kritika më e theksuar në sistemin juridik të Kosovës është ngatërresa e akteve të veçanta me të cilat ndryshohen apo plotësohen aktet normative që janë në fuqi, andaj edhe pse në nenin 8 të Projektligjit është theksuar çështja e tekstit të konsoliduar të aktit, duhet në mënyrë më koncize dhe më të qartë të precizohen këto çështje.

Këtë projektligj, krahas gabimeve të shumta gjuhësore dhe gramatikore, e po ashtu jo mirë të konceptuara në aspektin e doktrinës juridike e bën të papranueshëm përmbajtja e nenit 27, në të cilin juridikisht njihet fuqia juridike e ligjeve të nxjerra para periudhës së 24 marsit 1999.

As rregulloret e UNMIK-ut, siç bie fjala ajo e 1999/1 dhe 1999/24, nuk e bëjnë prerjen e akteve ligjore në aspektin kohor, siç e bën ky projektligj i propozuar nga Qeveria.

Përderisa këto rregullore të UNMIK-ut njëra e bën shkëputjen më 10 qershor 1999, për të ndryshuar nga tjetra në periudhën 24 mars 1989, projektligji i përgatitur nga Qeveria, njeh periudhën e aparteidit dhjetëvjeçar të sistemit të Millosheviqit.

Pra, kjo përmbajtje e bën të papranueshme këtë për Lëvizjen “Vetëvendosje” dhe të njëjtën në këtë përmbajtje nuk mund ta votojmë as në parim.

Ky ligj do të jetë i pranueshëm për neve vetëm në qoftë se shprehimisht shfuqizon të gjitha aktet e periudhës së Milosheviqit.

Ne e patëm pasur edhe një debat parlamentar në lidhje me këtë, mirëpo fatkeqësisht ai nuk është miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Pra, përveç këtyre vërejtjeve sigurisht që ne do të bëjmë të pamundurën që propozimin tonë ta dërgojmë edhe në Komision apo në grupin punues. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit të Aleancës, kryetari Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Mendoj se disa gjëra të cilat kanë vlejtur të thuheshin u thanë nga disa parafolës. Projektligji me të vërtetë ka nevojë për disa ndryshime dhe me siguri se të gjithë kolegët që folën janë edhe anëtarë të Komisionit për Legjislacion dhe një punë të tillë do ta bëjmë.

Ne si Grup Parlamentar do ta mbështesim këtë ligj në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Përsëritet për ministrin, i cili e prezantoi Projektligjin për aktet normative.

Duke marrë parasysh se edhe nga parafolësit u pozicionua çështja e akteve normative që është dashur të jenë në viza-vi me kompetencat të cilat i cakton Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe ligjet të cilat janë në fuqi, Koalicioni për Kosovë të Re e mirëpret këtë projektligj për akte normative dhe njëkohësisht lut ministrin që gjatë amendamentimit të këtij projektligji që të jetë së bashku me ta për arsye se besoj që ministri dhe zëvendëskryeministri është në dijeni mjaft mirë që këto çështje të ligjeve, rregulloreve dhe vendimeve që u potencuan të jenë në një data bazë të përbashkët dhe të jenë në

sled termina koji moraju biti isti od prvog do poslednjeg člana zakona pa čak i šire, da budu u skladu sa postojećim važećim zakonodavstvom, što zakon i sam potencira.

Obzirom da se radi o velikim broju neispravnosti u srpskoj verziji Predloga zakona, odlučili smo da se prečišćenim tekstom na ceo Nacrt zakona predložimo jedan amandman koji će rešiti sva pitanja i sve jezičke neispravnosti. Ono što je bitno, naglasićemo da izmena srpske verzije ne menja suštinu i ne zahteva izmenu albanske ili engleske verzije.

Samim tim, Parlamentarna Grupa Zajednička budućnost podržaće Nacrt zakona u načelu, svoje predloge daćemo u dotičnoj komisiji. Hvala!

KRYETARI: Nuk ka të lajmëruar për diskutim. Për të votuar, s'e kemi numrin e domosdoshëm.

Vazhdojmë me pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

Ftoj zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Drejtësisë, zotin Hajredin Kuçi që para deputetëve të Kuvendit ta paraqet dhe arsyetojë projektligjin.

ZËVENDESKRYEMINISTRI DHE MINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit!

I nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës,

Të nderuar deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni që prapë të dalë para jush dhe ta prezantoj një projektligj, në vazhdën e projektligjit të parë që e prezantova sot, që ka të bëjë me plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë.

Natyrisht, e thashë edhe për ligjin e parë që e prezantova sot, edhe për këtë në veçanti ka interesim të veçantë nga qytetarët e Republikës së Kosovës dhe do të thosha në veçanti edhe nga mediet dhe shoqëria civile, po natyrisht edhe për neve secili që paraqitemi si zyrtarë të lartë publikë.

Natyrisht që ky qëllim i këtij projektligji është që të kemi një harmonizim të plotë me dispozitat tjera të Kodit Penal dhe të Kodit të Procedurës Penale dhe natyrisht edhe logjika e këtij ligji është e njëjtë me atë që e prezantuam më herët.

Natyrisht, ne kemi vënë një pasus në Kodin Penal, që natyrisht është do të thosha më i rëndë se sa me atë që ka qenë më herët, duke shndërruar mos deklarimin e pasurisë apo

deklarimin e rrejtshëm prej kundërvajtjes në vepër penale. Dhe ta them shumë publikisht që kjo nuk paraqitet në asnjë vend të Evropës, se nganjëherë po flasin njerëzit, jo në Evropë, jo këtu, është mirë t'i lexojnë ata që flasin dhe unë po them po ashtu që kjo është një formë e sanksionit të ashpër të ne, që ne e kemi vënë si standard.

A do ta mbajmë këtë standard edhe më tutje, me siguri që ka nevojë edhe për një kohë, por me siguri do të vijë koha kur qytetarët e vendit do të kërkojnë, edhe shoqëria civile, në veçanti përfaqësuesit e popullit që të relaksojnë këtë sikur vendet e tjera.

Po ashtu duhet të pranojmë se ky apo kjo dispozitë ka bërë një bujë të madhe edhe në opinionin publik, por edhe në realitet ka ndryshuar gjendjen ku 99% e zyrtarëve të lartë publikë kanë deklaruar pasurinë e tyre. Do të thotë është një deklaram shumë më i lartë se sa në vendet e tjera.

Po ashtu më lejoni të theksoj që edhe në këtë projektligj kemi harmonizuar dhe pranuar rekomandimet e Agjencisë Kundër Korrupsion, të përfaqësuesve të Prokurorisë dhe të gjyqësorit, po edhe ata të EULEX-it.

Më lejoni të theksoj që këtu reflektohen këto rekomandime dhe mundësojnë pastaj të bëjnë edhe më funksionale edhe deklarimin e tillë, po edhe punën e institucioneve dhe harmonizimin ndërmjet tyre.

Për hir të opinionit publik që është bërë pak ca zhurmë, më lejoni të theksoj se publikimi i të dhënave dhe i deklaratave do të vazhdojë të mbetet ashtu sikur që ka qenë deri më tani. Por, po ashtu, për hir të opinionit publik dua të them se ky standard është shumë i fuqishëm dhe do të thosha që është ndoshta unik edhe për vendin tonë.

Në vendet më demokratike të botës, edhe me këshillimin edhe të ekspertëve ndërkombëtarë, aty kërkohet që në mënyrë të kontrolluar dhe me kërkesë të arsyetuar të bëhet qasja në formularët e tillë.

Nëse Kuvendi mendon ndryshe, le të vendosë, por unë kam vendosur që të mbetet ashtu sikur ka qenë deri më tani.

Më lejoni që t'i theksoj disa ndryshime që janë bërë. E para, harmonizimi i plotë në Kodin Penal dhe të Procedurës Penale. Dhe kur e thotë dikush fjalën “zyrtar, person zyrtar”, me Kodin e ri Penal ka të bëjë me qindra dhe mijëra njerëz më shumë, nuk ka të bëjë me një njeri.

Po e them nocionin, nëse lexojmë mirë në mënyrë taksative çka shkruan në Kodin Penal dhe çka shkruan në këtë Kod, dhe çka ka shkruar në Kodin Penal të vitit 2004, do të shihni që ka të bëjë me mijëra njerëz më shumë.

E dyta, këtu përfshihen edhe personat zyrtarë të kompanive private, do të thotë merreni pak një krahasim, s'po dua të jap elaborim më të gjerë, por është një obligim bukur i gjerë.

Po ashtu më lejoni të theksoj që kemi dhënë mundësi dhe e kemi fuqizuar Agjencinë Anti-Korrupsion në kallëzimet penale që duhet t'i ofrojnë pranë prokurive përkatëse dhe besoj që këtu do të rritet dukshëm numri i kallëzimeve penale që do të ndodhë.

Kemi shtuar numrin e njerëzve të cilët do të deklarojnë pasurinë, dhe këtu përfshihet edhe kryetari apo kryetarja e Komisionit Qendror Zgjedhor, anëtarët e Komisionit Qendror Zgjedhor që s'kanë qenë deri më tani, të gjithë të emëruarit e presidentëve dhe anëtarët e Këshillit Drejtues të universiteteve publike.

Kemi bërë një transparencë më të madhe me qëllim që ky ligj të zbatohet edhe për anëtarët e familjes, duke zgjeruar këtë nocion. Dhe tani nocioni për anëtarët e familjes në ligj përfshin zyrtarë shumë më shumë dhe po ashtu përfshin edhe zyrtarët tjerë të lartë publik që nënkupton që rritet numri i zyrtarëve që janë të obliguar të deklarojnë pasurinë.

Ne kemi qenë të obliguar të deklarojmë për shumën mbi 5 000 euro, tani ka një ndryshim që do të jetë për shumën mbi 3 000 euro.

Dhe në fund, më lejoni të them që kemi zbatuar në mënyrë të qartë, të logjikshme, dispozitat ligjore për secilin institucion sipas rekomandimeve të tyre. Natyrisht që jeta është më evolutive se ligji dhe nuk mendoj që me këtë ligj do t'i vëmë pikë, por po them që është një bazë e mirë për funksionalitetin, deklarimin, transparencën po edhe për obligimin që deklarohen, qoftë pasuria, qoftë dhuratat.

Ju ftoj që me sugjerimet tuaja dhe me vërejtjet ta miratojmë dhe pastaj në leximin e dytë ta kemi me plotësimet tuaja. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë. Fjalën e ka kryetari i Komisionit Funkcional për Legjislacion, deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe konstaton se ligji ka bazë juridike dhe kushtetuese dhe i rekomandon seancës që të vazhdojë më tutje ta aprovojë këtë ligj sepse është i rëndësishëm. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Partisë Demokratike, deputeti Halit Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Ligji për deklarimin e pasurisë për prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin e prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë është trajtuar edhe në Grupin tonë Parlamentar.

Me theks të veçantë është trajtuar interesimi i publikut, debatet në shoqërinë civile dhe sidomos të gjitha ato apostrofimet e medieeve tona që e kanë rritur edhe vëmendjen tonë dhe këtë ligj e kemi vlerësuar se është begatuar me ashpërsimin e politikave nga praktikrat dhe dallon nga praktikrat e Bashkimit Evropian.

Dhe sidomos rritja e rrezes së përgjegjësisë së zyrtarëve që parashihet me këto ndryshime dhe plotësime, rritja e kompetencave të Agjencisë Anti-Korrupsion dhe një varg ndryshimesh dhe plotësimesh në këtë ligj e bëjnë jashtëzakonisht të favorshëm dhe e nxit mbështetjen e grupit tonë dhe e deklarojmë përkrahjen në parim të këtij projektligji dhe premtojmë që në ndërmjet dy leximeve do të japim kontributin tonë nëpërmjet përfaqësuesve në Komisionin përkatës. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Lidhjes Demokratike të Grupit, kush e kërkon fjalën? Deputeti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Përshëndetje, zoti kryetar!

Faktikisht kjo është edhe pjesa aty ku atakohen më së shumti edhe deputetët, edhe institucionet, te deklarimi i pasurisë së zyrtarëve të lartë. Nuk do të ishte shqetësuese edhe deklaramet publike po të ishin të sakta dhe korrekte, por shqetësuese është forma e interpretimit edhe në aspektin ligjor, por edhe në atë procedural, shpeshherë edhe medial.

Si do që të jetë ky plotësim-ndryshim i këtij ligji, do të ishte më mirë që Kuvendi ta kishte dhënë fjalën e vet nëse e kishte mbikëqyrur zbatueshmërinë aktuale të ligjit aktual, i cili ka kaluar në vitin 2011 dhe atëherë ne më lehtë do të vinim te përkufizimet dhe te objektivat tona se cilat janë temat që duhet të ndryshohen dhe duhet plotësuar.

Si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e kemi përkrahur edhe Projektligjin e kaluar, i përkrahim edhe këto ndryshim-plotësime, sepse mendojmë që me zgjerimin e bazës edhe të deklarimit, por edhe të mbikëqyrjes dhe kompetencave të shtuara për Agjencinë Kundër-Korrupsion mendojmë që ne i ndihmojmë edhe procesit, por i ndihmojmë edhe parandalimit të keqpërdorimit të parasë publike apo të asaj që ne e quajmë mos deklarimit, fshehjes së pasurisë së deklaruar.

Por një gjë duhet ta kemi parasysh, sepse edhe tash edhe në të ardhmen, besoj që duhet të ekzistojë vullneti i institucioneve përkatëse siç është Prokuroria dhe gjykatat dhe pjesa që bie tash mbi Agjencinë Kundër-Korrupsion në ushtrimin e kallëzimeve penale.

Derisa këto nuk e kryejnë punën e vet, atëherë edhe deklaramet publike edhe mediale, edhe retorika, edhe e politikës për ligjet e mira të Kuvendit, të Qeverisë edhe institucioneve tjera, mendoj që do të mbetet në letër dhe prapë vitin e ardhshëm do të ketë nevojë për plotësim-ndryshim.

Unë mendoj që institucionet duhet ta kryejnë punën e vet. Ata që kanë përgjegjësi ta deklarojnë pasurinë duhet ta deklarojnë atë pasuri dhe aty ku ka hapësirë për të hetuar duhet hetuar dhe duhet ai proces të shkojë deri në fund, pa ndonjë ndikim politik, kështu që ne i japim përkrahje në parim dhe do të kontribuojmë në begatimin eventualisht të ndonjë amendamenti të caktuar që paraqitet në këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të “Vetëvendosjes”, fjalën e ka deputetja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Një qartësim, pas asaj që tha ministri, në kohën kur Kodi Penal është sjell në Kuvend, pra nga Qeveria, nuk ke qenë e parapare si vepër penale deklarimi i rrejshëm i pasurisë ose mos deklarimi i pasurisë, mirëpo është amenduar nga Komisioni për Legjislacion, konkretisht nga grupi punues dhe shoqëria civile. Pra, kjo është bërë pasi që ka ardhur në Kuvend nga Qeveria.

Dhe sa i përket kryetarit të KQZ-së dhe anëtarëve të Komisionit të Zgjedhjeve, ata kanë qenë të obliguar të deklarojnë pasurinë edhe me ligjin aktual, pra këtë e gjeni më së miri edhe në ueb-faqen e Agjencisë kundër Korrupsionit, kështu që nuk është ndonjë ndryshim që është bërë tani.

Në memorandumin shpjegues thuhet që me këtë plotësim- ndryshim po plotësohet pakaja ligjore kundër korrupsionit, mirëpo ne mendojmë që pakaja ligjore kundër korrupsionit plotësohet kur ky Kuvend miraton Ligjin anti mafia, Ligjin kundër korrupsionit dhe Ligjin për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme, të cilin tashmë ne si subjekt politik e kemi dërguar në Kuvend.

Në nenin 1, paragrafi 8 të projektligjit përkufizohet anëtari i familjes, ku ndër të tjera thuhet: personi me të cilin kryerësi jeton në bashkësi jashtë martesore, mirëpo këtu nuk kemi të bëjmë me kryerësin e veprës penale, por me anëtarët e familjes së zyrtarit të lartë, andaj fjala “kryerësi” duhet të zëvendësohet me “zyrtarit të lartë”.

Në nenin 6, thuhet se dhuratat e rastit konsiderohen dhuratat e vogla me vlerë deri në 25 euro dhe se zyrtari i lartë nuk mund të pranojë dhurata të rastit vlera e të cilave kalon mbi 500 euro. Mendojmë që është riformuluar gabim pasi që është shumë e vështirë që do të dihet vlera reale e dhuratës nga zyrtari i lartë, kështu që mendojmë që nuk duhet të ketë fare vlerë të caktuar ose-ose për çfarëdo lloj dhurate, të cilën e pranon zyrtari i lartë, është i obliguar që ta njoftojnë Agjencinë Kundër Korrupsionit, në mënyrë që të dihet vlera reale e dhuratës.

Në paragrafin 6 të nenit 7 thuhet se Agjencia Kundër Korrupsionit ka detyrim ligjor për mbajtjen e regjistrave deri në 10 vjet, por nuk qartësohet se çka bëhet pas 10 vjetëve me ato regjistra të dhuratave. Pse duhet të kufizohet kjo çështje, mendojmë që regjistrat e dhuratave të gjitha pra duhet të mbeten në arhivën e institucionit, pra në këtë rast të Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe nuk kemi nevojë të caktojmë ndonjë afat.

Me nenin 11 të projektligjit ndryshohet neni 17 i ligjit në fuqi, por se janë hequr dënimet me gjoba dhe nuk dihet se pse janë hequr ato dënime, andaj mendojmë që edhe neni 17 i ligjit aktual duhet të mbetet në ligj.

Pra, këto janë disa nga vërejtjet tona dhe sigurisht se ne do ta votojmë në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit të Aleancës, e ka fjalën kryetari Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Prapë shkurt. Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës do ta mbështesë në parim këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit të Koalicionit për Kosovë të re, deputetja Suzan Novobërdaliu e ka fjalën.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, kryetar!
Edhe Koalicioni për Kosovë të Re, në parim e mbështet këtë projektligj.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit “Zajednička Budućnost”, kryetar i Grupit, Goran Marinković e ka fjalën.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala predsedniče!
Poslanička grupa Zajednička budućnost je pažljivo razmatrala Nacrt zakona o deklarisanju poreklu, kontrolu imovine visokih javnih zvaničnika i podržace usvajanje istog nacrta zakona ali moramo da posebno obratimo pažnju na termine - alineja ili tačka, u članu 1 stavu 7 u pitanju su sinonimi za termin “postav” koji se koristi u svim zakonskim rešenjima tako da dalje objašnjenje termina „postav“ nije potrebno a termine “alineja, podtačka”, treba obavezno brisati.

Moramo obratiti pažnju u članu 1. stav 8. po meni je najvažniji član jer određuje šta se smatraju članovi porodice. Veoma je važna preciznost ovog člana, takođe i u članu 7. postavu 9, predviđa se obaveza čuvanja dokumentacije jer ceo član je smisao dužina i čuvanja evidencije po službenoj dužnosti.

Poslanička grupa Zajednička budućnost kao što sam rekao podržace usvajanje ovog Nacrta zakona i u svom radu u komisijama daće određene amandmane. Hvala.

KRYETARI: Grupet tjera nuk janë të lajmëruara. Për diskutim është lajmëruar deputeti Haki Demolli.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, kryetar!
I nderuar zëvendëskryeministër, njëherit edhe ministër i Drejtësisë.
Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Draftligjin me të cilin plotësohet dhe ndryshohet Ligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë e kam lexuar me vëmendje dhe interes të posaçëm për shumë e shumë arsye.

Në radhë të parë për shkak se në shtetin tonë viteve të fundit, dukuritë e korrupsionit dhe krimet të organizuar në të cilat janë involvuar zyrtarë të lartë publikë janë përhapur aq shumë sa që nuk ka thuaja se sferë të jetës dhe institucion apo organ shtetëror që në një mënyrë apo në tjetrën nuk është i afektuar nga këto dukuri negative.

Arsyeja tjetër është se këtyre viteve të fundit, në vazhdimësi është duke u rritur pasuria e zyrtarëve të lartë publikë dhe atë në mënyrë enorme sa që disave prej tyre pasuria u është

bërë jo vetëm milionëshe, por edhe me dhjetëra milionë, e prejardhja e së cilës assesi nuk mund të arsyetohet apo të argumentohet.

Arsyeja tjetër është se në vazhdimësi kemi kërkesa nga faktorët ndërkombëtarë, përfshirë këtu edhe Komisionin Evropian, që shteti i Kosovës të fillojë luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar me një qasje më konkrete dhe serioze, nëse pretendon dhe synon që një ditë të bëhet anëtare me të drejtat e plota në Bashkësinë Evropiane dhe në organizatat tjera relevante ndërkombëtare.

Arsyeja e radhës për leximin me përkushtim të këtij drafti është deklarimi i vazhdueshëm thuaja se bosh i Qeverisë dhe organeve tjera relevante, si Presidencës, prokurorit, Policisë për zero tolerancë ndaj korrupsionit dhe krimin të organizuar në Kosovë.

Andaj duke pasur parasysh se ky ligj paraqet njërin prej hallkave të infrastrukturës tonë ligjore që do të duhej ta ndihmonte në mënyrë direkte luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, kam qenë thellësisht i bindur dhe kam pritur se në këtë draft do të bëhen ndryshime dhe plotësime përmbajtësore të cilat do të shkonin në favor të zbulimit dhe të ndjekjes penale të zyrtarëve të lartë publikë të cilët janë pasuruar në kurriz të popullit duke keqpërdorur dhe përvetësuar paratë publike dhe postet e tyre publike.

Mirëpo, pas leximit të tij kam parë se ky draft përmban disa ndryshime më shumë të karakterit sipërfaqësor se sa të karakterit përmbajtësor, e të cilat do të sforconin luftën kundër korrupsionit dhe formave të tjera të krimin që sjellin përfitime të konsiderueshme pasurore nga të cilat fatkeqësisht ka përfituar edhe një numër i madh i zyrtarëve tanë publikë.

Sipas mendimit tim, ky ligj do të ishte më i dobishëm në luftë kundër krimeve të kryera nga zyrtarët e lartë publik sikurse në normat e këtij ligji të përcaktohej obligimi që për çdo cent apo më mirë thënë për çdo milion të deklaruar para Agjencisë të argumentojnë me prova dhe dokumente konkrete se si e kanë siguruar dhe prej nga është prejardhja e pasurisë së tillë dhe jo vetëm të bëhet deklarimi formal i saj.

Po ashtu mendoj se ky ligj do të ishte një mjet i fuqishëm në luftë kundër korrupsionit dhe formave tjera të krimin, sikurse të përmbante një dispozitë me të cilën do të përcaktohej si vepër penale pasurimi i kundërligjshëm, e cila vepër ekziston në legjislacionet e shumë vendeve të botës, e në veçanti të atyre që kanë probleme me dukurinë e korrupsionit.

Mendoj se inkriminimi i një veprimi të tillë, pra pasurimit të kundërligjshëm duke përcaktuar që deklaruesi ka obligim për të dëshmuar apo argumentuar prejardhjen e pasurisë së vet, do të ishte një bazë e mirë juridike jo vetëm për t'u ndjekur dhe ndëshkuar penalisht krimet e zyrtarëve të lartë publikë, por do të ishte një bazë e mirë edhe për konfiskimin e pasurisë së tyre të krijuar me veprime të kundërligjshme në dëm të parasë publike dhe pasurisë së popullit të varfëruar kosovar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Të lajmëruar nuk kemi. Natyrisht, kuorumin e domosdoshëm nuk e kemi. Po e marrim një pauzë, dhe fillojmë në orën 15:00, por po ua tërheq vërejtjen

që kryesisht në pjesën e dytë kemi votim dhe jo vetëm që duhet kuorumi, por duhet ta dinë ata deputetë që s'marrin pjesë në votim, s'mund ta marrin mëditjen për seancat plenare.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes pas pauzës

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: E vazhdojmë me seancën. Ju njoftojmë se sipas elektronikës, të pranishëm janë 88 deputetë, prania fizike 61. Ne i kemi pikat 9 dhe 10, por para këtyre e kemi votimin e tri pikave të rendit të ditës. Kemi votimin në parim për Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Të pranishëm janë 68 deputetë. Me 62 vota për, 1 kundër, 1 abstenim, Kuvendi e miratoi në parim projektligjin nr. 04/L-227 për plotësim dhe ndryshimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportin me rekomandime.

Votimi në parim për projektligjin për aktet normative. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. 68 deputetë të pranishëm. Votojmë tash!

Konstatohet se me 59 vota për, 7 kundër, asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 04/L-229 për aktet normative. Tani i kemi të pranishëm 72 deputetë.

E votojmë në parim Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për deklarimin e prejardhjes dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 69 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin nr. 04/L-228 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

E njëjta gjë vlen edhe për votimin në parim të Projektligjit për akte normative.

Jemi te pika e 9-të e rendit të ditës, e kemi një kërkesë nëse ju jeni dakord, por edhe nëse kanë ardhur këta - Auditori i Përgjithshëm që pikën e 10 ta vëmë në shqyrtim para pikës 9. A jeni dakord? Ne jse unë vetëm, po pyes. E kemi një kërkesë të tillë që e ka bërë ministri.

Vazhdojmë me pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i raportit vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2012

Raporti vjetor i Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2012, ka qenë i radhitur në seancën plenare më 12 shtator 2013, por me kërkesën e kryetarit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, është hequr nga rendi i ditës me qëllim që të plotësohet edhe me raportin e auditimit të vitit 2010 dhe 2011.

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar raportin vjetor të Radiotelevizionit për vitin 2012 dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij.

Tash është radha e diskutuesve. Fjalën e ka kryetari i Komisionit Funkcional, Idriz Vehapi, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti ministër,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në bazë të nenit 67 dhe 72 të Rregullores të Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 30.4.2013 ka shqyrtuar raportin vjetor të RTK-së për vitin 2012 dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këtë:

R E K O M A N D I M

Të miratohet raporti vjetor i RTK-së për vitin 2012. Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në mbledhjen e sipërpërmendur shqyrtoi raportin vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës dhe ka vlerësuar se i njëjti i përmbush obligimet ligjore për raportim Kuvendit dhe i rekomandon miratimin e tij. Faleminderit!

Fjalën e ka kryetarja e Komisionit për Buxhet dhe Financa, Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Në pajtim me nenin 30, paragrafët 8 dhe 9 të Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës, Bordi i RTK-së është detyruar që për punën e vet t'i raportojë themeluesit të tij në mënyrë të rregullt dhe të jashtëzakonshme. Raportimi i rregullt i Bordit për punën e tij bëhet në mënyrë periodike një herë në çdo tre muaj dhe në fund të çdo viti, kurse raportimi mund të bëhet edhe sipas kërkesës së themeluesit. Në kuadër të këtij raportimi, Radiotelevizioni i Kosovës është i obliguar që t'i paraqesë Kuvendit, respektivisht

Komisionit për Buxhet raportin vjetor financiar, kështu që Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 5 qershor 2013, ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2012 dhe ka vlerësuar se në raportin e shpenzimeve janë pasqyruar të hyrat dhe shpenzimet në mënyrë të detajuar. Po ashtu, është paraqitur edhe krahasimi i të hyrave dhe shpenzimeve për vitin 2011 dhe vitin 2012.

Radiotelevizionin e Kosovës me vite e ka përcjellë një deficit buxhetor edhe në vitin 2012, Radiotelevizioni i Kosovës ka pasur një deficit buxhetor prej 4%. Radiotelevizioni i Kosovës në çdo takim të mbledhjes së Komisionit e ka përcjell gjendjen e borxheve në Komisionin për Buxhet dhe Financa, të cilin borxh e ka trashëguar nga vitet e kaluara, kurse në vitin 2012 ky deficit buxhetor llogaritet të jetë 122 336 euro.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka kërkuar nga Radiotelevizioni i Kosovës të paraqesë një raport të detajuar rreth borxheve të këtij institucioni si dhe të paraqesë një plan të detajuar se si e parasheh mbulimin e deficitit buxhetor me të cilin përballlet. Radiotelevizioni i Kosovës ende deri me tani nuk ka paraqitur një raport të tillë dhe nuk ka paraqitur planin se si e parasheh mbulimin e deficitit buxhetor.

Komisioni për Buxhet dhe Financa unanimisht e ka përkrahur raportin financiar të Radiotelevizionit të Kosovës dhe i rekomandon Kuvendit që ta miratojë.

KRYETARI: Fjalën e ka kryetari i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, deputeti Ali Sadriu

ALI SADRIU: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

E nderuara Kryesi e Kuvendit,

Të nderuar kolegë,

Shqyrtimi i raportit vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2012, së bashku me pasqyrat financiare të audituara. Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, në mbledhjen e mbajtur më 20 korrik 2011, ka shqyrtuar raportin e auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2010.

Në mbledhjen plenare të datës 29 korrik 2011, me propozim të Komisionit është miratuar rekomandimi i Kuvendit me rekomandim i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, me të cilin obligohet Radiotelevizioni i Kosovës, që në afat prej tre muajve të ndërmarrë veprime konkrete lidhur me të gjitha të gjeturat e Zyrës të Auditorit të Përgjithshëm dhe lidhur me këtë ta njoftojë Kuvendin nëpërmjet Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, me raport me shkrim.

Raporti vjetor i Radiotelevizionit, i planifikuar për shqyrtim nga Kuvendi me datën 15 ... 2012, me propozim të kryetarit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike është shtyr me qëllim që në Kuvend të procedohet edhe raporti i kërkuar nga Komisioni.

Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike, me kërkesën e datës 21 nëntor të vitit 2012, ka kërkuar nga Radiotelevizioni që të dorëzojë në Kuvend raport me shkrim në

bazë të vendimit të Kuvendit, nr. 24-v/147 të datës 29 korrik 2011, një përgjigje nga RTK nuk e kemi pranuar. Me kërkesë të Komisionit, Kryesia e Kuvendit ka intervenuar dhe ia ka bërë një kërkesë të përsëritur Bordit të Radiotelevizionit. Më pastaj Komisioni ka marrë një material, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e ka shqyrtuar raportin vjetor të punës bashkë me pasqyrat vjetore financiare të audituara për vitin 2012. Po ashtu, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike ka analizuar me shumë kujdes raportin e auditimit të RTK-së për vitin fiskal 2011, në të cilin raport GZAP-i kishte konstatuar një varg shkelje për cilat i ka dhënë 9 rekomandime në fushat e ndryshme si në shpenzime, prokurim, personel dhe në fushën e menaxhimit të financave.

Rekomandimet në përgjithësi kishin të bëjnë me mënyrën e menaxhimit të RTK-së ngase edhe vetë auditori kishte për fushëveprim menaxhimin e RTK-së. Të gjeturat e GZAP-it në fushën e menaxhimit të financave dhe kontrollit, në fushën e menaxhimit të resurseve humane, në fushën e menaxhimit të hyrave dhe shpenzimeve të buxhetit, në fushën e menaxhimit të kontratave të prokurimit, ishin të adresuara menaxhmentit të RTK-së, gjegjësisht bordit, drejtorëve të RTK-së. Vlen të ceket se borxhet e bartura nga viti në vit, ne e kemi përshtypjen në bazë të dhënave që posedojnë se ato borxhe janë për momentin të panjohura dhe frikësojmë se një ditë ky institucion do të gjendet para një situatë që do ta sfidojë edhe Kuvendin.

Me qëllim të zgjedhjes dhe të adresimit të gjeturave, Komisioni i ka rekomanduar menaxhmentit të RTK-së për përgatitjen e një plani të veprimit për adresimin e rekomandimeve. RTK pas insistimeve të shumta të Komisionit edhe të Kryesisë të Kuvendit, ka dorëzuar në Kuvend një plan veprimi dhe hapat që do të duhej t'i ndërmerre. Komisioni ka shqyrtuar të njëjtin dhe ka ardhur në konstatim se adresimi i çështjeve nuk ka ndodhur në mënyrën dhe thellësinë e trajtimit të tyre. Për të qenë më të bindur, Komisioni ka kërkuar edhe mendimin e Zyrës së Auditorit Gjeneral rreth atij plani të veprimit të cilin e ka dërguar menaxhmenti i RTK-së.

Komisioni po ashtu konstaton se edhe Zyra e Auditorit del me konstatim se plani i veprimit është i mangët dhe nuk ofron informata të mjaftueshme lidhur me kohën dhe mënyrën e adresimit të rekomandimeve. Me Ligjin për RTK-në nr. 04/L-046, neni 37 i është mundësuar RTK-së që të bëjë përzgjedhjen e Auditorit të Jashtëm. Kjo për Komisionin përbën konflikt interesi, sepse Auditorin e Jashtëm duhet ta përzgjedhë aksionari e jo vetë etniteti i audituar. Lidhur me këtë Komisioni ka rekomanduar plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit të RTK-së, pra 04-L/046, përkatësisht me pjesën që ka të bëjë me auditorin e RTK-së dhe kompania audituese e përzgjedhur nga vetë RTK-ja, ka dhënë opinion të kualifikuar për RTK-në. Ky opinion është i bazuar në të dhënat e pasqyrave financiare vjetore të Radiotelevizionit.

Për më keq, me vite të tëra Radiotelevizioni ankohet për mungesë të mjeteve buxhetore të bollshme. Në rastin konkret kur atij i konvenon me para të veta angazhon një kompani private dhe ironia më e madhe për te i del se edhe ai auditor i jap opinionin e kualifikuar që nënkupton se nuk është opinion i mirë dhe kryesisht ka të bëjë me regjistrin e pasurive, si dhe mungesës së listës së plotë të aseteve dhe vendndodhjen e tyre. Dhe nënë dy, Radiotelevizioni ka shumë padi nga operatorët e ndryshëm ekonomikë për shkak të

mospagesës së borxheve ndaj tyre të fundit. Sa i përket raportit vjetor të punës, ai është më tepër përshkrim i aktiviteteve vjetore të dy radiove dhe televizionit e nuk i fokuson në aktivitetet matëse të arritjes objektivat e RTK-së sipas planit vjetor të punës.

Për të pasur një pasqyrë të qartë për gjendjen e RTK-së, Komisioni i ka rekomanduar Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, që të bëjë një auditim të performansës për punën e RTK-së. Faleminderit!

KRYETARI: Vazhdojmë me diskutimet. Në emër të Partisë Demokratike, fjalën e ka deputetja Xhevahire Izmaqu.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi ynë Parlamentar e ka shqyrtuar Raportin e punës së Radiotelevizionit për vitin 2012 dhe nxjerr këto të dhëna, pa pjesën e financave. Unë do të flas kryesisht për punën e skemës programore dhe për departamentet në veçanti. Bordi aktual në këtë raport konsiderojmë se ka dhënë disa sqarime reale ku neve si deputetë na është bërë më e qartë situata e rënduar financiare dhe disa probleme tjera që shoqëruan RTK- në vitin 2011 dhe 2012.

Për herë të parë në qershor të këtij viti, kryetari i Bordit të RTK-së i është drejtuar Asamblesë së Përgjithshme të IBIUS, kur ka kërkuar pranimin e RTK-së në këtë organizëm. Ky bord brenda afateve ligjore ka zgjedhur menaxhimet të ri të RTK-së, përfshirë dy kanale televizive - Radio Kosovën. Gjithashtu në pajtim me Ligjin e Radiotelevizionit të Kosovës, bordi ka ofruar alternativat për financimin e qëndrueshëm të Radiotelevizionit të Kosovës, alternativë e cila mbetet të diskutohet nga ne deputetët dhe është një kërkesë e domosdoshme të vendoset njëherë e përgjithmonë, pra një zgjidhje e qëndrueshme financiare dhe të largohemi nga perceptimi për politizimin e transmetuesit publik.

Në këtë raport edhe kryetari i Bordit, por edhe drejtori gjeneral paraqesin sfidat në të cilat kalon transmetuesi i vetëm publik në vend, ndër to pajisjet shumë të vjetruara teknologjike, mungesën e një objekti i cili do t'i përmbushte nevojat për të dy kanalet televizive dhe radiot. RTK gjatë vitit 2012 ka përshtatur nevojat e shumta përballë përmbushjeve ligjore, por vërejtjet tona si grup parlamentar kanë një fokus të qartë, me gjithë këto vështirësi financiare dhe sfida të tjera ne si deputetë dhe si qytetarë të këtij vendi normalisht që presin shumë më shumë program kualitativ nga transmetuesi publik. RTK ka arritur t'i përballojë sfidat e shumta me të cilat është ballafaquar. Si rezultat i gjendjes tepër të keqe të pajisjeve tashmë të amortizuara teknologjike ka problem në prodhimin dhe transmetimin e programit të vet.

Afati i kalimit nga sistemi analog i prodhimit dhe i transmetimit të programit po afron, kurse RTK, fatkeqësisht në mungesë të mjeteve financiare ka arritur ta hartojë vetëm një plan strategjik për këtë proces.

Programi i lajmeve

Programi i lajmeve në Radiotelevizionin e Kosovës është pjesa më e vlerësuar. Në këtë drejtim ne e vlerësojmë punën e mirë që bëhet nga e gjithë menaxhmenti dhe stafi duke krijuar edicione të lajmeve të sakta dhe të paanshme. Dhoma e Lajmeve përmbush misionin e vet themelor duke ofruara fakte dhe prezantuar argumente në ngjarjet apo debatet që zhvillohen. Përpyekjet e RTK-së për të pasur larushi të programeve ende nuk e ka përmbushur nevojën që ka sot qytetari i vendit kur pjesa kulturore dhe sociale është shumë më e varfër se sa Sektori i lajmeve dhe i emisioneve të llojit debat i hapur.

Programi i Mëngjesit dhe Magazina e së Dieles janë programe të cilat me një strukturim më kreativ mendojmë që mund të mbeten emisione të vlerësuara, por gjithsesi këto emisione duhet të kenë më shumë jetë, më shumë ngjyra, të ikin sadopak edhe nga studiot e ftohta të realizuara permanent. Emisionet të cilat nuk janë produkte të Radiotelevizionit, mendojmë që herë pas here kanë një rol të cilin nuk mund ta transmetojmë brenda një transmetuesi publik, nuk mund ta shfaqin. Pra, në këtë drejtim, menaxhmenti gjatë përfshirjes së tyre duhet të ketë kujdes në objektivitetin e tyre, konkretisht emisionet të cilat në përpjekje për të trajtuar çdo problem dhe diskutim, mund t'i devijojnë qëllimet e mira të tyre.

Ne si Grup Parlamentar mendojmë që Redaksia për të rinj ka nevojë që të përmbushet, pasi ato emisione realizohen në transmetues publik, mirëpo metodat e tyre janë shumë të vjetruara dhe nuk u përshtaten zhvillimeve të reja.

Po ashtu, Redaksia e Argëtimit ka një ngritje, mirëpo ende qëndron larg së dëshiruarës. Redaksia e Kulturës bën një punë shumë të mirë mendoj dhe ka një qasje serioze.

Programet për fëmijë, edukative-arsimore janë emisione shumë të largëta me realitetin. Edhe këto nuk i përshtaten trendëve të zhvillimit as mënyrës si prodhohen as mënyrat si bëhen ato emisione.

Grupi ynë Parlamentar e vlerëson punën e mirë që është bërë rreth festave zyrtare dhe shtetërore dhe përcjelljes së këtyre evenimenteve me emisione të drejtpërdrejta.

Misioni i RTK-së është që t'i afrojë auditorit informim objektiv dhe të balancuar, program cilësor, edukativ, kulturor, argëtues, si dhe të inkurajojë zhvillimin harmonik të demokracisë dhe tolerancës.

Në këtë drejtim e vlerësojmë dhe me mbështetjen pra të Kuvendit, RTK arriti që këtë vit ta hapë edhe kanalën 2 për komunitetin serb. Në këtë raport menaxhmenti ankohet për teknologjinë e vjetruar të RTK-së, sigurisht që edhe ne nga menaxhmenti kërkojmë që të ketë ide alternative se si mund të pajisen me teknologji të re, sigurisht duke racionalizuar një buxhet apo duke e dedikuar buxhetin në mënyrë që të kenë teknologji të re.

Radio Kosova mendojmë se po e përmbush me sukses misionin e vet, konkretisht Programi Informativ si segment më i rëndësishëm i programit të Radio Kosovës është

përqendruar në mbulimin e zhvillimeve kryesore nga të gjitha fushat dhe trajtimin tematik të ngjarjeve, proceseve politike në vend.

Vëmendje e posaçme gjatë vitit 2012 i është kushtuar analizës dhe debatit nga Redaksia e Aktualiteteve.

Kemi emisione të përditshme, forum dhe emisione të përjavshëm të bashkëprodhuar me Radio Tiranën dhe Radio Shkupin. Më 17 shkurt 2012, Radio Kosova ka startuar me edicion të ri të lajmeve në gjuhën angleze, i cili transmetohet çdo ditë në orën 17:00 dhe zgjat 5 minuta.

Edicioni është përmbledhja e ngjarjeve kryesore të ditës, të cilat i sigurojnë audiencës së huaj në Kosovë informacion të shpejtë dhe objektiv për zhvillimet në vend.

Të mos harroj të përmend se vërejtjet tona normalisht qëndrojnë edhe tek Redaksia e filmave ku shihet që ka një mungesë, mirëpo vlerësojmë Programin e sportit i cili duket që është një program mirë i realizuar.

Komunat po ashtu kanë vërejtje për mosmbulueshmëri të informacioneve dhe aktiviteteve të tyre, gjithashtu vërejtjet tona qëndrojnë ende te Programi arsimor.

RTK, pra përfundimisht ka nevojë urgjente të ketë përkrahjen për strategjinë e digjitalizimit. RTK-së i duhet një alternativë e re e financimit, një pronë legjitime e saj. RTK 2 duhet që në programin e vet t'i përmbahet ligjit dhe të përfshijë 15% të programit në gjuhët tjera joserbe.

Me gjithë këto vërejtje, menaxhmenti i ri mendon që ka një vullnet për një punë më energjike dhe presim shumë më shumë kualitet dhe diversitet në programet e RTK-së, një përgjegjshmëri më të lartë përball qytetarëve të cilët duan një RTK me plot arsye më të zhvilluar.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e mbështet raportin dhe do të votojë pro. Faleminderit!

KRYETARI: Nga LDK-ja, fjalën e ka deputetja Lirije Kajtazi.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar ministër,

Sot kur po shqyrtojmë raportin vjetor të RTK-së për vitin 2012, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së për pjesën e performansës veç foli zoti Sadriu për pjesën e parë, do të prezantojmë qasjen për të ndikuar në politika të mira dhe të drejta të RTK-së në mënyrë që ky institucion ta ruajë dhe mbrojë misionin e vet ligjor që e ka, t'i ofrojë Auditorit në Kosovë dhe më gjerë informim objektiv të balancuar, program cilësor edukativ, kulturor dhe argëtues dhe në këtë mënyrë t'i kontribuojë zhvillimit të demokracisë në shtetin tonë.

Nuk do të hyj në pjesën financiare, dhënë në raportet nga komisionet kompetente edhe pse gjithçka thuaja se sillet rreth parasë, edhe ajo që ka të bëjë me avancim të teknologjisë, edhe ajo që ka të bëjë me performansën dhe të gjitha të tjerat lidhen në këtë drejtim.

Edhe raportet më të reja të monitorimit të publikuar tani flasin për anshmërinë politike të RTK-së, kjo s'do koment ku të Partisë në pushtet, vëzhguesit e zgjedhjeve të BE-së, po them raporti më i ri, vëzhguesit e zgjedhjeve flasin për një favorizim të PDK-së gjatë transmetimeve që tani janë bërë këtyre ditëve. Po them, raporti më i freskët, përndryshe nuk po flas për monitorim të institucioneve vendore se menjëherë po pasojnë me sanksione.

Edhe pse edhe kryetari i Bordit të RTK-së edhe drejtori gjeneral në mbledhjen e Komisionit Parlamentar të Medias, por edhe në këtë raport këtu, shprehin brengat për borxhet që e përcjellin këtë medium, ata për çdo ditë vazhdojnë të ngarkojnë këtë institucion me borxhe të reja edhe pse Qeveria është munduar edhe me rishikimin buxhetor që t'i nxjerrin nga kjo krizë.

Të mos mendojë dikush se borxhi merret për avancim të teknologjisë, as për kualitet programor, asnjëherë nuk bëhet kjo, por vazhdimisht vazhdohet me pjesën e punësimeve të parregullta, pa procedura ligjore të rekrutimit, por normalisht me ndonjë të afërm familjar siç vazhdon të trashet nepotizmi në atë institucion.

Në raport prezantohen 557 të punësuar të rregullt, apo 625 totali me pjesën e menaxhmentit dhe punësime ad hoke. Unë dua të pyes publikisht - a është e vërtetë kjo listë apo ka edhe shumë e shumë të punësuar dhe ne e dimë saktësisht se lista është më e gjatë, këtë pyetje e kemi bërë edhe në Komision Parlamentar dhe nuk është prezantuar lista reale, prandaj besoj se në këtë drejtim duhet të jepet llogari. Po ashtu, kemi tejkalim të shpenzimit buxhetor në këtë fushë, 110%, a ka punëtorë që paguhen edhe pse asnjëherë nuk e shohin të nevojshme të dalin në punë, edhe pse e dimë që mesatarja e pagës në këtë medium është dyfishi i mesatares së pagës në Kosovë.

Gjersa këtu e kemi këtë tejkalim të shpenzimeve, në anën tjetër ndizet alarmi për këtë kolaps të pjesës së zbatimit të punës dhe teknikës, ngase nuk është investuar fare në teknologji, normalisht se kjo ndikon edhe në kualitetin programor.

Natyrisht për LDK-në mbeten shqetësuese këto gjëra, pavarësia editoriale, edhe pse kolegja nga Komisioni nga radhët e PDK-së përmendi fjalët lavdëruese nga EBU, ne e dimë saktë, ka qenë letër e publikuar të cilën e kemi parë, letër zyrtare, shqetësimi i drejtorit të EBU-s i cili shpreh shqetësimin e vet, po them, për rrëshqitjen e këtij mediumi publik në dorë të partisë në pushtet. Është letër po them zyrtare të cilën e kemi parë secili nga ne.

Po ashtu shqetësuese mbetet kualiteti apo për të dëshiruar mbetet kualiteti programor, politikat kadrovike. Është interesante në pyetjen që i kemi bërë menaxhmentit në Komision për ndërhyrjet politike, menaxhmenti është shprehur, thotë: ka vullnetarizëm

politik, por s'ka ndërhyrje. Do të thotë kjo është një kriter ndoshta edhe i marrjes në punë dikujt për ta shprehur atë vullnetarizëm politik.

Po ashtu mbetet të shihet si shpenzohet buxheti, kush janë kompanitë që përfitojnë nga buxheti i RTK-së, kush janë pronarët e kompanisë pro-media përfituese mjaft e madhe e parasë të buxhetit që i ndahet RTK-së edhe shumë shqetësime tjera të cilat në mënyra të ndryshme i kemi parë, qoftë në media apo në forma tjera dhe si të tillë e shohim se ka nevojë të korrigjohet shumë dhe në këtë mënyrë nuk mund edhe ta marrë votën e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, Afrim Kasolli e ka fjalën.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar dhe të nderuar deputetë!

Diskutimi i raportit vjetor të Radio-televizionit të Kosovës për vitin 2012 ngërthen në vetvete shumëçka paradoksale. Është e ditur se ky Kuvend edhe vitin e kaluar e kishte refuzuar një raport të ngjashëm për vitin 2012 për arsye sepse ai raport nuk adresonte shumë nga dyshimet që ekzistonin mbi parregullsitë financiare në këtë institucion.

Dihet që RTK gjatë vitit të kaluar asnjëherë nuk solli informacione të plota dhe të detajuara për këtë çështje, ndoshta kjo zaten ka qenë edhe arsyeja kryesore edhe pse personalisht pata votuar kundër këtij raporti, edhe në Komision Parlamentar për Media, ngase mungonin informatat e duhura.

Por, sidoqoftë, ndër arsyet tjera të votimit kundër këtij raporti, ne konsiderojmë se mbetet edhe dështimi i RTK-së si një institucion publik medial për të përmbushur misionin e tij themelor për informim të drejtë e të paanshëm të opinionit publik.

Ky raport është i mbushur me fraza demagogjike të një vetëvlerësimi të paparë mbi punën profesionale të stafit të këtij institucioni, por ndërkohë që praktika editoriale ka qenë krejt tjetër.

Dhe po të lexohet me vëmendje dhe të analizohen detajet, shihen qartë tendencat politike të këtij institucioni dhe trajtimi jo i drejtë që ky institucion u ka bërë në përgjithësi të gjitha formacioneve politike që sot operojnë e veprojnë në skenën politike të Kosovës. Në këtë mënyrë paraqitje të drejtpërdrejtë në televizion për aktivitetet e tyre shihet qartë se kanë pasur vetëm disa formacione politike që veprojnë në Kosovë e jo të gjitha siç e ka edhe obligim ky institucion ta bëjë.

Po ashtu raporti nuk adreson edhe njërën nga çështjet më të ndjeshme që kanë ndodhur vitin e kaluar në këtë shtëpi mediale sikurse ka qenë kaplimi i një pjese të ndërtesës së RTK-së nga zjarri. Raporti në fakt e potencon këtë dukuri vetëm në mënyrë kështu të përciptë, por nuk ofron informata të duhura mbi shkaqet e zjarrit si dhe a janë bërë përllogaritjet e sakta mbi dëmet materiale e financiare që i ka pësuar RTK-ja e deri për të ofruar ndonjë analizë apo hulumtim se çfarë është bërë në zbardhjen e këtij fenomeni?

Dhe shqetësimet tjera që lidhen me këtë institucion mbeten edhe disbalancat financiare dhe borxhet e thella që ka ky institucion publik. Madje edhe arsyetimet banale të drejtorit të ri se ka arritur ta ulë këtë borxh nga 4 milionë euro në 1,5 milion, janë absurde, sepse në këtë mënyrë tentohet të mbulohet fakti se pikërisht strukturat aktuale menaxhuese të këtij institucioni nuk janë struktura plotësisht të reja, por ato janë katapulturë në njëfarë mënyre, në një mënyrë më mirë të themi janë kontrabanduar gjatë këtij procesi të katapultimit. Prandaj kjo logjikë e “gjuajtjes së shtrigave” është e papranueshme, aq më tepër kur një pjesë dhe konkretisht drejtori në fjalë ka qenë edhe kryesues i blerjes së shërbimeve audio-vizuale, që tregon se ai është përgjegjës drejtpërdrejt në këtë borxh dhe në këto disbalanca financiare që ekzistojnë në këtë institucion publik.

Përpos këtij degradimi tjetër financiar, RTK-ja kohët e fundit po përballlet edhe me një degradim të egër profesional, duke shkelur çdo rregullore dhe procedurë. Menaxhmenti i RTK-së brenda natës po bën largimin e të punësuarve më të dëshmuar për profesionalizëm brenda RTK-së, ashtu edhe jashtë saj, si dhe duke instaluar një sistem klientelist, të lidhur me strukturat menaxhuese dhe ato të pushtetit.

Rast tjetër skandaloz është edhe konkursi që ishte shpallur për shitjen komplet të hapësirës reklamuese të RTK-së. Kështu 10% e programit të RTK-së thuaja se do të privatizohet, që do të thotë se brenda një mediumi publik do të kemi edhe aksionarë jo publikë, pra privat. Kjo do ta dëmtonte misionin e transmetuesit publik për të qenë në shërbim të të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Prandaj është detyrë imediate e këtij Kuvendi që si themelues i RTK-së sa më shpejt të intervenojë në mënyrë që të hetohet gjendja reale e këtij institucioni.

Duke marrë parasysh të gjitha këto deficite të cilat i sipër cekta Lëvizja “Vetëvendosje” nuk do ta miratojë raportin vjetor të Radio-televizionit të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Aleancës, fjalën e ka deputetja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Edhe ne si Grup Parlamentar e kemi shqyrtuar raportin në fjalë dhe për vetë faktin se ky raport pra është shtyrë deri në këtë kohë, pra deri në muajin nëntor 2013, tregon se jo gjithçka ka qenë në rregull, ashtu sikur që u cek nga parafolësja këtu në Kuvend.

Me qëllim që RTK-ja të përmbushë misionin e vet që ka ndaj qytetarëve të Republikës së Kosovës, ne si Aleancë jemi të shqetësuar dhe shqetësimet tona do t'i përmendim tani.

Ne jemi të shqetësuar se sot e kësaj dite RTK-ja nuk ka mbulueshmëri në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Janë shumë emisione të cilat nuk do të duhej të ishin ose nuk do të duhej të kishin hapësirë konform shumë emisioneve tjera që janë me interes për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Mungesa e emisioneve për rini, që për të mos thënë janë shumë pak, apo në esencë nuk ka kurrëgjë për rininë e Kosovës, është një shqetësim shumë i madh për ne si Aleancë.

Njëkohësisht shqetësim tjetër neve kemi edhe hapësirën shumë të vogël, ose mos hapësira e komunave të Kosovës për të pasur pra në këtë medium shtetëror për të treguar se edhe komunat e Kosovës, edhe qytetarët nga të gjitha komunat e Kosovës janë parapagues dhe ky buxhet që e merr RTK-ja është edhe buxhet i taksapaguesve të komunave tjera të Kosovës.

Njëkohësisht janë çështjet të cilat u adresuan edhe më parë nga parafolësit dhe nga komisionet tjera, ne nuk do të duhej të ndalemi, janë shqetësime dhe për ne. Shqetësim për ne është edhe moszgjidhja sot e kësaj dite ashtu siç është e paraparë me ligj, një zgjidhje e qëndrueshme dhe financiare e rregulluar, pra për RTK-në, ku RTK-ja do të duhej të ishte një RTK jo pra pro Qeverisë në këtë rast, unë them që paragjykime mund të jenë, nesër mund të jetë cilado qeveri, por sot e kësaj dite askush nuk mund të thotë që nuk është pro për derisa paguhet nga buxheti i Republikës së Kosovës.

Pra, është nevojë urgjente që të bëhet zgjidhje e përshpejtuar, unë konsideroj se ne kemi hapësirë, kemi mundësi për ta tejkaluar më shpejt këtë çështje pra të financimit të RTK-së, mirëpo unë them që nuk po ekziston disponimi.

Prandaj me shumë pak fjalë do të thotë po e përmbyll, ne nuk do të votojmë për, në mënyrë që RTK-ja pra të ketë edhe një transparencë më të madhe dhe një përkushtim më të madh në emisionet që ne i kërkuam, pra edhe në emisionin edhe në kulturë, edhe në arsim që janë shumë me rëndësi për qytetarët e Republikës së Kosovës. Ka edhe shumëçka tjetër, prandaj vota jonë do të shkojë kundër.

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, e ka fjalën deputeti Jeton Svirca.

JETON SVIRCA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Kolegë deputetë,

Vetë fakti që po e shqyrtojmë raportin e RTK-së për vitin 2012 në fund të vitit 2013, flet për shumë parregullsi. RTK-ja duhet të jetë në shërbim të qytetarëve, sepse pagesa bëhet nga taksat e qytetarëve.

Koalicioni për Kosovë të Re ka informatë të cilën ndoshta e kanë edhe deputetët tjerë këtu në Kuvend, se ky raport nuk është miratuar në Bordin e RTK-së dhe si i tillë pra nuk merr as përkrahjen e Koalicionit për Kosovë të Re.

Në përgjithësi ne jemi të pakënaqur me punën e RTK-së dhe për të qenë më konkret jemi të pakënaqur me emisionet edukative të cilat i servon ky televizion publik, në mungesën e emisioneve fetare, shkencore, emisioneve për rini. Pra, një vërejtje tjetër të cilën do ta japim është hapësira e madhe e muzikës degjeneruese. Ky pra është televizion publik e jo privat, që për qëllim ta ketë vetëm fitimin, për shkak për këtë opinion të cilin e ceka tani kam vërejtje edhe nga shumë qytetarë të cilët kanë kontakt me mua ose unë kam kontakt me ta.

Gjithashtu është përmendur edhe këtu, por RTK u jep hapësirë shumë të vogël politikanëve të rinj në moshë, hapësirë shumë e vogël pra edhe prononcimeve të grupeve parlamentare ku në rast se RTK-ja transmeton një kronikë nga Kuvendi i Kosovës merren të gjitha prononcimet e grupeve parlamentare, kurse kur vjen fjala te prononcimi i Koalicionit për Kosovë të Re, futet kronika.

Ne kemi vërejtje në keq menaxhimin të cilin e bën menaxhmenti i RTK-së Ne e dimë se ka punësim pa konkurse dhe në këtë rast vjen në shprehje edhe punësimi familjar, gjithashtu RTK ankohet shpesh se s'ka mjete, kurse në anën tjetër hyn në obligimet të cilat mund t'i kryejë edhe vetë kur e dimë se RTK ka një staf shumë të madh të punëtorëve, të cilët kanë mundësi t'i kryejnë edhe obligimet, të cilat duhet t'i kryejë vetë ky televizion.

Për borxhin e përmendur, duhet pasur parasysh se fajin e ka edhe menaxhmenti aktual, sepse shumica e tyre kanë qenë në pozita kyçe në RTK dhe në menaxhmetin e kaluar. Vlen të theksohet se për shembull Emisioni i mëngjesit në RTK, i cili është për teknologji dhe është një fjali aty - të dhënat e fundit nga shkenca, ne e dimë që këto emisione janë të prodhuara në vitin 2004 dhe tani jemi në 2013. Fjala e fundit të shkencës është në vitin 2013, e jo në vitin 2004.

Pra, me një fjalë nuk ka prodhime të emisioneve dhe nuk përcillet trendi shkencor dhe i zhvillimit global në këtë aspekt.

Gjithashtu ne kemi informata se Rregullorja e RTK-së nuk është e harmonizuar me Ligjin e punës, ku ka shumë vendime të cilat kundërshtohen nga sindikata për shkak se sipas tyre këto vendime janë në kundërshtim edhe me Ligjin e punës dhe në këtë drejtim mendoj se Kuvendi apo Komisioni përkatës për Media duhet të bëjë një shqyrtim.

Gjithashtu mua si deputet më ka ardhur një e-mail nga Sindikata me të cilin kërkon që Kuvendi ta themelojë një komision hetimor, i cili do ta hetojë keqmenaxhimin e financave të RTK-së si dhe djegien e arkivit për të cilën nuk ka asnjë përgjigje dhe asnjë raport.

Sipas informatave, pra edhe një herë po e përmendi se në RTK ka shumë punëtorë pa kontrata si dhe bëhen shkarkime pa paralajmërime të cilët i cekën edhe kolegët këtu.

Përfundimisht, në bazë të raportit nga Komisioni Buxhetor për obligimet e RTK-së e cila nuk ka paraqitur planin e kthimit të borxhit si dhe nga të dhënat, informatat që i morëm nga raporti i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, ne si Koalicion për Kosovë të Re jemi kundër miratimit të këtij raporti. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit “6+”, deputeti Enis Kervan e ka fjalën.

ENIS KERVAN: Faleminderit, kryetar!

Bugün Kosova Radyo Televizyonu yıllık raporunu görüşmekteyiz, bu konuda bazı beklentilerimizi paylaşmakta yarar görüyorum. Özellikle sözkonusu çocuk programları olunca Türkçe ve diğer dillerde programlarımız mevcut değildir, bu büyük bir sıkıntıdır.

Bunun dışında Türk, Boşnak ve Rom dillerinde programların izlendiği zamanlarda çoğu zaman kesintilere uğrayarak, güncel olaylara yer verilmektedir. Bu da topluluklara bir haksızlıktır.

Bu yüzden üçüncü kanalın Türkçe ve diğer dillerde yapacak üçüncü kanalın bundan böyle çalışmaların başlamasının zamanı geldiğinin bilincinde olarak, bu konuda girişimlerin başlamasını RTK Bordundan ve diğer organlardan talep ediyoruz. Böylece toplulukların hakkı çiğnenmeyecektir.

Sırp dilinde kanal olduktan sonra, çok etnikli multi etnik Kosovayı yansıtabilmemiz için üçüncü Türk dilinde ve diğer dillerde yayın yapacak olan kanalın da açılması için çalışmaların başlaması gerektiğini bir kez daha vurguluyoruz. Raporu 6+ Parlamenter gurubu olarak milletvekillerimiz kendi iradelerince değerlendirip, oylayacaklardır.

KRYETARI: Po, e kemi edhe Grupin “Zajednička Budućnost”. Milivoje Stojanović e ka fjalën.

MILIVOJE STOJANOVIĆ: Hvala gospodine predsjedniče!

Uvažene kolege poslanici,

Poslanička grupa “Zajednička Budućnost” razmatrala je i analizirala Izveštaj o radu RTK u 2012. godini.

Izveštaj koji smo dobili je veoma iscrpan i detaljan, na osnovu koga možemo ustvorati realnu sliku o javnom meniteru.

Tokom 2012. godine usvojen je novi zakon o RTK. Ovim zakonom, nažalost nisu rešena dva veoma bitna problema. Imovina RTK i konkretni mehanizmi za finansiranje javnog emitera van budžeta.

Tokom 2012. godine otežavajuća situacija za rad RTK bila je i nedostatak kvoruma borda što je uticalo da neke strateške odluke nisu mogle biti donete, odnosno RTK nije uspela da napravi jasnu strategiju i plan kako da se oslobodi duga od 3 miliona evra koje nastajao 2011. godine.

Veliki problem u RTK jeste da nije završena sistematizacija radnih mesta, tako da javni emiter ima prevelik broj radnika na čijoj se plate troše više od pola predviđenog budžeta.

Neophodno je da se odradi valjana sistematizacija radnih mesta kako bi se došlo do bolje raspodele ljudskih resursa što će za rezultat biti profesionalizacija ljudskih kapaciteta u službi povećanja kvaliteta programa.

Od prethodnih govornika čuli smo da se RTK susreće sa izazovima nedostatka prostora, loše tehnološke opreme ali i sa lošim menadžiranjem budžeta kao i sa deficitom budžeta za 2012. godinu.

Rad Televizije bio je uspešan i unapređen u oblasti informativnog programa gde su uvedene nove emisije. Sportski program je bio aktuelan i raznovrstan jer su direktno prenošeni mnogobrojni sportski događaji iz celog sveta.

Međutim, kulturno-edukativni program i obrazovni program nije na zavidnom nivou jer emisije koje se emituju u ovim oblastima nisu proizvedene u RTK. Mali broj emisija proizvedenih u RTK proizvod je nedovoljnog unutrašnjeg stvaralačkog kadra, ali i nedostatka osnovnih sredstava za rad.

Program na srpskom jeziku u ukupnom programu RTK-a bio je zastupljen samo sa dnevnim vestima u trajanju od 10 minuta i nedeljnom kolažnom emisijom što je nedovoljno za srpsku zajednicu a ista je situacija i sa drugim zajednicama.

Bilo je velikog broja direktnih prenosa sportskih, kulturnih i verskih događaja svi zajednica. Ali tokom 2012. godine nije prenošena nijedna manifestacija koja je važna za srpsku zajednicu što je zabrinjavajuće.

Za poslaničku grupu “Zajednička Budućnost” zabrinjavajuće je i način informisanja oko događaja koji su se desili na početku kalendarske 2013. godine naći informisanje oko rušenja spomenika na srpskim grobljima.

U proteklom periodu nametnula se u javnosti oko rada RTK-a 2, pojavljivale su optužbe o ne transparentnom radu korupciji i ne profesionalizmu .

Pozitivno je na kraju da istakanom da je pokrenut RTK-a 2 na srpskom jeziku koje sa imitovanjem programa počela polovinom 2013. godine.

Međutim, on za sada još uvek nije vidljiv za sve građane srpske zajednice.

Poslanička grupa “Zajednička Budućnost” glasa će za ovaj izveštaj u nadi da će rad RTK-a tokom 2013.godine i u narednom periodu biti efikasniji i transparentni. Zahvaljujem!

KRYETARI: Tani është radha e deputetëve. Fjalën e ka deputetja Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Do të flas për raportin e punës për shkak se u fol shumë për raportin financiar të Televizionit të Kosovës dhe unë do të ndalem veçanërisht tek raporti i punës së RTK-së për vitin 2012. Do të thotë është përafërsisht raport i punës që vë në pah problemet e njëjta me të cilat po vazhdon të përballet mediumi publik, do të thotë mbetet ende e pazgjidhur çështja e pronës si dhe financimi i transmetuesit publik në këtë rast jashtë buxhetit të shtetit, sepse janë dhënë versione të ndryshme.

Pastaj vazhdon të mbetet problem edhe borxhi që ky institucion do të thotë e ka që një farë forme po e bën të pamundur risistematizimin e vendeve të punës brenda RTK-së e që

do të kishte ndikim të drejtpërdrejtë në rritje të cilësisë dhe të performansës së vet të mediumit publik.

Problematikë tjetër me të cilën është përballur RTK-ja është edhe kompletimi i bordit të Televizionit të Kosovës. Ne si Parlament sot pikën e fundit të rendit të ditës kemi edhe përzgjedhjen e dy anëtarëve të Bordit të RTK-së. Unë mbes me shpresë që ne si deputetë do të japim kontributin tonë dhe do të arrijmë që ky bord të jetë funksional, sepse në këtë rast ka pasur disa herë tentativa që të përzgjidhen anëtarët e Bordit të RTK-së, por pa sukses.

Do të ndalem edhe tek teknologjia që u përmend këtu, do të thotë mediumi publik është ndër mediumet e pakta që po përballlet me një teknologji analoge, sepse shumica e mediumeve tashmë kanë kaluar në teknologjinë digjitale.

Dhe, krejt në fund e di se pat shumë kritika për shkak se RTK vazhdon të mbetet televizion i pushtetit, vazhdimisht dhe e mbaj fare mend, e mbajnë mend mirë se edhe gjatë kohës që kam qenë gazetarë, vazhdimisht opozita e ka kritikuar mediumin publik si medium të pushtetit dhe kjo nuk është asgjë e re.

Krejt në fund mendoj se ka pasur tentime të ruajtjes së parimit të neutralitetit dhe të paanësisë, kjo është vënë re edhe gjatë zgjedhjeve të fundit ku do të thotë të dhënat tabelare kanë bërë të ditur se subjektet politike kanë pasur hapësirën e vet të nevojshme dhe brenda mediumit publik, ka pasur edhe raporte vendore. Unë e di që opozita i merr ato raporte që asaj i pëlqejnë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Kolegë të nderuar deputetë,

Sigurisht që kjo temë më shumë është edhe në aspektin profesional edhe atyre që u takon dhe që e thanë fjalën e vet, anëtarëve të Komisionit, të cilët edhe e përcjellin punën e këtij mediumi publik si medium i cili është i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, por unë edhe kohë më parë kam ngritur disa çështje të cilat përkojnë tash edhe me raportin e punës sidomos për vitet paraprake, por edhe në këtë rreth përmbushjes së një misioni të Radiotelevizionit të Kosovës, i cili është i obliguar që t'i ofrojë Auditorit informim objektiv, të balancuar edhe program cilësor.

Ne dëgjuam edhe kolegë deputetë, i dëgjuam edhe çështjet të cilat mund të kenë defekte në arritjen e kësaj, por unë mendoj se këto probleme nuk e pengojnë Radiotelevizionin e Kosovës në përmbushjen e misionit të vet.

Tash, pse po e them këtë, sepse çështja e teknologjisë, çështja e borxheve, mendoj që nuk e ndalojnë informimin objektiv. Nuk e ndalojnë ose nuk do të ishin pengesë për punësime familjare, nuk do të duhej të ishin pengesë për keqpërdorim të pronës, dëmtimit të arkivave, por edhe deri te ajo keq menaxhim i buxhetit dhe te pjesa e prokurimit që edhe Auditori vetë e ka dhënë por edhe në pjesën që lidhet me financat publike.

Qëllimi i misionit të këtij mediumi publik është shmangja e propagandimit të çfarëdo lloji dhune, urrejtje edhe shkeljeve të normave tjera që përbëjnë edhe me etikën edhe me transparencën.

Andaj, unë këtu e them edhe një herë publikisht, sepse në Radiotelevizionin e Kosovës, fatkeqësisht emitohen emisione të porositura me tendencë negative dhe me qasje që unë këtu e kam quajtur edhe që përkojnë me ideologjinë staliniste dhe atë bolshevike. Dhe, tash kjo a është ajo që taksapaguesit kosovarë e meritojnë edhe ne si qytetarë të Kosovës e meritojmë se aty tentohet apo insistohet të instalohet një rrymë politike e caktuar e cila shfaq urrejtje edhe politike edhe të ideologjisë ndaj personave të caktuar, por edhe një pjese të aktivitetit të njerëzve në përgjithësi edhe të kaluarën edhe të tashmen?

Andaj kjo duhet të theksohet këtu në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe nuk duhet të fshihet për çfarëdo arsye edhe qofshin ne që jemi politikanë dhe i nënshtrohemi mediumit edhe publik edhe medimeve tjera.

Tash te pavarësia editoriale. E thanë edhe kolegët nga pozita, sepse opozita po thotë ankohet në pavarësinë e Radiotelevizionit të Kosovës.

Unë tash po e them kështu për ta faktuar edhe këtë që e thashë paraprakisht. Mund ta shikoni në pjesën e raportit preliminar të vëzhguesve të Bashkimit Evropian e cila thotë për mbulimin e fushatës nga mediat po citoj decidivisht: “në emisionet e veta të lajmeve, Televizioni Publik, RTK 1 demonstroi një preferencë të dukshme në paraqitjen e PDK-së, posaçërisht udhëheqësit të saj, kryeministrit Hashim Thaçi” Pra, kjo tregon se RTK ka favorizuar PDK-në duke i dhënë hapësirë më të madhe se sa subjekteve tjera politike, por edhe duke favorizuar në situata të caktuara në lansimin e lajmeve pozitive për Qeverinë dhe mënjanimin e lajmeve negative për PDK-në dhe për Qeverinë.

Kjo është hera e parë kolegë deputetë, këtë po e them publikisht që Radiotelevizioni i Kosovës përfshihet në raport monitorues ndërkombëtar për njëanshmëri dhe kjo krijon imazh të keq jo vetëm për RTK-në, por edhe për shtetin e Kosovës që transmetuesi publik i një vendi demokratik po shfaq prirje të dukshme për anime politike dhe kjo nuk është dëshirë e opozitës dhe nuk është raport i monitoruesve vendorë.

Prandaj si Kuvend duhet të kërkojmë që Komisioni Parlamentar nëpërmjet Bordit të RTK-së të ndërmarrë veprime për ta ruajtur pavarësinë editoriale të RTK-së. Ky është obligim i Kuvendit që si themelues të garantojë funksionimin normal, si dhe të përmbushë atë që quhet mision që ka për të qenë i pavarur profesionalisht dhe i paanshëm. Faleminderit!

KRYETARI: E ka fjalën Ramiz Lladrovci.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Shqetësimet e ngritura nga Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me Raportin e auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Radiotelevizionit të Kosovës janë domethënëse.

Për të mos i përsëritur ato që i thanë parafolësit, unë dua të përgëzoj menaxhmentin e ri të Radiotelevizionit të Kosovës i cili ka bërë një progres, sidomos në fushën e planifikimit si dhe shlyerjes së borxheve që RTK kishte krijuar gjatë vitit 2011 si rezultat i një planifikimi jo të mirë nga ish- menaxhmenti i saj.

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike ka rekomanduar Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm të bëjë një auditim të performansës për disa organizata buxhetore si dhe për Radiotelevizionin e Kosovës. Besoj që Zyra e Auditorit do ta ketë parasysh këtë kërkesë të Komisionit. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Emilija Rexhepi e ka fjalën.

EMILIJA REDŽEPI: Hvala predsedniče!

Osим što imam veliki primedbi na jako teške uslove ratnika RTK-a 1, odnosno uredničke kuće na bosanskom jeziku gde će 14. godina posle rata se faktički niko nije zaposlio od Bošnjaka, a da ne govorim o politizaciji programa, Jako ... i tehničari sa kojim rade na terenu.

Ono što želim je da za ovom govornicom skrenem pažnju nacionalnoj Televiziji RTK-a 2, o poštovanju zastupljenosti programa ostalih zajednica od 15%, gde smo sa direktorom obavljene neke početne pozitivne korake otvaranju redakcije na bosanskom jeziku.

Te koristim priliku da pozovem sve nadležne organe Vladine institucija pre svega OSCE-ja ali drugih međunarodnih organizacija da nam izađu u susret i pomognu u ovom procesu koji je od prioritetne važnosti za bošnjačku zajednicu na Kosovu. Zahvaljujem se predsedniče!

KRYETARI: Nuk ka të lajmëruar për debat. Unë dua t'ju përkujtoj të nderuar deputetë se Kuvendi i Republikës së Kosovës është themeluar i Radiotelevizionit të Kosovës si televizion publik dhe përgjegjësinë për një kontroll të shtuar të këtyre institucioneve, qoftë publike, qoftë të tjera që i përgjigjen Kuvendit e kanë komisionet parlamentare. Një çështje tjetër që dua ta cek krejt telegrafisht është Bordi i Radiotelevizionit të Kosovës.

Bordet e Radiotelevizionit të Kosovës janë votuar në këtë Kuvend dhe mund të them që gjithë kuadrat që kanë qenë të përgatitur për ta kryer detyrën si duhet janë eliminuar me votat tona, prandaj, nuk duhet fortë të qahemi pastaj në mekanizma tjerë.

Përzgjedhja e kuadrove profesional realisht nuk bëhen mbi bazën e profesionit dhe ngritjes profesionale dhe intelektuale, por mbi preferenca të tjera, nepotizmi është një çështje që duket nga po them figurativisht nga aeroplani.

Mungesa e kulturës tradicionale shqiptare në Radiotelevizionin e Kosovës është e dukshme, siç është e dukshme dhe mungesa emisioneve edukativo- arsimore, them kombëtare- shqiptare të mos them në një drejtim tjetër. Mendoj që edhe këtu janë të dukshme të vërejtur për shkak se kuadrat janë të papërgatitur për t'i kryer detyrat dhe përgjegjësitë mbi bazën e ligjit dhe të interesit të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Edhe një çështje që dua ta them shumë telegrafisht, në pesë vizitat e fundit që i ka bërë kryetari i Kuvendit të Kosovës, në asnjë nuk ka pasur gazetarë të Radiotelevizionit të Kosovës dhe mund të them që Radiotelevizioni i Kosovës e ka diskriminuar organin që është themelues i Radiotelevizionit të Kosovës. Këto janë fakte që unë i thashë krejt telegrafisht.

Të pranishëm janë 66 deputetë.

Dhe, tani e votojmë raportin e Radiotelevizionit të Kosovës.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 27 vota për, 34 kundër dhe 6 abstenime, nuk miratohet raporti i Radiotelevizionit të Kosovës.

10. Shqyrtimi i raportit vjetor të Auditimit për vitin 2012

Raportin vjetor të Auditimit për vitin 2012 e ka shqyrtuar Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Ftoj Auditorin e përgjithshëm, zotin Lage Olofsson, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin.

LAGE OLOFSSON: Honourable chairman,
Members of the Assembly,
Dear Ministers,

I am going to present this, the Annual Audit Report covering the Government's implementation of the 2012 budget and the Annual Financial Statement for the same period.

Our Annual Audit Report is based upon around ninety (90) statutory audits and around twenty five (25) non-statutory audits, performance and management audits, and analysis that we have carried out at the aggregated level.

In general the quality of the information in the Kosovo Budget as well as in the underlying Annual Financial Statements has improved over the years in my view. But at the same time we are facing higher expectations and requirements on the accuracy and validity of information and statistics; and these are related to Kosovo's Euro Atlantic ambitions. I think we can be proud what Kosovo has achieved so far, but we have new challenges ahead of us.

Already today there is a need for a better focus on output and results; and it is a need of financial management and control that is developed. The financial management approaches are new, the legal framework is increasingly more consistent, and the Assembly's oversight is gradually strengthening. But to roll out this over the entire public sector is a thing that will take time; but that is important much more can be done already now if we have a more focused approach.

The implementation of necessary financial management system and mechanism requires commitment and support from the highest levels. New approaches, methods and good examples on "how to do things" are needed and should be applied and firm actions has to be taken in cases of the identified misuse and mismanagement of public funds.

When it comes to our opinion that we have given on the KB/AFS , my conclusion is that this financial statement in all material aspect presents a true a fair view of finances and financial situation for the fiscal year 2012. This is very good for Kosova; it is very good for our friends and partners. But, I am saying that at the same time I will try to warn the reader a little bit about a specific thing in this Annual Financial Statement. That is in fact that we have a very very big mismatch of what we are owning in form of assets. When we go through the individual budget organizations assets we can see that there is a difference of almost 3 billion euro compared to KB/AFS, at the same time as we have given emphasis on Matters for almost half of all the budget organization related to that they have underestimated their assets. So, in fact we have richer than we believe when we read this, when it comes to what we have in form of assets.

Nothing that everyone that read this should be very aware of that, because what we have shall all to be used in a good way.

We have also four other minor issues that has to do with the information quality in the AFS, minor in the form that they are material for the totality. That is that the Government or the Ministry of Finance does not do any consolidation of the businesses between the budget organizations. So what is happening is ...in both sides inside the state or in the public sector. It means that we are blowing up the financial statements, that we overestimated it. We also receive as a second point funds from donations, third parties; and these are not integrated as they should in many cases, so we here underestimate the business of Kosova.

At the same time we are presenting in this Annual Financial Statement KEK's debt that in fact if we look at it are over estimated. And we as the fourth point we are presenting that the KEK's debt to the state as something that we in fact should be able to get in as a totality and this must be questioned. I think it is ... and I have recommended the Government in this Report that they should ensure till the next AFS that these issues are addressed and I have the view that the Assembly should consider to follow this up how the Government is working with these issues striving for getting better information quality in the AFS for 2013.

This is about the information quality. Much of this report is drawn about how we are managing our finances, and we have looked into that as well and we can see when we

have drawn that the public financial management also to certain degrees is organized in the legal and institutional framework around it, but when it comes to implementing it, it is very very many challenges we have; our report are full of it and here they are generalized more.

We have problems when it comes to management control, we have problems when it comes to procurement, we have problems when it comes to responsibilities, guidelines and reporting to management, etc., numerous of them. And this goes on in central authorities, in independent institutions, in municipalities and in publicly and socially owned enterprises. Where the two latter have the biggest problem, the development when it comes to financial management in municipalities and in publicly owned enterprises of behind the first categories of organizations. As I said we have given numerous recommendations on this, I shall not go through them all here; but all the recommendations that we are given here to the Government, the considerations we are given for the Parliament, they are linked to values and approaches of Kosovo's EU integration strategy, which I think is important. It is about to clarify the clear borderlines between the political and administrative levels; it is about transparency, it is about better financial information and statistics; it is about the result reporting and cost indicators as a mean for parliamentarians, managers, interested persons to focus on what we in fact get for taxpayers money; it is about better follow up and oversight and it is about hold to account.

I suppose I take it for granted that the members of ... will reflect more on the individual recommendation later on.

We have, I think, everyone in the public administration in Kosovo, especially a specific line of responsibility to a responsive and in a result oriented manner assist, where they are to put forward improvements in the public sector.

Where we as the Office of Auditor General have found weaknesses we have tried to give constructive recommendation for change; and I think we had some good results there. And we also closely follow how our recommendations are addressed and continue to work in close partnership with management to promote improvements. We as an Office act as an independent key driver for change in Public Financial Management.

It is my hope that you will find the report useful in identifying areas where we can work together for a better service to the citizens of Kosova.

Thank you very much.

KRYESUESI: Radha është e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike. E ka fjalën zoti Ali Sadriu.

ALI SADRIU: I nderuar zoti kryesues!
I nderuar ministër,
Të nderuar kolegë.

Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike në dy mbledhjet e radhës e ka shqyrtuar këtë raport. Po ashtu ne kemi njoftuar kryesinë e Kuvendit, se në bazë të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësisë, Kuvendi shqyrton raportin vjetor të Auditorit deri më 31 tetor, në të kundërtën, raporti dhe deklarata financiare të Qeverisë konsiderohen të pranuar në formë të dorëzimit nga autoriteti i Auditorit.

Meqë afati ka kaluar, për shkak se siç e dimë, Kuvendi nuk ka punuar një kohë për shkak të zgjedhjeve, unë do të vazhdoj disa nga vërejtjet, gjegjësisht rekomandimet, me qëllim që ky raport të jetë më i plotësuar, aty ku e la drejtori i Zyrës së Auditorit Gjeneral.

Pos tjerash, ne gjatë shqyrtimit të raporteve, problemet të cilat kemi hasur dhe brengat që i ka Komisioni janë, bazohen kryesisht në mos adresimin e rekomandimeve të konstatuara apo numrin e vogël të rekomandimeve. Gati në të gjitha raportet nuk ndodh që të adresohen tërë rekomandimet e viti paraprak, çka i pamundëson organizatës për të parë gjendjen dhe sfidat e problemet që në tejkalimin e tyre është garanci për mospërsëritjen.

Problem më vete, them nga përvoja e Komisionit, është trajtimi i pasurisë, është një brengë sepse udhëhiqen dy sisteme. E-sistemi dhe sistemi 'sim fakes', që të këto dy sisteme për të njëjtën çështje na japin rezultate të ndryshme.

Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike ka pasur disa takime me Ministrinë e Financave, me Ministrinë e Thesarit, kemi pasur dhe institucione të tjera të cilat janë përgjegjëse që këto çështje të tejkalohen. Bashkërisht kemi formuar një komision i cili do të duhet të gjejë një zgjidhje që të ketë një sistem të evidentimit të pasurisë, në mënyrë që të kemi një saktësi të gjendjes, ashtu siç e tha edhe zoti Lage, sepse shumë herë për pasurinë ne nuk kemi tabela të qarta.

Komisioni i formuar ka punuar për tejkalimin e këtyre sfidave, por ende nuk e kemi rezultatin konkret, sepse ka ngelur që të ketë një udhëzim administrativ, sepse kërkesë e Komisionit ka qenë të jetë vetëm një, këta në shqyrtimin e fundit e kanë dhënë një propozim, se mund të jenë dy, por duhet të jetë një udhëzim administrativ i cili do të sinkronizojë formën dhe mënyrën e punës, në mënyrë që të kemi rezultate të njëjta dhe jo të ndryshme. Jemi në pritje, kjo ende nuk ka ndodhur.

Probleme të tjera, pos pasurisë, Komisioni dhe brengë e vëren, e ka cekur edhe në raport Auditori, janë borxhet e bartura nga viti në vit. Qeveria duhet të ketë një qasje dhe një brengë në këtë drejtim, sepse mund të vijë në një situatë, që mandej sfidohet edhe më rëndë e mos të them, që vjen deri para një situatë të pa tejkaluar.

Probleme të tjera, që ne kemi vërejtur dhe që mendojmë se do të duhet të gjejmë zgjidhje në të ardhmen, është sfera e prokurimit. Aty janë dy rekomandime që të ketë një prokurim të centralizuar, i cili ka një marrëveshje të një prokurimi të centralizuar, por në shqyrtimet individuale ne kemi konstatuar se lë shumëçka për të dëshiruar, sepse nuk po e zbatojnë.

Dhe, çështja tjetër dhe është njëherësh edhe kërkesë, që prokurimi do të duhet të kalojë në sistemin elektronik, në mënyrë të unifikuar dhe t'i vejë operatorët në pozita të barabarta.

Nga shqyrtimet që kemi vërejtur ka shumë lëshime, sepse ka kurdisje të kriterëve të tenderit, ka mosrespektim të standardeve të precizuara nga vetë autoriteti kontraktues dhe ka edhe shumëçka, shmangie e të mos them se ka edhe dyshime të bazuara, që ka nevojë për një trajtim, për një ndjekje të mëtutjeshme. Ka në plot raste dhe unë mund të ju ofroj po deshët shumë shembuj të tillë.

Çështje tjetër që ne kemi vërejtur dhe kërkojmë që Qeveria do të duhet ta ketë një trajtim rreth kërkesave për borxhet e veta. Ka shumë borxhe që janë para parashkrimit. Dhe ne si Komision kemi pas kërkuar që të jetë një rekomandim, ku Qeveria do të duhet të dalë para Kuvendit me një pasqyrë të borxheve, të pasqyrave që kanë të bëjnë me borxhet. Dhe, në veçanti ta kemi edhe një pasqyrë tjetër me pasqyrat e borxheve të parashkruara, sepse informacionet që na ofrohen del se është një sasi e konsiderueshme që veç është parashkruar, ose është në periudhën e parashkrimit final, sepse dihet pas një kohe, nuk e di pas pesë vjet më duket është, ato borxhe në mënyrë automatike shlyhen.

Një çështje tjetër, po ashtu që e kemi vërejtur gjatë shqyrtimit të raporteve ka qenë mosfunksionimi i zyrave të Auditorit të Brendshëm. Aty ku funksionon njësia është e konstituuar dhe funksionon Njësia e Auditorit të Brendshëm dhe në veçanti Komiteti i Auditimit, problemet i gjejmë shumë më të vogla.

Kam kënaqësinë që ne në takim me ministrin e Financave kemi marrë premtimin edhe nga ministri i ri, pra që kërkesat e organizatave buxhetore që kanë të bëjnë për plotësimin e vendeve të punës, që kanë të bëjnë me postin e auditorit, do të gjejnë kushte dhe mënyra që të njëjtat të reflektojnë në buxhet dhe ata të mund ta rrisin numrin e tyre.

Problem në vete është edhe çështja e personelit, mënyra e rekrutimit, mënyra e mbajtjes së evidencës, dosjeve të personelit dhe mosrespektimi i kriterëve të kualifikimit. Pra, ka shumë shkelje në këtë drejtim dhe ne kemi kërkuar që në të gjitha rastet individuale t'i bëjmë rekomandimet e caktuara që të njëjtat të korrigjohen nëpërmjet adresimit, gjegjësisht planit veprues që organizatat të marrin nga Komisioni.

Te tenderët e kemi edhe një brengë, sepse nuk bëhet ruajtja e dokumentacionit, dosjes së tenderit. Në shumë organizata nuk kemi planifikim në kohë të tenderit. Kemi shumë organizata që hyjnë në obligime kontraktuese pa sigurim mjetesh, por kemi edhe organizata të cilat kontraktojnë pra, në shuma shumë të mëdha, mund të përmendim emra, dhe ato janë të shumta. Është për t'u brengosur, për shembull, Ministria e Arsimit, në disa vjet ka 500 mijë deri në 1 milion euro mjete të buxhetuara, gjegjësisht mjetet dhe sigurimin e mjeteve, ndërsa ka hyrë në obligime me vite me radhë, 12, 13, 14 milionë. Shtrohet pyetja - nga? Dhe kur të vijë periudha e draft-buxhetit që do ta kemi, ne do të kërkojmë kategorikisht që një gjë e tillë të mos u ndodh.

Këtu fajësinë, pos në këtë rast Ministrisë së Arsimit, unë do të them se e ka edhe Ministria e Financave, sepse nga i mori mjetet, si iu bartën? Po përdoret ai ventili, kur shkurtohen diku tjetër dhe i hidhen një organizate tjetër. Ja, pra në çfarë situatë kemi sjellë.

Kur jemi te tekstet, mund ta them edhe këtë, ne kemi kërkuar se ku kanë shkuar ato mjete. Auditori ka bërë auditivin e 7 shkollave dhe a dini çfarë ka konstatuar se në ato shkolla kanë të gjithë nxënësit tekstet e siguruara, megjithatë kanë gjetur tepër, jo më pak se 1,2 milion euro tekste të papërdorura.

E, ju lutem, ato i janë shkurtuar dikujt, një organizate buxhetore, përkatësisht një projekti, dhe janë bartur këtu.

Nga ky kontest e lidhi edhe atë çështje dhe kemi po ashtu edhe projekte kapitale që nuk i ka pasur fare të buxhetuara, e kemi rastin në Ministrinë e Shëndetësisë, e kemi rastin te Ministria e Infrastrukturës, ndërtohet ura mbi lumin Drenicë apo ndërtohet rruga Pejë-Vitomiricë, pa projekt, pa sigurim të mjeteve, pa shumëçka. Dhe, ne nuk mund t'i themi se kjo është krejt në rregull.

Prandaj, ta përmbyll, ne kemi kënaqësinë që nëse bëjmë krahasime nga viti në vit, ka progres. Nuk mund t'i ikim asaj që nuk ka progres, por këto lëshime na venë në pozicion që ne duhet të jemi këmbëngulës dhe...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Tani është radha e përfaqësuesve të partive politike. Në emër të PDK-së, fjalën e ka zoti Lladrovci.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin vjetor të Auditimit për vitin 2012.

Fillimisht dua të përgëzoj Auditorin e Përgjithshëm për përgatitjen me kohë dhe me saktësi të raportit vjetor të auditimit për vitin 2012. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike me kujdes e ka lexuar dhe analizuar raportin vjetor të auditimit dhe mendon se raporti në mënyrë të detajuar ka nxjerr në pah të gjeturat, konkluzionet dhe rekomandimet me qëllimin më të mirë për ngritjen e cilësisë së menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Ajo që ne do të vlerësojmë shumë është se raporti, opinionin gjithëpërfshirës i auditimit nga Auditori i Përgjithshëm, si përmbledhje nxjerr si përfundim, se pasqyrat vjetore financiare të Buxhetit të Republikës së Kosovës, në të gjitha aspektet materiale paraqesin një prezantim të vërtetë dhe të drejtë të financave dhe gjendjes financiare për vitin fiskal 2012.

Në këtë drejtim, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka bërë një punë të mirë duke ndihmuar etnitetet e audituara në eliminimin e shumë gabimeve në pasqyrat financiare dhe përmirësimin e cilësisë së informacionit të raportuar. Auditori i Përgjithshëm në këtë raport përfshin opinionet e dhëna të auditimit dhe mangësitë më domethënëse menaxheriale në secilin organ të audituar. Roli i Auditorit të Përgjithshëm është që të ofrojë një bazë për mbylljen e zinxhirit të llogaridhënies ndërmjet Kuvendit dhe organizatave buxhetore.

Por, raporti fokusohet edhe në disa të gjetura, mangësi të cilat nuk kanë ndonjë ndikim të madh në cilësinë e informacionit. Këto çështje ne duhet t'i trajtojmë me kujdesin më të madh për një menaxhim me të mirë të financave publike dhe kontrollit, menaxhimin e pasurisë, prokurimin publik të parasë, raporteve financiare dhe operative e profesionale dhe një shpalosje e drejtë e tyre. Ky besoj se do të jetë edhe synimi primar i Qeverisë së Kosovës.

Nga raporti vjetor i auditimit të përgjithshëm shohim se gjatë vitit 2012 janë kryer 91 auditime dhe janë dhënë opinione të ndryshme mbi pasqyrat vjetore e financiare të organizatave buxhetore. Prej tyre janë 38 me opinion të pakualifikuar, domethënë opinionin më i mirë i mundshëm; 42 me opinion të pakualifikuar, me theksim të çështjes; dy me opinion të kualifikuar; 6 me opinion të kualifikuar me theksim dhe 3 me mohim të opinionit. Është fjala për tri komunat në veri, të cilat nuk kanë pasqyra vjetore financiare.

Në raport ka edhe të gjetura shqetësuese si pasojë e menaxhimit jo të mirë, zbatimit të pamjaftueshëm të ligjeve, prokurime jo të mira, menaxhim jo i mirë i aseteve, mosimplementim të rekomandimeve e të tjera.

Grupi Parlamentar i PDK-së kërkon një angazhim shtesë të të gjithë aktorëve për sanimin e shkaqeve në vendosjen më të mirë të kontrolleve, menaxhimin më të mirë të rreziqeve që do të rezultojnë në ngritjen e efikasitetit dhe vlerës së organizatës.

Për të gjitha rekomandimet që janë dhënë nga Auditori i Përgjithshëm duhet që Qeveria të ndërmarrë masa të nevojshme për adresimin e tyre. Gjithashtu, shpresoj që Auditori i Përgjithshëm do të shfrytëzojë eksperiencën e vet dhe do të ndihmojë stafin e tij në ngritjen e performansës dhe kualitetin e raportit të auditimit.

Unë do të dëshiroja të ngre edhe dy çështje specifike, të cilat i ka ngritur edhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, pra çështjen e kthimit të pozitës së kryeshefit ekzekutiv në komuna, për ta rritur efikasitetin e punës së komunave dhe nën 2, thjeshtësimin e pasqyrave financiare të Fondit të privatizimit, se ashtu si janë është vështirë t'i kuptojnë ata së nuk janë profesionistë të fushës, duhet të thjeshtohen, që edhe deputetët të mund t'i lexojnë.

Në fund do të kërkojmë përkrahjen e të gjithë deputetëve që të diskutojnë për të gjitha çështjet që do të ndihmojnë një menaxhim më të mirë për shtyrjen përpara të implementimit të gjitha rekomandimeve, që dalin nga ky raport.

Të nderuar deputetë,

Të vetëdijshëm për rëndësinë e auditimit, komentet, sugjerimet dhe rekomandimet tuaja, do të jenë një kontribut i vlefshëm në ngritjen e performansës së auditimit në përgjithësi, sepse një auditim i mirë do të përmirësonte sistemin e kontrollit të financave publike, si rezultat i së cilës do të ishte një qeverisje më e mirë dhe transparente në shfrytëzimin e parasë publike.

Grupi Parlamentar i PDK-së rekomandon që të miratohet raporti vjetor i auditimit i prodhuar nga Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2012 dhe i fton deputetët që të votojnë raportin me rekomandime. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështet raportin e Auditorit të Përgjithshëm. Mendojmë se ai në mënyrë detaje përmban aktivitetet që ka zhvilluar Auditori dhe konstatime që janë nxjerr nga kontrolli i shfrytëzimit të pasurisë dhe parasë publike.

Ne konsiderojmë se Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka pasur një zhvillim të mirë dhe është një shembull i mirë i ndërtimit të institucioneve të pavarura që kanë një rëndësi vitale për kontrollin e shfrytëzimit të parasë publike dhe qeverisjen e mirë në Kosovë.

Në këtë drejtim ne mbështesim edhe më tutje të gjitha aktivitetet që kanë për qëllim forcimin e nivelit të profesionalizmit dhe nivelit të pavarësisë së këtij organi shumë të rëndësishëm.

Prandaj, duhet të jemi shumë syçelë që t'i evitojmë të gjitha ato tendenca që do ta rrezikonin pavarësinë ose kthimin prapa në zbatimin e pavarësisë së nivelit profesional të kësaj.

Sa u përket të gjeturave të Auditorit, ato sinjalizojnë se ende ka probleme shumë të mëdha me menaxhimin e parasë publike, përkundër faktit që janë bërë përparime në kornizën ligjore, janë bërë përparime në aftësimin e auditimit të brendshëm edhe në shumë drejtime. Mirëpo, nëse kemi probleme serioze në menaxhimin dhe kontrollin e buxhetit, kemi probleme gati në secilën ministri, në secilën komunë edhe në shumë prej organizatave të pavarura lidhur me prokurimin lidhur me regjistrimin e aseteve lidhur me raportimin, nëse kemi faktin se 40% të kontrolleve të bëra gjatë vitit të kaluar kanë gjetur probleme me theksim të çështjes. Te komunat, gjendja është shumë dramatike, rreth 80% të komunave kanë probleme serioze në menaxhimin e parasë publike.

Ne nuk kemi një pasqyrë reale ende edhe për ndërmarrjet publike. Kjo mund të shihet fare mirë nga raporti nëse shikoni vetëm pasqyrën e organizatave buxhetore të audituara prej faqeve 57 deri në 67 të këtij raporti. Për çudi, ne kemi dobësi serioze edhe në ministritë që duhet të jenë shembull për kontrollin dhe përdorimin e parasë publike, kemi probleme me pothuaj ato ministri që kanë buxhete shumë të mëdha, kemi probleme edhe

në zyrat e Kryeministrit. Pra, kemi situata që nuk do të duhej të toleroheshin në asnjë mënyrë, ato duhet të jenë shembull, se si përdoret paraja publike.

Prandaj, mendoj se ky raport, nëse lexohet në mënyrë objektive, kërkon që vërtet Kuvendi ta marrë situatën në dorë dhe të imponojë disiplinën buxhetore, të imponojë qeverisjen e mirë, kontrollin e mirë të pasurisë dhe parasë publike, vetëm kështu ne mund të arsyetojmë besimin që na kanë dhënë votuesit tanë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, fjalën e ka zoti Afrim Hoti.

AFRIM HOTI: Faleminderit, kryesues!

Raporti vjetor i auditimit të performancës buxhetore në përgjithësi ka të plotësuar kriteret formale për një raport gjithëpërfshirës që përmban elemente thelbësore të një dokumenti përshkrues.

Në faqen 16 të raportit, pikën 3.3 mbi opinionet e auditimit, pasqyrave vjetore financiare thuhet se Auditori i Përgjithshëm ka kryer auditimin e rregullsisë për gjithsej 89 organizata buxhetore dhe dy organizatave jashtë buxhetit. Me këtë rast, auditori ka bashkëlidhur një tabelë në këtë pikë të raportit, ku i ka klasifikuar llojet e opinionëve për të cilat ka dhënë shpjegim domethënës në shtojcën 1 të këtij raporti.

Një nga çështjet që janë për t’u diskutuar është që sipas të dhënave të futura në këtë tabelë përfshihet numër më i madh i opinionëve të pakualifikuara që sipas kuptimit të nocioneve të këtyre opinionëve nuk ka pasur parregullsi të theksueshme.

Ky konstatim mund të jetë paksa kontradiktor kur kihen parasysh disa konstatime që bëhen në pjesë të tjera të këtij raporti. Në pikën 3.4 mbi progresin e rekomandimeve nga viti i kaluar në lidhje me pasqyrat vjetore financiare të organizatave buxhetore theksohet se në auditimin e pasqyrave vjetore financiare për vitin 2011 janë dhënë gjithsej 11 rekomandime, prej tyre sipas raportit, 10 u janë drejtuar Qeverisë, ndërsa 1 i është drejtuar Kuvendit të Kosovës.

Sipas kësaj pjese të raportit janë 4 rekomandime nga 11 sosh, që nuk janë adresuar fare. Sipas raportit, këto rekomandime kanë të bëjnë me shlyerjen e borxheve të këqija tatimore, hartimin e dokumenteve strategjike për trajtimin e borxheve tatimore, sqarimin e borxheve të KEK-ut ndaj shtetit para fazës së privatizimit dhe konsolidimi i duhur i transaksioneve ndërqeveritare. Auditori në këtë pjesë të raportit tërheq vëmendjen se mosimplementimi i këtyre rekomandimeve potencialisht do të rezultojë në humbje financiare në raportime të pasakta.

Pra, trajtimi i borxheve publike duhet të jetë prioritar, në mënyrë që të arrihet preventiva financiare nga tentimi i buxhetit nga pasivja potenciale.

Në pikën 3.5 mbi analizën e pasqyrave vjetore financiare, organizatave buxhetore, vërehet një konstatim i Auditorit, ku theksohet se nga testimi i 97 projekteve kapitale të

aprovuara, buxheti i 12 projekteve nuk është implementuar fare. Kjo tregon më së miri se si kjo Qeveri nuk e ka aftësinë e menaxhimit financiar në destinim të drejtë të projektit buxhetor e po ashtu edhe shfrytëzimit të mjeteve financiare për projekte kapitale.

Po ashtu, raporti thekson se në projeksionet buxhetore të organizatave buxhetore shihet se të hyrat e planifikuara me buxhetin fillestar janë më të ulëta se shpenzimet e planifikuara që nënkupton se shpenzimet janë më të mëdha se sa të hyrat, gjë që nënkupton deficitin buxhetor që është duke u krijuar nga organizatat buxhetore, zaten në buxhetin e vitit 2012 është planifikuar një deficit buxhetor për hiq më pak se 3 milion e 306 mijë euro. Ndër çështjet më shqetësuese është se raporti është në pikat 3, 5, 2, 1 mbi analizën e parimeve në para të gatshme theksohet se rritja e pranimeve krahasuar me vitin 2011 është rezultati i inkasimit më të lartë të taksave, letrave me vlerë shtesë, kredive të FMN-së dhe financimit nga AKP-ja.

Ky konstatim më së miri e vërteton se kjo Qeveri shtetin e ka kthyer në drejtim të inkasuesit pasiv, i cili me politikat fiskale është duke e varfëruar çdo ditë e më shumë popullin e Kosovës dhe është larg nga çdo atribut të një shteti zhvillimor.

Pra, politikat e këtij pushteti janë shitja e pasurisë publike. Raporti në pikën 3.5, 2.2 trajton analizën e pagesave në para të gatshme ku në pjesën tabelore shihet se ndarja buxhetore për mallra dhe shërbime përbën hiq më pak se 193 161, që në krahasim me vitin paraprak kjo vijë buxhetore është ngritur për jo më pak se 8,18%.

Auditori ka theksuar se realizimi i ulët i buxhetit rrjedh si rezultat i sfidave në zbatimin e proceseve të prokurimit të dobët të projekteve. Në pikën 3.6.2 ku janë të trajtuar borxhet publike është tejet shqetësuese fakti se borxhi publik ka arritur në një shkallë mjaftë të madhe. Nga totali i buxhetit të organizatave buxhetore që përbën shumën prej 917 milionë e 392 223 euro, borxhi publik përbën një shumë prej 24 milionë e 110 529 euro apo thënë në përqindje 2,63%.

Sipas kësaj tablele nga niveli qendror organizatat kampione janë Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Infrastrukturës, ajo e Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit, ndërsa nga pushteti lokal kampione të borxheve publike janë Komuna e Gjilanit, Skenderajt, Mitrovicës dhe Shtëpcës.

Shuma e madhe e borxhit publik është edhe një nga indikatorët e mospërfilljes dhe menaxhimit të dobët financiar, si nga pushteti qendror, ashtu edhe nga pushteti lokal.

Dhe, në faqen 26 të raportit, Auditori ka dhënë një sërë rekomandimesh për Qeverinë dhe një rekomandim për Kuvendin e Kosovës. Duket se rekomandime më të rëndësishme që do të ngritin nivelin e përgjegjësisë së Qeverisë karshi zbatimit të drejtë të mjeteve buxhetore, është rekomandimi i auditorit përkitazi me themelimin e një Taks force speciale që do të duhej t'i raportonte Kuvendit në një periudhë tre mujore lidhur me regjistrimin dhe vlerësimin e pasurive të organizatave buxhetore.

Dhe, ajo çka i intereson më së shumti organit legjislativ është rekomandimi i drejtuar atij i cili pretendon në përqendrimin e Kuvendit lidhur me efektivitetin e Qeverisë në

adresimin e rekomandimeve dhe sigurimin e raporteve mbi progresin para krijimit të pasqyrave vjetore financiare për vitin 2013.

Në pikën 4.1.4 mbi prokurimin është një e dhënë mjaftë kurioze ku në raport theksohet se mbi 15% e bruto-produktit vendor apo 50% të buxhetit të Kosovës është shpenzuar në prokurime për vitin 2012, edhe pse me të vërtetë shpenzimet publike do të mund të ishin indikator i rëndësishëm në zhvillimin ekonomik, mirëpo jo në dobi të individëve.

Trendët e pasluftës më së miri e tregojnë se sa janë drejtuar shpenzimet publike në mirëqenien të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Kjo tani më së miri e shpjegon tendencën gjatë hartimit të buxhetit të Kosovës lidhur me mallra dhe shërbimet dhe destinimet e mjeteve financiare në investime kapitale.

Komisioni Parlamentar për Mbikëqyrjen e Financave Publike në mbledhjen e mbajtur më 9 dhe 22 tetor 2013, ka shqyrtuar raportin vjetor të auditimit për vitin 2012, ku është vendosur për miratimin e këtij raporti. Në këtë rekomandim janë inkorporuar dhe sugjerimet e këtij Komisioni përkitazi me çështjet konkrete që ndërlidhen me raportin e auditimit.

Po ashtu, është kërkuar nga Qeveria që e njëjta ta njoftojë Kuvendin nëpërmjet një raporti me shkrim për trajtimin e borxheve publike duke përfshirë edhe borxhet e parashikuara në suaza të këtij rekomandimi.

Është mirë që të kërkohej nga Qeveria themelimin e taks forcës që është rekomanduar nga Auditori i Përgjithshëm lidhur me themelimin e një task force speciale, e që do të duhej të raportojë pranë Kuvendit brenda një periudhe 3-mujore lidhur me regjistrimin dhe vlerësimin e pasurive të organizatave buxhetore.

Kuvendi duhet të fokusohet thellësisht në përmbushjen e rekomandimeve, sidomos që ndërlidhen me mbikëqyrjen e performansës të ndërmarrjeve publike, si dhe çështjet e ndërlidhura me AKP-në. Këtu theks do të duhet t'i jepet çështjes së ndryshimit të kornizës ligjore përkitazi me përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të AKP-së, si dhe çështjes që ndërlidhet me rregullat mbi administrimin e “Trepçës” dhe pasqyrave vjetore të unifikuara.

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” në analizë do ta përkrahë këtë raport. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës, deputeti Xhevdet Neziraj e ka fjalën.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar!

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka analizuar raportin vjetor të Auditorit dhe do ta përkrahë në tërësi këtë raport dhe rekomandimet që i ka dhënë komisioni funksional, do të thotë Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe

nëse rekomandimet do të zbatohen nga Kuvendi, nga komisionet dhe nga agjencitë buxhetore do të shohim një efikasitet më të mirë të buxhetit nga agjencitë buxhetore, të cilat marrin paratë nga Buxheti i Kosovës.

Prandaj, do të kemi një harxhim shumë më të mirë të parasë publike. Edhe për Grupin e Aleancës është shqetësuese trajtimi i pasurisë, borxhet e bartura dhe sidomos fusha e prokurimit. Grupi punues në kuadër të Komisionit të Buxhetit ka monitoruar Ligjin e prokurimit dhe mund të them lirisht se ka gjetur të meta të mëdha dhe do të kisha thënë këtu Kuvend se është shumë urgjente që të fillohet me prokurimin elektronik dhe të centralizuar me qëllim që edhe kjo fushë të mbulohet dhe të kemi një efikasitet më të mirë të buxhetit të Kosovës dhe të harxhimit të parasë publike. Faleminderit!

Prandaj, Aleanca në tërësi do t'i votojë të gjitha rekomandimet që i ka dhënë Komisioni Funkcional.

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re, fjalën e ka kryetarja e Grupit, Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Faleminderit edhe Auditorit, edhe ministrit,

Koalicioni për Kosovë të Re ka shqyrtuar raportin vjetor të Auditimit për vitin 2012 dhe nese e shohim Raportin e auditimit, atëherë duhet të nisemi nga Ligji për buxhet dhe Ligji për menaxhimin e financave publike, ku definitivisht mund të themi se si dhe kah janë shpenzuar këto të holla të buxhetit apo më mirë të themi taksat e qytetarëve të Kosovës të mbledhura në Buxhetin e Kosovës.

Siç shihet në raportin e auditimit kësaj radhe del që shpenzimi i parasë publike ka qenë në nivel më të mirë dhe shpresoj dhe besoj që raporti tjetër do të nxjerrë një raport edhe më të mirë të menaxhimit të financave publike. Janë dhënë rekomandimet edhe nga Komisioni Parlamentar për Mbikëqyrjen e Financave Publike, mirëpo edhe nga Auditori që do të thotë se këto rekomandime kanë qenë të njohura ndoshta edhe për deputetët të cilët e përcjellin çështjen e menaxhimit të financave publike ku në shumë raste etiketohen edhe linja buxhetore të ministrive, linjat buxhetore të komunave, linja buxhetore të autoriteteve të pavarura dhe linjat në të cilat besoj që edhe ministri pas këtij debati këtu do t'i marrë parasysh edhe rekomandimet që dalin po nga Komisioni Parlamentar ku thuhet se ndoshta obligohen Qeveria e Republikës së Kosovës, Kuvendi dhe institucionet që të zbatojnë në mënyrë më efektive paratë publike, për arsye se ne vetë po i japim votën miratimit të buxhetit dhe po na jemi deputetët të cilët duhet ta kontrollojmë edhe çështjen e shpenzimit të parasë publike.

Si Koalicion për Kosovë të Re u jap përkrahje rekomandimeve të komisionit, por njëkohësisht i jap përkrahje edhe raportit të Auditorit për vitin 2012 dhe shpresoj që raporti tjetër do të jetë edhe më i mirë, për arsye se edhe ministri e di edhe deputetët e dinë që paratë e buxhetit nuk janë para tona, por janë paratë e taksapaguesve të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Edhe në emër të SLS-së, deputeti Mursel Haljilji.

MURSELJ HALJILJI: Zahvaljujem g. predsedniçe Skupštine!

Uvaženi ministri,

Kolege i poslanici,

Parlamentarna grupa SLS-a je razmatrala ovaj Godišnji izveštaj o reviziji za 2012. godinu.

Koristim priliku da se zahvalim Kancelariji generalnog revizora i lično gospodinu generalnom revizoru g. Olafssonu koji je veoma stručno sa svojim timom izradio ovaj Izveštaj.

Izveštaj je vrlo precizan i daje pravu sliku trošenja javnog novca na Kosovu od strane budžetskih organizacija. Mišljenje kancelarija generalnog revizora je nekvalifikovano sa naglašavanjem pitanja što znači da finansijski pregledi predstavljaju pravu i realnu sliku finansija i finansijskog stanja za fiskalnu 2012. godinu. Naglašavanje pitanje je dato zbog toga što finansijske imovine u jednom znatnom delu budžetskih institucija nije tačna, naročita bi se osvrnuo na menadžiranje javnih finansija, problemi vezani za javnu nabavku revizije registraciju imovine kao i neisplaćene obaveze iz godine u godinu.

Ja bih se držao naročito u pogledu dugova koji premašuju šest godina nenaplativosti to će uzrokovati da ti dugovi budu otpisani i to je veoma veliki teret za budžet Kosova, prelazi veliku cifru ja mislim da se time treba pozabaviti na vreme.

Takođe poseban akcenat stavljamo na izradu strategije delovanja za rad za fond privatizacije i mislimo da tu treba posebno obratiti pažnju i takođe na jačanje institucija revizijskih što znači povećanje i kvalifikovanje određenog broja revizora. Naša parlamentarna grupa je takođe razmatrajući ovaj izveštaj došao do stanovišta da će ovaj izveštaj u načelu dakle i podržati ali ove preporuke koje dala Funkcionalna komisija, znači Komisija za nadgledanje javnih finansija. U to ime ja želim da još jednom izrazim zahvalnost kancelariji generalnog revizora koja izradila ovaj izveštaj i u to ime pozivam naše poslanike iz grupe SLS podrže ovaj Izveštaj. Hvala!

KRYETARI: Edhe e fundit për sot është lajmëruar deputetja Valbona Dibra.

VALBONA DIBRA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Paraprakisht unë kisha pasur dëshirë ta jap një sqarim, zoti kryetar, sepse raportin të cilin po e shqyrtojmë sot në bazë të Ligjit për menaxhimin e financave publike është i aprovuar më datën 31 tetor.

Ligji decidivisht e thotë neni 48 që nëse Kuvendi nuk e shqyrton raportin vjetor të Auditimit deri më datën 31 tetor, atëherë automatikisht konsiderohet i aprovuar raporti i Auditorit. Mirëpo, sqarimi është nga ana e sekretarit se nuk kemi mbajtur mbledhje për shkak fushatës, por është e mirë të bëhet e ditur për opinionin pse raporti është duke u shqyrtuar me vonesë.

Raporti vjetor i Auditimit ofron një përmbledhje të punës duke përfshirë auditimet në Autoritetin Qendror, në të gjitha komunat dhe në agjencitë e pavarura. Po ashtu, ky raport përmban edhe opinion e Auditorit, i cili është opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes që do të thotë që pasqyrat vjetore financiare të Buxhetit të Republikës së Kosovës në të gjitha aspektet materiale paraqesin një prezantim të vërtetë dhe të drejtë të financave dhe gjendjes financiare për vitin fiskal 2012, përveç prezantimit të pasurive.

Unë edhe në Komision ia kam thënë Auditorit Gjeneral se mendimi im është që opinionin e këtij raporti vjetor të auditimit nuk është konsistent me raportet individuale, sepse në Komision kemi shqyrtuar pothuajse shumicën e raporteve të Autoritetit Qendror ku përfshihen ministritë, niveli lokal komunal, agjencitë e pavarura dhe në vazhdimësi raportet e Auditorit kanë potencuar se ka përmirësim të menaxhimit të pasurisë si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal.

Dhe, në këtë kontekst, unë mendoj që nuk ka konsistencë në dhënien e opinionit, mendoj që duhet të ishte pa theksim të çështjes. Nga ky raport vërehet se ekziston një menaxhim shumë i mirë i buxhetit për vitin 2012. Këtë e vërtetoi edhe më herët prania dhe fjala e Auditorit Gjeneral të Kosovës.

Procesi i raportimit është në përmirësim të vazhdueshëm. Pjesa më e madhe e organizatave buxhetore kanë përmbushur të gjitha kriteret ligjore lidhur me raportimin e jashtëm duke përfshirë raportet tremujore, nëntëmujore dhe vjetore, raportin për obligimet e papaguara, si dhe planin për adresimin e rekomandimeve. Obligimet kanë rënë dukshëm në raport me vitin 2011 apo shprehur në përqindje 33% janë më pak. Kjo tregon forcimin e kontrollit në ekzekutimin e pagesave.

Po ashtu, edhe te rekomandimet shohim që ka përmirësime, nga vetë rekomandimet drejtuar Qeverisë tri janë adresuar plotësisht, ndërsa katër janë në proces të adresimit, ndërsa te autoritetet qendrore nga raportet individuale shohim se ekziston një gatishmëri e organizatave buxhetore për të adresuar rekomandimet e dhëna.

Nga 204 rekomandime, 160 janë adresuar apo afër 80% e rekomandimeve. Po ashtu, përmirësime vërehen edhe në fushat tjera siç është sistemi i auditimit të brendshëm. Mirëpo, përpos përmirësimeve në raport janë paraqitur edhe sfida me të cilat ballafaqohen organizatat buxhetore. Lidhur me këto sfida ZAP ka dhënë rekomandime dhe ne kërkojmë që këto rekomandime të adresohen nga menaxhmenti i organizatave buxhetore. Faleminderit!

KRYETARI: Sqarimet nuk i jep sekretari, do të thotë Administrata. Ju njoftoj se në bazë të nenit 20 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë nr. 03 / L- 48, i plotësuar me ligjin nr. 03 / L- 221, Kuvendi është dashur ta shqyrtojë raportin vjetor të Auditimit për vitin 2012 deri më 31 tetor 2013.

Nëse deri më këtë datë nuk shqyrtohet raporti me deklaratat financiare të Qeverisë, konsiderohet i pranuar në formën e dorëzuar nga Auditori i Përgjithshëm.

Andaj, raporti vjetor i Auditimit për vitin 2012 konsiderohet i miratuar, pasi që ka kaluar afati ligjor brenda të cilit është paraparë të shqyrtohet dhe miratohet nga Kuvendi. Po, ju e dini që arsyet pse nuk është miratuar ky ligj deri më 31 tetor kështu që edhe shumica e diskutimeve kishin vlerësim pozitiv për këtë raport dhe mendoj që nuk ka ndonjë pengesë pse është shtyre dhe pas 31 tetorit. Ministër e ke fjalën.

MINISTRI FADIL ISMAJLI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që edhe unë ta falënderoj Auditorin e Përgjithshëm për punën e bërë të cilën ai gjatë kësaj kohe jo vetëm që ka bërë kontrollimin dhe ka kërkuar llogari për shpenzimin e parasë publike, por edhe ka ndihmuar që ky proces të përmirësohet më tutje. Sigurisht që auditimi ka edhe natyrën e edukimit të organizatave buxhetore për shpenzim, ka edhe orientimin që të vihet në përgjegjësi për të ngritur kapacitetet, ajo çka më bën të ndihem mirë është se në krahasim me vitin e kaluar ky raport ka përmirësime të dukshme, rekomandimet të cilat janë adresuar në drejtim të Qeverisë dhe organizatave buxhetore të cilat janë të përmendura në raport, ne do të përkujdesemi që ato të trajtohen në mënyrë sa më të mirë të mundshme.

Edhe një herë faleminderit për Auditorin për punën e bërë, por edhe njëkohësisht edhe për kontributin që deputetët e kanë dhënë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! 56 deputetë janë këtu, nuk ka kuorum për të votuar. Shtyhet për nesër. Këtë votim dhe pikat tjera të rendit të ditës i lëmë për nesër, kur vazhdon seanca në orën 10:00.

* * *

E premte, më 15 nëntor 2013

Vazhdimi i seancës plenare, e filluar më 14 nëntor 2013

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Vazhdojmë me punimet e seancës, na ka mbetur votimi për raportin vjetor të Auditimit për vitin 2012.

Të pranishëm janë 64 deputetë. Vendosni kartelat tuaja se ende nuk janë të vendosura të gjitha. Faleminderit!

Tani shkojmë në procedurën e votimit. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. E votojmë raportin vjetor të Auditimit për vitin 2012.

Konstatohet se me 62 vota për, 1 kundër dhe 1 abstenim, Kuvendi e miratoi raportin vjetor të Auditimit për vitin 2012 me rekomandimet e Komisionit Funkcional.

Vazhdojmë me pikën e 11-të të rendit të ditës:

11. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 11 nëntor 2013, ka kërkuar nga grupet parlamentare të Kuvendit që deri te mbledhja plenare, më 14 nëntor 2013, t'i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media.

Komisioni përbëhet prej 9 anëtarëve. Ftoj kryetarët, përfaqësuesit e grupeve parlamentar që t'i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media.

Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës për kryetare të Komisionit e propozon Xhevahire Izmakun, ndërsa për anëtar Ramë Vatën.

KRYETARI: Lidhja Demokratike gjithashtu i ka dy anëtarë. Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Lidhja Demokratike e Kosovës e propozon zonjën Lirije Kajtazi dhe zotëri Sadri Ferati për anëtarë të Komisionit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i "Vetëvendosjes", kryetari Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Lëvizja "Vetëvendosje" për anëtar të Komisionit e propozon deputetin Afrim Kasolli.

KRYETARI: Faleminderit! Ardian Gjini, kryetar i Grupit Parlamentar të Aleancës.

ARDIAN GJINI: Faleminderit kryetar!

Grupi ynë Parlamentar e propozon deputeten Teuta Haxhiu për anëtare të Komisionit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, kryetarja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Koalicioni për Kosovë të Re e propozon deputetin Jeton Svirca.

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i SLS, një anëtar së bashku me grupin "Zajednička Budućnost", a jeni marrë vesh, Sasha?

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, predsedniče!

Dogovorili smo se da za člana ove komisije će dati ime Goran Marinković iz njihove grupe.

KRYETARI: Mirë, Goran e ke fjalën.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala, predsedniče!

Poslanička grupa “Zajednička Budućnost” predlaže poslanika Milivoje Stojanovića za člana Komisije.

KRYETARI: Faleminderit! Grupi “6+”, Enis Kervan e ka fjalën

ENIS KERVAN: Faleminderit, kryetar!

Grupi ynë e propozon deputeten Duda Balje.

KRYETARI: Faleminderit! Të gjitha grupet parlamentare i propozuan kandidatët për Komisionin ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media.

Na duhet një votim formal. Të pranishëm janë 77 deputetë. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 69 vota për, 1 kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi i emëroi anëtarët e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media.

Kërkohej nga Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media që të veprojnë në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr. 04/L-044 për Komisionin e Pavarur për Media.

Vazhdojmë me pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës:

12. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 11 nëntor 2013, ka kërkuar nga grupet parlamentare të Kuvendit që deri në mbledhjen plenare, më 14 nëntor 2013, t'i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës.

Komisioni përbëhet prej 9 anëtarëve. Partia Demokratike i paska propozuar dy anëtarët.

Fjalën e ka kryetari i Grupit parlamentar të PDK, Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike për këtë Komision e propozon si kryetar zotin Ramë Vatën, ndërsa për anëtare Xhevahire Izmakun.

KRYETARI: Faleminderit! Lidhja Demokratike, Arben!

ARBEN GASHI: Faleminderit, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike për Komisionin ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës propozon për nënkryetar Armend Zemajn, ndërsa për anëtar Haki Demollin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! “Vetëvendosja”, Visar!

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!
Lëvizja “Vetëvendosje” e propozon deputeten Albana Gashi.

KRYETARI: Faleminderit! Ardian Gjini, kryetar i Grupit Parlamentar të Aleancës.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, kryetar!
Grupi ynë Parlamentar e propozon deputeten Teuta Haxhiu. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Grupi Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, kryetarja Myzejene Selmani

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!
Koalicioni për Kosovë të Re për Komisionin ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës e delegon zonjën Suzan Novobërdaliu.

KRYETRI: Grupi Parlamentar i SLS, Sasha Milosavljeviq!

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedniče! Mi predlažemo Murselja Haljiljija za člana ove Komisije.

KRYETARI: Faleminderit! Grupi “6+”, Albert Kinolli e ka fjalën

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, kryetar!
Grupi ynë e propozon deputeten Enis Kervan.

KRYETARI: Faleminderit! Shkojmë në procedurën e votimit. Lus deputetët dhe regjinë të përgatitën për votim. Të pranishëm janë 80 deputetë. Votojmë tash!

Konstatohet se me 74 vota për, 1 kundër, Kuvendi i emëroi anëtarët e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës.

Kërkohet nga Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës që të veprojë në përputhje me nenin 6 të Ligjit nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës.

Pika e trembëdhjetë:

13. Emërimi i anëtarëve të Organit Përzgjedhës të Pavarur për zgjedhjen e kryesuesit dhe anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit

Qeveria e Republikës së Kosovës, mbështetur në dispozitat e Ligjit për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, Kuvendit ia ka parashtruar propozim-vendimin për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Kryesia e Kuvendit, mbështetur në Ligjin për prokurim publik, ka kërkuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës që Kuvendit t’ia propozojë anëtarët e Organit Përzgjedhës.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, mbështetur në përfundimet e Kryesisë së Kuvendit ia ka propozuar Kuvendit tre gjykatës për Organin Përzgjedhës të Pavarur dhe atë:

1. Vladete Daka, nga Gjykata Supreme e Kosovës,
2. Asllan Krasniqi, nga Gjykata Themelore në Prishtinë, dhe
3. Nebojsa Boriçiq, nga Gjykata Supreme e Kosovës.

Ne kemi merak t’i ngarkojmë me shumë pozita, se nuk mund të gjejmë kandidatë tjerë, dhe duam t’i grumbullojmë krejt në një vend.

Këshilli Gjyqësor, meqë i kemi kërkuar, i ka deleguar këta. Është përgjegjësi e tyre, por ju mund ta keni fjalën në emër të grupeve parlamentare. Shkojmë sipas radhës.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, kush e do fjalën? Kryetari Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrah këtë përbërje dhe do të votojë për.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Veç desha ta tërheq vërejtjen për mbingarkesën që po bëhet për disa individë, në këtë rast për zonjën Daka. Edhe pse mund të jetë një gjyqtare e mirë, ajo është edhe kryetare e Komisionit Qendror Zgjedhor, dhe në të njëjtën kohë po emërohet në këtë komision. Mendoj se njerëzit po mbingarkohen, kur kanë përgjegjësi, dhe detyrat mund të shpërndahen.

Prandaj, kjo ishte një vërejtje publike për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, sepse nuk duhet të veprojë kështu, t’i emërojë gjithmonë të njëjtit njerëz nëpër pozita të ndryshme.

Ka mjaft njerëz boll, ka mjaft gjyqtarë edhe Gjykata Supreme, edhe nivele tjera të gjykatave, prandaj duhet shpërndahet përgjegjësia, e jo të centralizohet dhe të mbingarkohet një individ. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”, kryetari Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Përveç kësaj që u tha, ne konsiderojmë që veçanërisht zonja Daka nuk ka dëshmuar as si kryesuese e KQZ të jetë as person me integritet, e as profesionalisht e duhur.

Prandaj, emërimi i saj edhe në një komision mendoj që vetëm sa e zgjat këtë problem që po e kem me KQZ-në, edhe nëpër komisionet tjera. Kështu që Lëvizja “Vetëvendosje” është kundër kësaj liste.

KRYETARI: Faleminderit! Kryetari i Grupit të Aleancës, Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, kryetar!

Ne i kem diskutuar këto tema dhe e dimë se ka shumë çështje, të cilat kishin pasur mundësi të sillen sot në debat. Sidoqoftë, e kemi një bindje se vetëm sa do ta prolongonim një gjendje jo të mirë në këtë sferë nëse do të sillemi ndryshe.

Kështu që do ta votojmë këtë listë, edhe pse edhe një herë duhet të them publikisht se kemi vërejtje, jo vetëm për ato që u thanë, por edhe vërejtje të natyrave tjera. Faleminderit!

KRYETARI: Koalicioni për Kosovë të Re, kryetarja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Edhe Koalicioni për Kosovë të Re i përkrah anëtarët të Organit Përzgjedhës dhe besoj që do ta kryejnë punën mirë, edhe pse janë të ngarkuar.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit të SLS-së, Sasha!

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala!

Poslanička grupa Samostalne liberalne stranka podržava ove kandidate.

KRYETARI: Grupi “6+”, deputeti Enis Kervan e ka kërkuar fjalën.

ENIS KERVAN: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar “6+” e përkrah vendimin e Këshillit Gjyqësor dhe do të votojë për.

KRYETARI: Kryetari i Grupit Parlamentar “Zajednička Budućnost”, Goran Marinković e ka fjalën.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala predsjedniče!

I poslanička grupa “Zajednička Budućnost” podržava listu kandidata i glasaćemo za njih.

KRYETARI: Të lajmëruar të tjerë për diskutim nuk ka. Atëherë, sipas rregullit, shkojmë në votim.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 58 vota për, 13 kundër dhe 6 abstenime, Kuvendi i emëroi anëtarët e Organit Përzgjedhës të Pavarur për zgjedhjen e kryesuesit dhe anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit në këtë përbërje.

1. Valdete Daka, nga Gjykata Supreme e Kosovës,
2. Asllan Krasniqi, nga Gjykata Themelore në Prishtinë, dhe
3. Nebojsa Boriçi, nga Gjykata Supreme e Kosovës.

Kërkohej nga anëtarët e Organit Përzgjedhës të Pavarur që në mbështetje të nenit 100, pika 4 të Ligjit numër 03/L-241 për prokurimin publik në Republikën e Kosovës ta shqyrtojnë propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e katërmëdhjetë të rendit të ditës:

14. Emërimi i anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Pronës

Qeveria e Republikës së Kosovës, mbështetur me dispozitat e Ligjit për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë punën bujqësore dhe atë komerciale, si dhe ligjet për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjen ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës, Kuvendit ia ka parashtruar propozim-vendimin për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Pronës dhe atë:

1. Ujup Krasniqi dhe
2. Ismail Osdautaj

Komisioni Funkcional për Legjislacion e ka shqyrtuar propozim-vendimin e Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Pronës dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Fjalën e ka kërkuar kryetari i Komisionit për Legjislacion, deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar propozimin e Qeverisë dhe ka konstatuar se propozimi ka bazë kushtetuese dhe është në pajtim me procedurat ligjore dhe i rekomandon seancës që ta aprovojë.

Po ashtu, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e ka shqyrtuar dhe e përkrah. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Shkojmë në procedurën e votimit. Të pranishëm janë 85 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 67 vota për, 8 kundër, Kuvendi i emëroi zotin Ujup Krasniqi dhe zotin Ismail Osdautaj anëtarë të Bordit të Agjencisë Kosovare të Pronës me mandat njëvjeçar.

Pika e pesëmbëdhjetë e rendi të ditës:

15. Emërimi i 2 (dy) anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

Komisioni ad-hoc e ka shqyrtuar nominimet e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radhët e komunitetit shumicë shqiptarë dhe Kuvendit ia ka paraqitur rekomandimin për miratim.

Ndërsa ky Komision për zgjedhjen e një anëtari nga radhët e komitetit serb, bazuar në nenin 26, paragrafi 2, pika 3 e Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës rekomandon përsëritjen e konkursit për shkak të mosplotësimit të numrit të kandidatëve që duhet të aplikojnë për këtë pozitë.

E ftoj kryetaren e Komisionit ad hoc, Xhevahire Izmakun, që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë rekomandimin e Komisionit.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, në bazë të nenit 67 dhe 71 të Rregullores së Kuvendit, si dhe të nenit 26 të Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës, në mbledhjet e mbajtura më 10 dhe 22 tetor 2013, pas shqyrtimit të biografive dhe intervistimit të kandidatëve të nominuar për anëtarë të Bordit të RTK-së, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R E K O M A N D I M

1. I rekomandohet Kuvendit të Republikës së Kosovës të bëjë zgjedhjen e dy anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës me votim të fshehtë.

2. Për dy anëtarë të Bordit të RTK-së nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar propozohen kandidatët si në vijim:

1. Naime Beqiraj,
2. Afërdita Maliqi,
3. Murat Musliu dhe
4. Besa Maxhuni.

Kuvendi bën përzgjedhjen e dy anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga katër kandidatët e propozuar.

Radiotelevizioni i Kosovës në pajtim me nenin 26, të Ligjit për RTK-në të nxjerr shpallje publike a për zgjedhjen edhe të një anëtari nga radhët e komunitetit serb.

Komisioni pas intervistimit të kandidatëve për anëtarë të Bordit të RTK-së në pajtim me nenin 26, pika 2.3 të Ligjit për RTK-në vendosi që Kuvendit t’ia propozojë për votim katër kandidatë.

Kuvendi prej katër kandidatëve të propozuar do t’i zgjedhë me votim të fshehtë dy kandidatë.

Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit, pas shqyrtimit dhe verifikimit të listës së kandidatëve të propozuar nga RTK-ja nga radhët e komunitetit serb konstatoi se ka aplikuar vetëm një kandidat.

Në bazë të nenit 26, paragrafi 2.3 për çdo pozitë të lirë në Bord duhet të propozohen dy kandidatë.

Komisioni ka konstatuar se në bazë të kësaj dispozite nuk janë përmbushur kushtet për emërimin e anëtarit të Bordit të RTK-së nga radhët e komunitetit serb. Andaj, RTK-ja duhet që, në pajtim me nenin 26 të Ligjit për RTK-në, të nxjerrë shpallje publike për zgjedhjen edhe të një anëtari nga radhët e komunitetit serb.

Ne do të votojmë sot për dy kandidatë, ndërsa pastaj do të shpallet konkursi edhe për kandidatin nga radhët e komunitetit serb. Faleminderit!

KRYETARI: Tani është radha që t’i ftoj përfaqësuesit e grupeve parlamentare që ta propozojnë nga një anëtar për Komisionin votues.

Në emër të Partisë Demokratike, kryetari Adem Grabovci e propozon një kandidat për Komisionin votues.

ADEM GRABOVCI: Grupi Parlamentar i PDK-së e propozon Blerta Deliun për anëtare.

KRYETARI: LDK-ja, Arben!

ARBEN GASHI: LDK-ja e propozon Hashim Deshishkun.

KRYETARI: “Vetëvendosja”, Visar!

VISAR YMERI: Ne e propozojmë Albana Fetoshin.

KRYETARI: AAK-ja, Ardian!

ARDIAN GJINI: Aleanca e propozon deputeten Kymete Bajraktari.

KRYETARI: Faleminderit! Koalicioni për Kosovë të Re, Myzejene!

MYZEJENE SELAMANI: Jeton Svircën, kryetar.

KRYETARI: Grupi SLS-së, Sasha!

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Jelena Bontić.

KRYETARI: “6+”, Enis!

ENIS KARVAN: Kryetar, Duda Balje.

KRYETARI: Grupi “Zajednička Budućnost”!

GORAN MARINKOVIĆ: Biserka Kostić.

KRYETARI: Lus deputetët që me ngritje dore të deklarohen për Komisionin votues. Faleminderit! A ka kundër? Nuk ka. Me shumicë miratohet komisioni.

Lus komisionin që t’i zërë vendet e veta!

KRYETARI: Fillojmë me votimin e fshehtë:

Adem Grabovci, Afërdita Berisha-Shaqiri, Afrim Hoti, Afrim Kasolli, Gëzim Kelmendi, Agim Kuleta, Ahmet Isufi, Albana Fetoshi, Albana Gashi, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Ali Sadriu, Albert Kinolli, Alma Lama, Anton Çuni, Arben Gashi, Ardian Gjini, Armend Zemaj, Aurora Bakalli, Azem Syla, Bahri Thaçi, Arsim Bajrami, Bali Muharremaj, Berat Buzhala, Behar Selimi, Amir Ahmeti, Bekim Haxhiu, Biserka Kostiq, Blerim Shala, Blerta Deliu-Kodra, Burim Ramadani, Danush Ademi, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Duda Balje, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enis Kervan, Nait Hasani, Eqrem Kryeziu, Etem Arifi, Fadil Demaku, Fatmir Limaj, Fatmir Xhelili, Jeton Svirca, Flora Brovina, Florin Krasniqi, Ganimete Musliu, Glauk Konjufca, Goran Marinkoviq, Nijazi Idrizi, Haki Demolli, Halit Krasniqi, Hamza Balje, Hydajet Hyseni-Kaloshi, Hashim Deshishku, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami; Emin Gërbeshi, Idriz Vehapi, Imri Ahmeti, Ismet Beqiri, Jakup Krasniqi, Jasmina Zhivkoviq...

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: ...Jelena Bontiq, Justina Pula, Kymete Bajraktari, Latif Gashi; Liburn Aliu, Lirije Kajtazi, Lumnije Morina, Lutfi Haziri, Lutfi Zharku, Fikrim Damka, Kurtan Kajtazi, Suzan Novobërdaliu, Mufera Shinik, Muhamet Mustafa, Mursel Halili, Myzejene Selmani, Naser Osmani, Nazane Breca, Kymete Bytyçi, Sasha Millosavljeviq, Petar Miletiq, Rada Trajkoviq, Ramë Vataj, Ramiz Kelmendi, Ramiz Lladrovci, Rasim Demiri, Rexhep Selimi, Rita Hajzeraj-Beqaj, Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala, Sali Asllanaj, Salih Morina, Lutfi Zharku, Salihe Mustafa, Sasha Gjokiq, Milivoje Stojanoviq, Sevdije Lama, Shaip Muja, Skender Hyseni, Boban Todoroviq, Sreten Ivanoviq, Teuta Haxhiu, Teuta Sahatqija, Time Kadrijaj, Ukë Rugova, Vesimir Saviq, Vesna Mikiq, Visar Ymeri, Vjollca Krasniqi, Vjosa Osmani, Valbona Dibra, Xhevahire Izmak, Xhevdet Neziraj dhe Zenun Pajaziti, Xhavit Haliti.

Lus komisionin që ta marrë fjalën për ta komunikuar rezultatin e votimit dhe për ta bërë numërimin publik.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryesues!

Nga të gjithë deputetët, kanë votuar gjithsej 89 dhe fillojmë me numërimin e votave.

E pavlefshme, Naime Beqiraj, Murat Musliu, Është votuar vetëm Naime Beqiraj, E pavlefshme, Naime Beqiraj, Besa Maxhuni, Afërdita Maliqi, Murat Musliu, Naime Beqiraj, Afërdita Maliqi, Naime Beqiraj, Murat Musliu, Naime Beqiraj, Afërdita Maliqi, Afërdita Maliqi, Murat Musliu, Naime Beqiraj, Bexha Maxhuni, Naime Beqiraj, Afërdita Maliqi, Naime Beqiraj, Afërdita Maliqi, Naime Beqiraj, Afërdita Maliqi, Afërdita Maliqi, Murat Musliu, Naime Beqiraj, Afërdita Maliqi, Afërdita Maliqi, Murat Musliu, Afërdita Maliqi, Murat Musliu, Afërdita Maliqi, Naime Beqiraj, Afërdita Maliqi, Naime Beqiraj, Naime Beqiraj, Murat Musliu, Afërdita Maliqi, Murat Musliu, Naime Beqiraj, Afërdita Maliqi, Afërdita Maliqi, Murat Musliu, Afërdita Maliqi, Murat Musliu, Afërdita Maliqi, Murat Musliu, Afërdita Maliqi, Besa Maxhuni, E pavlefshme, Naime Beqiraj, Afërdita Maliqi, Naime Beqiraj, Murat Musliu, Naime Beqiraj, Afërdita Maliqi, Naime Beqiraj, Afërdita Maliqi, Naime Beqiraj, Afërdita Maliqi, Afërdita Maliqi, Murat Musliu, Naime Beqiraj, Murat Musliu, Naime Beqiraj, Besa Maxhuni, Naime Beqiraj, Afërdita Maliqi, Naime Beqiraj, Afërdita Maliqi, Afërdita Maliqi, Besa Maxhuni, Afërdita Maliqi, Murat Musliu, Naime Beqiraj, Murat Musliu, Afërdita Maliqi, Murat Musliu, Naime Beqiraj, Naime Beqiraj, Afërdita Maliqi, Afërdita Maliqi, Murat Musliu, Naime Beqiraj, Afërdita Maliqi, Afërdita Maliqi, Naime Beqiraj, Afërdita Maliqi, Naime Beqiraj, Afërdita Maliqi, E pavlefshme, E pavlefshme, Naime Beqiraj, Afërdita Maliqi, Naime Beqiraj, Murat Musliu, Afërdita Maliqi, Murat Musliu, Afërdita Maliqi, Murat Musliu, Naime Beqiraj, Naime Beqiraj, E pavlefshme, Afërdita Maliqi, Murat Musliu, Naime Beqiraj, Afërdita Maliqi, Afërdita Maliqi, Murat Musliu, Naime Beqiraj, Afërdita Maliqi, Afërdita Maliqi, Murat Musliu, Afërdita Maliqi, E pavlefshme, Naime Beqiraj, Afërdita Maliqi, E pavlefshme, Afërdita Maliqi, Murat Musliu, Naime Beqiraj, Afërdita Maliqi, Afërdita Maliqi, Besa Maxhuni, Naime Beqiraj, Afërdita Maliqi, Murat Musliu, Afërdita Maliqi, Murat Musliu, Naime Beqiraj, Afërdita Maliqi, Afërdita Maliqi, Murat Musliu, Naime Beqiraj, Afërdita Maliqi, Naime Beqiraj, Afërdita Maliqi, Afërdita Maliqi, Murat Musliu, Naime Beqiraj, Afërdita Maliqi, Naime Beqiraj, Afërdita Maliqi, Afërdita Maliqi, Murat Musliu, Naime Beqiraj, Afërdita Maliqi, Afërdita Maliqi, Murat Musliu, Afërdita Maliqi, Murat Musliu.

KRYESUESI: Regjia, fjalën deputetes Deliu!

BLERTA DELIU-KODRA: Komisioni votues, pas procedurave të votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për emërimin e 2 anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, konstaton si vijon:

Në votim kanë marrë pjesë 89 deputetë. Të pavlefshme janë 7 fletëvotime. Rezultati i votimit është si vijon:

- Naime Beqiraj i ka fituar 46 vota;
- Afërdita Maliqi i ka fituar 63 vota;
- Murat Musliu i ka fituar 35 vota dhe
- Besa Maxhuni i ka fituar 6 vota.

Në bazë të rezultatit të votimit, në pajtim me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 26 të Ligjit numër 04/L-46 për Radiotelevizionin e Kosovës dhe nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, konstatohet se anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës janë zgjedhur:

- Afërdita Maliqi, me gjithsej 63 vota; dhe
- Naime Beqiraj me gjithsej 46 vota.

KRYESUESI: Faleminderit! Konstatoj se me kaq seanca e sotme përfundoi. Mirupafshim në seancën e ardhshme!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*